



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 923/ 6 prot

Datë 23.04.2026

V E N D I M
Nr. 538/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79017-03-12-2026, me objekt: “*Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra*”, me fond limit: 149,998,577.16 (*njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjet e tetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH ose 1,560,209.87 (*njëmilion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë e dyqind e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë*) euro. (Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.14), datë 12.03.2026), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79017-03-12-2026, me objekt: “*Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra*”, me fond limit: 149,998,577.16 (*njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjet e*

tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,560,209.87 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë) euro. (Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.14), datë 12.03.2026), parashikuar për t'u zhvilluar më datë 17.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Albgarden” SHPK me NIPT K37513520N dhe me adresë: Lagjia “Skënderbeg”, God Private 1 kat, Superstrada Lezhë – Shkodër, Km. 1, Lezhë.

Autoriteti Kontraktor:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
Adresa: Pranë Stadiumit Himarë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.03.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-79017-03-12-2026, me objekt: “*Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra*”, me fond limit: 149,998,577.16 (*njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjet e tetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH ose 1,560,209.87 (*një milion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë e dyqind e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë*) euro. (Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.14), datë 12.03.2026), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

II.2. Në datën 26.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “*Albgarden*” SHPK, me numër ankimi elektronik A/2026/6456 dhe me nr. 923/2026 prot., dhe, datë 26.03.2026, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumenteve standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, e më konkretisht pretendohet si më poshtë vijon:

Në datë 17.03.2026 Autoriteti Kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt: Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra me nr. REF-79017-03-12-2026, me fond limit 149,998,577.16 (njëqind e dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 1,560,209.87 (një milion e pesë qind e gjashtëdhjetë mijë e dyqind e nëntë pikë tetë dhjetë e shtatë) Euro, parashikuar për tu zhvilluar në datë 17.04.2026 ora 10:00. Pasi jemi njohur me dst, nga verifikimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatojmë se disa prej tyre janë vendosur në kundërshtim të plotë me Ligjin 162/2020 Për Prokurimin Publik i ndryshuar, si dhe me VKM nr. 285 datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik . Në këto kushte, brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 110 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 Për

Prokurimin Publik i ndryshuar, po paraqesim këtë ankesë përpara Autoritetit Kontraktor, duke parashtruar si vijon:

Pika 1.

Në Shtojcën 9, Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.1.1 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kategoria III.2 Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis: nënkategoria III.2.B për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, kodi: 17 5 04 dhera dhe gurë të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03.

Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kritereve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Kjo licencë është e domosdoshme, pasi shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit përfshin edhe menaxhimin, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, përfshirë materialet inertë si dhe dherat dhe gurët e përmendur në kodet e licencës. Prania e licencës garanton që operatori ekonomik është i certifikuar dhe i autorizuar për kryerjen e këtyre shërbimeve në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe normat e sigurisë. Licenca e Kategorisë III.2 siguron që operatori ekonomik plotëson kriteret teknike, kapacitetet profesionale dhe standardet administrative të kërkuara për ofrimin e shërbimeve me ndikim në mjedis, duke përfshirë aspektet e menaxhimit të mbetjeve dhe monitorimit të ndikimit mjedisor. Kërkesa për licencë të vlefshme nga QKL është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare për shërbime me ndikim në mjedis, dhe përbën një kriter proporcional dhe të domosdoshëm për garancinë e realizimit të shërbimit në mënyrë profesionale dhe ligjore. Kriteri 2.1.1 është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës duke garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetet dhe autorizimet e nevojshme për realizimin korrekt të shërbimit të gjelbërimit, përfshirë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane .

Lidhur me kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në pikën 2.1.1 për paraqitjen e licencës së vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kategoria III.2 Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis: nënkategoria III.2.B për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, kodi: 17 5 04 dhera dhe gurë të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03 kërkojmë modifikimin e këtij kriteri. Më konkretisht sqarojmë Autoritetin Kontraktor se në VKM nr. 402, datë datë 30.6.2021 Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve në fq 17 përcaktohen kodet përkatëse të Mbetjeve nga Ndërtimet dhe Prishjet (Përfshi Dhera të Gërmuara nga Zona të Kontaminuara). Lidhur me Kodin e kërkuar nga AK me nr. 17504 në kriterin 2.1.1, referuar Katalogut të Mbetjeve rezulton se ky Kod nuk ekziston, ndërkohë që Kodi i saktë i parashikuar nga Katalogu i Mbetjeve është: 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. Ne e kuptojmë faktin se ndoshta mund të jetë një

lapsus i lehtë i AK por nga ana tjetër, me qëllim hartimin në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e më pas vlerësimin korrekt e në përputhje me Ligjin e Prokurimit të ofertave të paraqitura, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke vendosur numrin e saktë të Kodit të Mbetjeve sipas përcaktimit të katalogut të mbetjeve të miratuar me VKM nr. 402, datë datë 30.6.2021 Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve. Sa mësipër, kërkojmë ndryshimin e kriterit duke përcaktuar numrin e saktë të Kodit të Mbetjeve dhe konkretisht duke saktësuar kodin: 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03.

Pika 2.

Në Shtojcën 9, Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.1.3 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Prodhimi dhe tregëtimi i farave dhe fidanëve (Kodi II.4). Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të krieteve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Ky kriter është i domosdoshëm, pasi kontrata përfshin mbjellje dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelbra, përfshirë mbi 2,700 fidanë dekorativë, shkurre dhe fidanë të rinj, si dhe mbjellje bari në rreth 42,000 m² sipërfaqe. Për të garantuar që bimët dhe fidanët e përdorur janë të certifikuar, të shëndetshëm, të përshtatshëm për klimat dhe tokat vendore, është e nevojshme që operatori të ketë licencën përkatëse të prodhimit dhe tregimit të farave dhe fidanëve. Licenca e lëshuar nga QKL (Kodi II.4) siguron që operatori posedon kapacitete ligjore dhe teknike për furnizim me fidanë dhe fara të cilësisë së certifikuar, duke garantuar integritetin biologjik të bimëve, përshtatshmërinë për ambientin urban dhe natyror, dhe respektimin e standardeve mjedisore dhe fito sanitare. Kjo redukton rrezikun e sëmundjeve ose problemeve mjedisore nga bimët e importuara ose të paprovuara. Dokumentacioni i kërkuar, përfshirë licencën, garanton që operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht dhe i kualifikuar për aktivitetet e prodhimit dhe tregimit të bimëve, duke shmangur përdorimin e burimeve të paautorizuara dhe duke siguruar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet me standarde profesionale. Kriteri është proporcional me objektin e kontratës, i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për furnizim të sigurt dhe cilësor me bimë dhe fidanë, dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës. Ai siguron që operatorët që marrin pjesë kanë kapacitet të ligjshëm dhe teknik për të përmbushur kërkesat e shërbimit. Ky kriter është i domosdoshëm pasi garanton realizimin e shërbimit të gjelbërimit me përdorim të bimëve dhe fidanëve të certifikuar dhe të autorizuar.

Lidhur me kriterin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e Licencës me Kod II.4, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi ky kriter është i paligjshëm. Më konkretisht, sqarojmë se në VKM nr. 34 datë 22.01.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.538 datë 26.05.2009 Për liçensat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta, të ndryshuar, rezulton

se në pikën 2 është shfuqizuar Kategoria II.4, Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor) , e fushës II, Ushqimi dhe shëndeti . Sjellim në vëmendje të Autoritetit Kontraktor se në nenin 77 Kërkesat për kualifikim të Ligjit të Prokurimit Publik përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; ??b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës . Më tej akoma, në pikën 2 po të nenit 77 parashikohet se: 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. Ndërsa në nenin 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve , pika 4, të VKM 285 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik përcaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore ; Referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, rezulton se Autoriteti Kontraktor ka të drejtën ligjore e përcaktimit të kërkesave lidhur me përshtatshmërinë profesionale, por nga ana tjetër këto kërkesa duhet të jenë të bazuara në kuadrin ligjor në fuqi. Duke qenë se me VKM nr. 34 datë 22.01.2020 është shfuqizuar Licenca e lëshuar nga QKL për Kodin II.4, Kategoria II.4, Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor) , e fushës II, Ushqimi dhe shëndeti , në këto kushte, vlerësojmë se kërkesa e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e kësaj license është e pambështetur ligjërisht, e për pasojë duhet të hiqet si kriter.

Pika 3.

Në Shtojcën 9, Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nën-pika 2.1.4 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit dhe N.S- 18 A Punime topogjeodezike. Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të krieteve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Ky kriter është i domosdoshëm, pasi realizimi i kontratës kërkon ndërhyrje të koordinuara në hapësira të gjelbra dhe infrastruktura të mbështetura në

matje topografike dhe inxhinieri mjedisore. Punimet e mirëmbajtjes së varrezave, shëtitoreve, rrugëve dhe zonave kodrinore përfshijnë:

- ? skarifikim dhe mbjellje bari në sipërfaqe të mëdha,
- ? prerje dhe sistemim pemësh me diametra të ndryshëm,
- ? vendosje dhe mirëmbajtje të fidanëve dekorativë dhe shkurreve,
- ? mbjellje, transport dhe stabilizim të materialeve të ndryshme,
- ? ndërhyrje në terrene të pjerrëta dhe zona urbane të ndjeshme.

mjedisit, duke garantuar realizimin e punimeve me respektim të standardeve mjedisore, për sigurinë dhe funksionalitetin e hapësirave të gjelbra. Licenca N.S-18 A siguron që operatori ka kapacitet për matje dhe shënime topografike të terrenit, të cilat janë të domosdoshme për vendosjen e saktë të elementeve të gjelbërimit dhe për planifikimin e punimeve në zona kodrinore dhe urbane. Kërkesa për licensë profesionale të vlefshme siguron gjithashtu që shoqëria është e regjistruar dhe e autorizuar ligjërish për kryerjen e punimeve të planifikuara dhe shmang veprime të paautorizuara, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi. Licenca është një dokument thelbësor për të verifikuar kapacitetin teknik të operatorit dhe aftësinë për realizim të punimeve inxhinierike mjedisore dhe topogjeodezike. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit A që i përgjigjet kësaj vlere. Kriteri është i domosdoshëm pasi garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin dhe autorizimin e nevojshëm për të realizuar shërbimin e gjelbërimit në përputhje me standardet profesionale dhe ligjore.

Lidhur me kriterin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e Liçensës N.S-18 A Punime topogjeodezike, kërkojmë heqjen e këtij kriteri si kriter i paligjshëm, i cili nuk është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Më konkretisht argumentojmë si vijon: Referuar argumentimit të vendosjes së këtij kriteri, rezulton se AK ka kërkuar që OE konkurues të ketë kapacitet për matje dhe shënime topografike të terrenit. Sqarojmë AK se vendosja e këtij kriteri e për më tepër me këtë argumentim nuk është në përputhje me llojin dhe natyrën e kontratës. Sjellim në vëmendje të AK se kontrata e prokurimit është shërbime dhe jo punë, ndërsa objekti i procedurës së prokurimit është Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbra që do të thotë se hapësirat e gjelbërta që kërkon AK të mirëmbahen minimalisht janë identifikuar nga AK dhe nuk kërkohet të identifikohen me anë të shërbimeve topografike nga OE konkurues. Kjo licencë qartazi nuk ka asnjë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit. Për më tepër rezulton se Autoriteti Kontraktor nuk ka publikuar asnjë lloj harte me koordinatat përkatëse për sipërfaqet e gjelbërta që kërkon mirëmbajtje. Po kështu, referuar Shtojcave të Dokuemnteve Standarde të tenderit rezulton se nuk ka asnjë fjalë, proces apo zë/punë konkrete që duhet të kryejë OE konkurues lidhur me shërbimet/punimet topogjeodezike. Më konkretisht:

- a) Shtojca 6 Formulari i Specifikimeve Teknike nuk përmban asnjë fjalë/term apo proces që identifikon ndonjë punim topogjeodezike;
- b) Shtojca 7 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, nuk përmban asnjë proces pune (aq më pak njësi apo sasi) që identifikon ndonjë punim topogjeodezike;

c) Shtojca 8 Formulari i Termave të Referencës, nuk përmban asnjë proces pune, përshkrim të shërbimeve apo kërkesë teknike që identifikon ndonjë punim topogjeodezike;

Sa mësipër, rezulton se ky kriter nuk është në përputhje me natyrën, kërkesat dhe llojin e kontratës. Ky kriter i vendosur si ciban pa rrënjë bie në kundërshtim të hapur me nenin 2 Qëllimi shkronja d të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik i ndryshuar ku përcaktohet se: Qëllim i këtij ligji është: d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; Qartazi vendosja e këtij kriteri është e paligjshme dhe diskriminon OE konkurues në këtë procedure prokurimi. Për pasojë, vlerësojmë se ky kriter është tërësisht abuziv dhe diskriminues dhe ne kërkojmë të hiqet.

Pika 4.

Në Shtojcën 9, Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.3.2 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëra, i cili duhet të jetë inxhinier pyjesh i çertifikuar si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

a) Diplomë në inxhinieri pyjesh;

b) Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor. c) Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave.

d) CV-në përkatëse;

e) Kontratë pune (e vlefshme).

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të krieteve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: “në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar). Nga preventivi rezulton se kontrata përfshin ndërhyrje të gjera në pemë dhe sipërfaqe të gjelbra, konkretisht prerje dhe sistemime pemësh me diametra deri në 75 cm, mirëmbajtje në zona kodrinore dhe me pisha, mbjellje fidanësh të rinj, trajtime me plehra dhe produkte fito sanitare, si dhe ndërhyrje në zona me karakter natyror dhe gjysmë-natyror. Këto aktivitete kërkojnë njohuri të thelluara profesionale mbi biologjinë e pemëve, menaxhimin e masiveve drusore, stabilitetin e terrenit, ndikimin në biodiversitet dhe praktikat e qëndrueshme të mirëmbajtjes. Përcaktimi i një inxhinieri pyjesh si Drejtues Teknik është i domosdoshëm për të garantuar që ndërhyrjet në pemë dhe në zonat e gjelbëra të kryhen sipas praktikave profesionale dhe

standardeve teknike, duke shmangur dëmtimet e pakthyeshme të vegjetacionit, prerjet e gabuara, destabilizimin e terrenit apo rreziqe për sigurinë publike. Duke qenë se në preventiv parashikohen ndërhyrje në mijëra elementë drusorë dhe sipërfaqe të mëdha natyrore, drejtimi teknik nga një specialist i fushës është thelbësor për planifikimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së punimeve. Kërkesa për certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor është e justifikuar nga fakti se ndërhyrjet në zona kodrinore, në pisha dhe në hapësira me karakter natyror mund të kenë ndikim mjedisor. Prania e një eksperti me këtë kualifikim garanton që aktivitetet do të vlerësohen dhe do të realizohen në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe me legjislacionin përkatës. Gjithashtu, kërkesa për certifikim si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për supervizimin e aktiviteteve siguron që drejtimi teknik të kryhet nga një profesionist i njohur dhe i autorizuar për të mbikëqyrur ndërhyrje në fondin pyjor dhe hapësirat e gjelbra, duke garantuar standard profesional dhe përgjegjësi teknike. Paraqitja e diplomës, certifikatave përkatëse, CV-së dhe kontratës së vlefshme të punës synon të garantojë që personi i deklaruar është realisht i kualifikuar, i angazhuar pranë operatorit ekonomik dhe i disponueshëm për zbatimin e kontratës, duke shmangur deklarime formale. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet nën drejtimin e një specialisti të kualifikuar në fushën e pyjeve dhe mjedisit, në përputhje me standardet profesionale dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Lidhur me kërkesën për pasjen e Certifikatës për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi ky kriter është abuziv, konfuz, si dhe bie në kundërshtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Më konkretisht argumentojmë se: Në Ligjin nr. 10440, datë 7.7. 2011 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis , neni 2, pika 18 përcakton se: Ekspert i certifikuar i VNM-së është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor. Pra qartazi ligji 10440 dhe përkufizimi përkatës për certifikatën për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor bën fjalë për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ndërkohë në procedurën konkrete të prokurimit, referuar Shtojcës 8 Formulari i Termave të Referencës, rezulton se Qëllimi i kontratës është: realizimi i shërbimeve për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, prerjen dhe sistemimin e vegjetacionit, furnizimin dhe mbjelljen e fidaneve, plehërimin dhe trajtimin fitosanitar, transportin e materialeve dhe mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e elementeve ndërtimore dhe infrastrukturore në zona publike, rrugore, shkollore dhe memorial. Pra kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me shërbime mirëmbajtje në hapësira e sipërfaqe të gjelbërta (përfshirë mbjedhje dhe trajtim fitosanitar) dhe mirëmbajtje të elementëve ndërtimorë e infrastrukturorë në zona publike, rrugore, shkollore etj.. Lidhur me këtë kërkesë të AK sqarojmë se nuk jemi në një procedurë prokurimi ku kërkohet impakti dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis të ndonjë procesi (psh ndërtimi i një objekti industrial apo me karakter civil rrugë objekt ndërtimor etj), por jemi përballë një shërbimi rutinë mirëmbajtje. Nga ana tjetër, rezulton se në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike dhe në Shtojcën 7 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, Autoriteti

Kontraktor nuk ka përcaktuar asnjë zë apo specifikim konkret që lidhet ne procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në këto kushte kjo kërkesë është e paligjshme, diskriminuese dhe ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e procedurës, e për pasojë duhet të hiqet.

Lidhur me kërkesën për pasjen e Certifikatës si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, sjellim në vëmendje të Autoriteti Kontraktor se objekti i procedurës së prokurimit është shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta në Bashkinë Himarë dhe JO Supervizionim i këtij shërbimi. Kërkesa për pasjen e Certifikatës së supervizimit të punës dhe shërbimit që do të kryejë Operatori Ekonomik i shpallur fitues mund të realizohet ose nga një zyrtar i Autoriteti Kontraktor ose nga një Person Fizik apo Juridik i kontraktuar nga AK. E thënë thjesht, bukur dhe pastër ju bëjmë me dije se OE fitues që realizon kontratën nuk mund të supervizojë veten, pasi minimalisht do të ndodhet në një situatë konflikti interesi të pastër me veten e tij. Referuar VKM nr. 284, datë 29.4.2022 Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave dhe Kritereve për Pajisjen me Certifikatën e Ekspertit në Fushën e Pyjeve dhe Kullotave në pikat 2 dhe 3 parashikohet se: 2. Pajisja me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve është e detyrueshme për çdo individ, që kërkon të ushtrojë ekspertizë profesionale për veprimtari të tilla, si supervizimi, studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota në Republikën e Shqipërisë me fonde publike e private. 3. Shërbimi i ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota ushtrohet nga eksperti për veprimtaritë e mëposhtme: a) supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, mbikëqyrjen, kolaudimin dhe certifikimin e veprimtarive të prodhimit apo tregtimit të farave, kalemave e fidanëve pyjorë dhe të materialit mbjellës; b) hartimin e metodikave, udhëzuesve/manualëve, studimeve thellësisht teknike për përdorimin e territorit për zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor dhe vlerësimin e peizazhit, biodiversitetit, zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare, florës spontane (bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore), faunës së egër, të rrjetit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës dhe parandalimit të rrezikut të zjarreve; c) hartimin e projekteve të tilla, si projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse, projekte për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulturore, të sistemimeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, të mbritshmërisë, ndërtimin e rrugëve autopsyjore dhe teleferikëve pyjorë; ç) zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve, ku përfshihet zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të pyllëzimit dhe projektet që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve . Referuar përcaktimeve të VKM nr. 284, date 29.04.2022 qartazi rezulton se shërbimi i ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave nevojitet për aktivitetet si: supervizimi, studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota në Republikën e Shqipërisë. Në rastin konkret rezulton se procedura e prokurimit është thjesht dhe vetëm Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra , pra nuk ndodhemi në asnjë nga kushtet për nevojën e shërbimit të specializuar të ekspertit.

Në këto kushte është e qartë se ky kriter nuk është në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës duke shkelur kështu parashikimet e nenit 77 të Ligjit të Prokurimit Publik, dhe nenit 41 të VKM nr. 285, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku përcaktohet se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Bazuar në sa mësipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke hequr kërkesën për pasjen e Certifikatës për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor si dhe duke hequr kërkesën për pasjen e Certifikatës si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave.

Pika 5.

Në Shtojcën 9, Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.3.5 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë fitosanitare e brendshme të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose të ketë kontratë furnizimi me një subjekt i cili të jetë i pajisur me këtë certifikatë . Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kriterëve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Objekti i kontratës përfshin mbjelljen, zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e bimësisë dekorative, drurëve ornamentale, shkurreve dhe sipërfaqeve me bar, si dhe trajtimin e tyre me produkte fitosanitare kur është e nevojshme. Këto aktivitete lidhen drejtpërdrejt me qarkullimin dhe përdorimin e materialit bimor, i cili duhet të jetë i kontrolluar nga pikëpamja fitosanitare për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, dëmtuesve dhe organizmave të dëmshëm. Kërkesa për pajisje me certifikatë fitosanitare të brendshme është teknikisht e domosdoshme, pasi garanton që operatori ekonomik ose furnizuesi i tij është i autorizuar për tregtimin dhe qarkullimin e materialit bimor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se produktet bimore janë subjekt i kontrollit zyrtar. Në mungesë të këtij autorizimi, ekziston rreziku i përdorimit të materialeve të pakontrolluara, të cilat mund të sjellin pasoja negative për shëndetin e bimësisë ekzistuese, biodiversitetin urban dhe mjedisin në tërësi. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, pasi cilësia dhe siguria e materialit bimor përbëjnë element thelbësor për realizimin e qëndrueshëm të shërbimit të gjelbërimit. Përdorimi i fidanëve apo bimëve të infektuara mund të shkaktojë dëme afatgjata, kosto shtesë për zëvendësime dhe ndërhyrje korigjuese, si dhe rrezik për përhapjen e sëmundjeve në hapësirat publike. Parashikimi që operatori ekonomik mund të përmbushë kriterin edhe përmes një kontrate furnizimi me një subjekt të pajisur me certifikatë fitosanitare garanton respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe moskufizimit të konkurrencës. Në këtë mënyrë, kriteri nuk kufizon

pjesëmarrjen vetëm te subjektet që e disponojnë drejtpërdrejt certifikatën, por lejon përmbushjen e tij edhe përmes bashkëpunimit të ligjshëm me subjekte të autorizuara, duke siguruar njëkohësisht që materiali bimor të vijë nga burime të kontrolluara. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatori ekonomik fitues do të furnizohet me material bimor të kontrolluar dhe të certifikuar, duke siguruar realizimin e shërbimit të gjelbërimit në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore në fuqi.

Lidhur me kriterin për pasjen e certifikatës fitosanitare e brendshme të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose të ketë kontratë furnizimi me një subjekt i cili të jetë i pajisur me këtë certifikatë kërkojmë modifikimin e këtij kriteri dhe përcaktimin e tij sipas kuadrit ligjor në fuqi. Paraprakisht ju bëjmë me dije se mënyra se si është kërkuar kriteri nga ana e AK sjell konfuzion dhe krijon paqartësi te OE konkures. Më konkretisht sqarojmë se në Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e çertifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese përcaktohen rregullat, kriteret dhe dokumentacioni shoqërues i tregtimit të fidanëve dhe bimëve zbukuruese. Në pikën II, Kërkesat për Tregtimin e Materialeve të Shumëzimit dhe Fidanëve , shkronja d të VKM 523 përcaktohet se: 1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi . Referuar kuadrit dhe përcaktimeve ligjore të sipërcituara, rezulton se kriteri për paraqitjen e Certifikatës Fitosanitare, do të ishte në formën dhe mënyrë e duhur ligjore nëse kërkohet si vijon: Certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur VKM nr. 523 datë 13.07.2016 . Gjithashtu, ju bëjmë me dije se Institucioni kompetent në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i ngarkuar me detyrën e zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor , si dhe të akteve nënligjore, të miratuara, është Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF). Disa Autoritete të tjera Kontraktore si Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, etj, në rastet kur kanë prokuruar procedura të prokurimi të njëjta dhe/ose të ngjashme me procedurën aktuale, i janë drejtuar me kërkesë zyrtare ESHFF lidhur me kërkesën për paraqitjen e Certifikatës fitosanitare, dhe ky Institucion ka dhënë përgjigje zyrtare duke sqaruar se: Dokumentacioni shoqërues që duhet të kenë fidanët e bimëve zbukuruese, drurë apo shkurre dekorative, për tu tregëtuar, është: 1) Të jenë të çertifikuar nga Autoriteti Çertifikues (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve) duke i pajisur me Çertifikatën Zyrtare model 3, aneksi 4 i VKM nr. 523, datë 13.07.2016; 2) Të jenë të Autorizuar nga Organi Çertifikues (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve) për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit. Autorizimi nxirret sipas modelit 4 të aneksit 4, të VKM nr. 523, datë 13.07.2016.; 3) të kenë Çertifikatë Origjine , që nxirret dhe plotësohet nga furnizuesi dhe që ka vlerë pasi nënshkruhet dhe vuloset nga Autoriteti Çertifikues . Sa më sipër vlerësojmë se të njëjtën praktikë

ligjore dhe institucionale duhet të zbatohet dhe Autoriteti Juaj Kontraktor. Bashkëngjitur kësaj ankese po ju paraqesim përgjigjet zyrtare të Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, si dhe modelet e Certifikatave zyrtare fitosanitare siç përcakton VKM nr. 523 datë 13.07.2016. Përsa mësipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

Pika 6. Në Shtojcën 9, Formular i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.3.6 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Gazelone me kapacitet mbajtës deri në 1 ton	5 copë	Pronësi ose me qira
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1-3 ton	3 copë	Pronësi ose me qira
3	Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Autokullë vinç me kosh	1 copë	Pronësi ose me qira
5	Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Mini fadrome	1 copë	Pronësi ose me qira
7	Makineri per hidrombjelljen e barit në sipërfaqet e pjerrëta të qytetit me kapacitet deri në 1000 litra	1 copë	Pronësi ose me qira
8	Vegla krasitëse	20 copë	Pronësi ose me qira
9	Pompa spërkatëse	5 copë	Pronësi ose me qira
10	Korrëse bari	5 copë	Pronësi ose me qira
11	Sharrë krasitje	5 copë	Pronësi ose me qira
12	Zetor	1 copë	Pronësi ose me qira

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, që do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës janë dokumentat si mëposhtë:

Aktin e pronësisë së mjetit përkatës: Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm) ndërsa për mjetet tip Autokullë duhet të paraqitet dhe raport inspektimi (certifikata e kontrollit teknik) i kraut ngritës për punime në lartësi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

ose

Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale dhe të jetë specifike për objektin që prokurohet dhe afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (mjetet me goma) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatën e kontrollit teknik, taksa e mjetit dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (të vlefshme) si dhe certifikatën e transportit nga autoritetet perkatese per vete dhe te trete, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qirasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhen e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kriterëve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: në nenin 77, pika 1/c, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar). Objekti i kontratës përfshin ndërhyrje të vazhdueshme në territor, transport të materialeve bimore, dheut dhe mbetjeve, ujitje të sipërfaqeve të gjelbra, krasitje të pemëve në lartësi, mbjellje dhe mirëmbajtje të barit, përfshirë zona të pjerrëta, si dhe ndërhyrje me makineri të specializuara. Për realizimin me eficiencë, brenda afateve dhe sipas standardeve teknike të kërkuara, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë kapacitetet logjistike dhe mekanike të mjaftueshme. Kërkesa për gazelone dhe kamionçina me kapacitete të përcaktuara lidhet drejtpërdrejt me nevojën për transportin e përditshëm të materialeve, pajisjeve, mbetjeve bimore dhe stafit në terren. Numri i kërkuar është vlerësuar në raport me shtrirjen territoriale të shërbimit dhe frekuencën e ndërhyrjeve, me qëllim garantimin e vazhdimësisë dhe mosndërprerjes së shërbimit.

Autoboti i ujit është i domosdoshëm për ujitjen e sipërfaqeve të gjelbra, veçanërisht gjatë periudhave të thata, kur kërkohet ndërhyrje e menjëhershme për ruajtjen e gjendjes së bimësisë. Autokulla me vinç dhe kosh është e nevojshme për kryerjen e punimeve të krasitjes në lartësi dhe ndërhyrjeve në pemë dekorative apo të larta, duke garantuar sigurinë e punonjësve dhe të qytetarëve. Gjeneratori siguron furnizim alternativ me energji në raste ndërhyrjesh në zona pa akses të drejtpërdrejtë në rrjet elektrik. Mini fadroma dhe zetori janë të domosdoshëm për sistemin e terrenit, transportin e materialeve në zona të vështira dhe realizimin e punimeve të mbjelljes apo zëvendësimit të shtresave të dheut. Makineria për hidrombjelljen e barit në sipërfaqe të pjerrëta është kërkuar duke marrë në konsideratë karakteristikat topografike të zonave urbane ku shërbimi do të zbatohet, ku metoda tradicionale e mbjelljes nuk është

gjithmonë e zbatueshme. Kjo pajisje garanton mbulim uniform, stabilizim të terrenit dhe eficiencë në realizim. Veglat krasitëse, pompat spërkatëse, korrëset e barit dhe sharrat e krasitjes janë pajisje bazë operative për realizimin e shërbimit të përditshëm të mirëmbajtjes. Numri i kërkuar është proporcional me nevojën për organizim të disa ekipeve paralele në terren, me qëllim përmbushjen e grafikut të punimeve dhe reagimin në kohë ndaj situatave emergjente. Kërkesa që mjetet të jenë në pronësi ose me qira garanton fleksibilitet dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi u jep mundësi operatorëve ekonomikë të përmbushin kriterin përmes formave të ligjshme të disponimit. Parashikimi që kontratat e qirasë të jenë noteriale, specifike për objektin dhe me afat të vlefshëm për gjithë kohëzgjatjen e kontratës, synon të shmangë deklaratimet formale dhe të sigurojë disponueshmëri reale të mjeteve gjatë ekzekutimit të saj. Kërkesa për dokumentacion provues, përfshirë lejet e qarkullimit, certifikatat e kontrollit teknik, siguracionin e vlefshëm, taksat përkatëse dhe, në rastin e autokullës, raportin e inspektimit të krahut ngritës për punime në lartësi, është e lidhur drejtpërdrejt me garantimin e sigurisë në punë, ligjshmërisë së përdorimit të mjeteve dhe mbrojtjes së interesit publik. Për mjetet e paregjistruara në regjistra publikë, kërkesa për akte çdoganimi ose fatura tatimore siguron transparencë mbi pronësinë dhe origjinën e pajisjeve. Kërkesa për pajisje të mbrojtjes në punë për punonjësit është në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë VKM nr. 312, datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier , i ndryshuar. Duke qenë se shërbimi përfshin punime në lartësi, përdorim makinerish dhe pajisjesh prerëse, si dhe ndërhyrje në mjedis të hapur, garantimi i pajisjeve mbrojtëse është thelbësor për parandalimin e aksidenteve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore të punëdhënësit. E drejta e rezervuar e Autoritetit Kontraktor për të kryer verifikim fizik të disponueshmërisë së mjeteve në çdo kohë është një masë kontrolli që synon të sigurojë vërtetësinë e deklaratimeve dhe gatishmërinë reale të operatorit për zbatimin e kontratës. Kërkesat dokumentare janë të arsyeshme dhe të nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të kontratës, sigurinë publike dhe respektimin e legjislacionit në fuqi. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatori ekonomik fitues të ketë kapacitetin real logjistik, teknik dhe organizativ për realizimin e plotë, cilësor dhe të sigurt të shërbimit të gjelbërimit.

Lidhur me kërkesën e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e një Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1-3 ton kërkojmë modifikimin e këtij kriteri sipas kuadrit ligjor në fuqi. Më konkretisht parashitrojmë si vijon: Në nenin 54 Automjetet të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998 Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë parashikohet si vijon:

1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove.

Automjetet ndahen në:

- a) Autovetura: mjete të destinuara për transport njerëzish, që kanë maksimumi nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;
- b) Autobus: mjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;

- c) Automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit;
- d) Kamion: mjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave;
- e) Tërheqës: mjet i destinuar vetëm për tërheqjen e rimorkiove ose gjysmërimorkiove;
- f) Automjet për transport të veçantë: mjet transporti i destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përhershme, me mekanizma specialë që i shërbejnë këtij qëllimi;
- g) ?????..
- h)????..

Referuar këtij përcaktimi ligjor rezulton se Ligji Organik pra Kodi Rrugor, në rastin konkret përkufizimin e mjetit të autorizuar për transportin e mallrave e cilëson: Kamion . Ndërkohë termi i përdorur nga ana juaj kamioncinë nuk gjen asnjë mbështetje ligjore dhe për pasojë nuk mund të kërkohet si kriter i veçantë kualifikimi. Sjellim në vëmendjen tuaj se neni 77, pika 4 të Ligjit të Prokurimit Publik, përcakton se: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie Më tej akoma neni 41 i VKM nr. 285, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikpërcakton se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Bazuar në sa mësipër rezulton e qartë se kërkesa juaj për të paraqitur mjetin Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1-3 ton është e pambështetur ligjërisht e për pasojë duhet të modifikohet duke respektuar kërkesat dhe parashikimet e Kodit Rrugor. Përsa mësipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri.

Pika 7.

Në Shtojcën 7, Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar që: Oferta e operatorit ekonomik duhet të shoqërohet me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar . Lidhur me këtë kërkesë të Autoritetit Kontraktor, ju bëjmë me dije se ajo është totalisht e paligjshme, e pambështetur ligjërisht, dhe diskriminuese duke kufizuar në mënyrë drastike konkurrencën dhe garën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë konkurrues për këtë procedurë prokurimi. Më konkretisht argumentojmë si vijon: Në nenin 34 Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se: 1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale

që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit. 2. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit të këtij ligji, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive. Metodatat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

Më tej Akoma në nenin 12 Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik përcaktohet si vijon:

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti/enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit.

2. Autoriteti/enti kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, konverton vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor vendos dhe kursin e këmbimit të përdorur prej tij.

3. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë.

4. Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit ?. Referuar këtyre parashikimeve ligjore si mësipër cituar, rezulton e qartë se detyrimi për përllogaritjen e vlerës së kontratës duke analizuar koston për çdo zë apo element të kontratës është vetëm i Autoritetit Kontraktor dhe kurrsesi nuk mund të jetë detyrim për OE konkurrues në një garë.

Në vijim, në nenin 29 Oferta ekonomike të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik përcaktohet si vijon:

1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.

2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.

Sjellim në vëmendje të Autoritetit Kontraktor se kërkesa e tij për shoqërimin e ofertës me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar, është një kërkesë që bie në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenin 29 të VKM 285. Kjo kërkesë është abuzive, diskriminuese dhe

është në kundërshtim me të paktën 4 nga qëllimet e ligjit të prokurimit publik dhe konkretisht qëllimet që:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Po kështu, ky kriter i paligjshëm dhe diskriminues bie në kundërshtim të hapur me nenin 3 Parime të përgjithshme të Ligjit 162/2020 ku parashikohet se: 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Sjellim në vëmendje të AK se rasti i vetëm kur mund të kërkohet analiza e koston së ofertës ekonomike (dhe jo për çdo zë të ofertës) është ai rast kur Oferta e Paraqitur nga Operatori Ekonomik konkurrues rezulton të jetë Anomalisht e Ulët sipas parashikimeve të nenit 93 të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik dhe nenit 82 të VKM 285 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik . Në çdo rast tjetër kërkesa e AK për shoqërimin e ofertës me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar, është e paligjshme, qartazi abuzive dhe tregon nivelin e paditurisë së Autoritetit Kontraktor. Referuar gjithë parashikimeve ligjore të sipërcituara kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë nga Shtojca 7, Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit.

Pika 8.

Pasi jemi njohur me gjithë dosjen e tenderit përfshirë kriteret e kualifikimit, termat e referencës, grafikun e punimeve, preventivat dhe specifikimet teknike të publikuara për këtë procedurë prokurimi, vlerësojmë se me qëllim hartimin e një oferte të plotë teknike, financiare dhe ligjore është e nevojshme që AK të publikojë dhe të na vëri në dispozicion hartat dhe plan-vendosjen e objekteve sipas sistemit kordinativ shtetëror KRGJSH 2010. Ky informacion është shumë i nevojshëm me qëllim që ne të ndërtojmë një panoramë të qartë lidhur me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke llogaritur kostot tona të brendshme të gjithë volumeve të punimeve. Sjellim në vëmendje se në nenin 36 Specifikimet teknike të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik përcaktohet se: 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të

marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Ndërsa në nenin 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik parashikohet se: Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

Bazuar në kuadrin ligjor si mësipër cituar, si dhe referuar argumenteve të cituara, me qëllim hartimin dhe paraqitjen e një oferte objektive e konkurruese ju bëjmë me dije se është shumë e nevojshme paraqitja nga Autoriteti Kontraktor e informacionit lidhur me dispozicion hartat dhe plan-vendosjen e objekteve sipas sistemit kordinativ shtetëror KRGJSH 2010. Vetëm kështu do të respektohet qëllimi dhe parimet e përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të LPP duke konkurruar në mënyrë të drejtë dhe të ndershme. Përsa mësipër kërkojmë marrjen parasysht të kësaj kërkesë dhe vendosjen në dispozicion të hartave dhe plan-vendosjeve të objekteve sipas sistemit kordinativ shtetëror KRGJSH 2010.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me anë të shkresës nr. 257/14 prot., datë 03.04.2025, me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesës së OE Albgarden shpk” protokolluar me tonën me nr. 923/1 prot., datë 03.04.2026 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku nga verifikimi në brendësi të informacionit konstatohet, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues janë pranuar pjesërisht si më poshtë vijon:

Në zbatim të shkresës tuaj nr. 257/10 prot datë 27.03.2026 dhe shkresës nr. 257/13 prot, date 02.04.2026, morëm në shqyrtim ankesën e O.E. Albgarden shpk të paraqitur për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra”, REF-79017-03-12-2026 dhe fond limit 149,998,577.16 lekë pa TVSH.

Pasi shqyrtuam në tërësi ankesën, arritëm në këto konkluzione:

Në lidhje me pikën e ankesës se paraqitur nga shoqëria Albgarden sh.p.k., lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 te Shtojcës 9 “Formulari i kriterëve të perzgjedhjes/kualifikimit”,

KSHA-ja, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe verifikimit të bazës ligjore në fuqi, vlerëson se kjo ankesë është e bazuar dhe duhet pranuar, pasi konstatohet se në formulimin e kriterit është përdorur një kod i pasaktë i mbetjeve, konkretisht “17 5 04”, i cili nuk përputhet me përcaktimet e bëra në VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, ku kodi i saktë është “17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03” , dhe kjo pasaktësi, megjithëse mund të konsiderohet si lapsus material, krijon paqartësi në interpretimin dhe zbatimin e kriterit nga operatorët ekonomikë, si dhe mund të ndikojë në mënyrë të padrejte në procesin e kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave, KSHA-ja pranon kërkesën e ankuesit për modifikimin e kriterit duke saktësuar kodin përkatës të mbetjeve në përputhje me katalogun zyrtar, pa ndryshuar thelbin e kërkesës për disponimin e licencës përkatëse.

Në lidhje me pikën 2 të ankesës së paraqitur nga shogëria Albgarden sh.p.k., që kundërshton kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.3 të Shtojcës 9 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, KSHA-ja, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe analizimit të bazës ligjore dhe teknike, vlerëson se kjo ankesë nuk është e bazuar dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet, pasi kërkesa për paraqitjen e licencës së leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (OKL) me Kod II.4 “Prodhimi dhe tregtimi i farave dhe fidanëve” është në përputhje të plotë me objektin e kontratës dhe natyrën e shërbimeve që do të realizohen, duke qenë se kontrata parashikon në mënyrë të drejtëperdrejtë furnizimin, mbjelljen dhe mirembajtjen e një numri të konsiderueshëm fidanesh dekorative, shkurresh dhe sipërfaqesh të gjelbra, çka e bën të domosdoshme që operatori ekonomik të ketë kapacitete të provuara dhe të licencuara për sigurimin e materialit biologjik të certifikuar dhe në përputhje me standardet fitosanitare dhe mjedisore në fuqi, nderkohe që kjo kërkesë nuk përben një kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi nuk i detyron operatorët ekonomikë të jenë domosdoshmërisht prodhues të drejtëperdrejtë, por garanton që ata të operojnë në mënyrë të ligjshme dhe të kontrolluar në tregun e farave dhe fidanëve, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe cilësinë e produkteve të përdorura në realizimin e kontratës, si dhe duke minimizuar rreziqet që lidhen me përdorimin e materialeve të pakontrolluara që mund të dëmtojnë mjedisin ose të cenojnë qëndrueshmërinë e investimit publik, për më tepër, vendosja e këtij kriteri mbështetet në dispozitat përkatëse të legjislacionit për prokurimin publik, konkretisht nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 41 të VKM nr. 285/2021, të cilat i japin Autoritetit Kontraktor të drejtën të kërkojë prova mbi kapacitetet teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, në funksion të garantimit të realizimit cilësor të kontratës, ndaj në këto kushte kërkesa për heqjen e këtij kriteri vlerësohet e pajuzuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Në lidhje me pikën 3 të ankesës së paraqitur nga shoqëria AlbGarden sh.p.k., që kundërshton kërkesën për paraqitjen e licencës profesionale N.S-18 A “Punime topogjeodezike”, KSHA-ja, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe analizimit të dokumentacionit të procedurës, vlerëson se kjo ankesë nuk është e bazuar dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet, pasi kërkesa për disponimin e kësaj licence është në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, e cila, megjithëse

klasifikohet si kontratë shërbimi, përfshin ndërhyrje të shumta në terren që kërkojnë vlerësime të sakta të konfigurimit të hapësirave, përfshirë zona kodrinore, sipërfaqe të pjerrta dhe ambiente urbane me ndjeshmëri të lartë, ku pozicionimi, sistemimi dhe stabilizimi i elementeve të gjelbërimit nuk mund të realizohen në mënyre profesionale pa pasur njohuri dhe kapacitete bazë në matje dhe orientim topografik, ndërkohë që licenca në fjalë nuk kërkohet për realizimin e shërbimeve të mirëfillta topogjeodezike në kuptimin e plotë teknik, por si provë e kapaciteteve minimale të operatorit për të menaxhuar saktë ndërhyrjet në terren, për më tepër, fakti që sipërfaqet janë përgjithësisht të identifikuar nga Autoriteti Kontraktor nuk përjashton nevojën që operatori ekonomik të ketë aftësi për verifikime, përshtatje dhe zbatim korrekt në terren gjatë ekzekutimit të kontratës, veçanërisht në rastet kur kërkohen ndërhyrje në zona me relief të ndryshëm apo me kufizime fizike, si dhe për të garantuar shmangien e dëmtimeve të infrastrukturës ekzistuese dhe perputhshmërinë me parametrat teknikë të kërkuar, gjithashtu vendosja e këtij kriteri mbështetet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenin 41 të VKM nr. 285/2021, të cilat i japin Autoritetit Kontraktor të drejtën të percaktojë kërkesa që lidhen me kapacitetet teknike dhe profesionale në funksion të realizimit cilësor të kontratës, dhe në këtë kuptim, kërkesa për licencën N.S-18 A nuk përben kriter të paligjshëm apo diskriminues, por një masë të arsyeshme dhe proporcionale për të garantuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë nivelin e duhur të profesionalizimit për të realizuar ndërhyrjet në mënyrë të sigurt, të saktë dhe në përputhje me standardet përkatëse, për rrjedhojë kërkesa për heqjen e këtij kriteri vlerësohet e pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Në lidhje me pikën 4 të ankesës së paraqitur nga shoqëria Albgarden sh.p.k., që kundërshton kërkesat e percaktuara në pikën 2.3.2 të Shtojcës 9 për kualifikimin e Drejtuesit Teknik, Autoriteti Kontraktor, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe analizimit të kuadrit ligjor dhe teknik, vlerëson se kjo ankese nuk është e bazuar dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet, pasi kërkesat për kualifikimet specifike të drejtuesit teknik janë të lidhura drejtperdrejt me natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve që do të realizohen, të cilat nuk kufizohen thjesht në mirembajtje rutinë, por përfshijnë ndërhyrje të konsiderueshme në elemente drusorë, zona me karakter natyror dhe gjysmë-natyor, si dhe përdorimin e praktikave profesionale që kanë ndikim të drejtperdrejtë në mjedis, biodiversitet dhe sigurinë publike, për rrjedhojë kërkesa që drejtuesi teknik të jete inxhinier pyjesh dhe i pajisur me certifikime përkatëse synon të garantojë që këto ndërhyrje të kryhen mbi baza shkencore dhe në përputhje me standardet profesionale dhe legjislativën mjedisore në fuqi, ndërkohë që kërkesa për certifikim në fushën e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe auditimit mjedisor nuk lidhet domosdoshmërisht me zhvillimin e një procedure të plote formale të VKM-se, por me aftësinë profesionale për të vlerësuar dhe menaxhuar ndikimet mjedisore gjatë zbatimit të kontratës, duke qenë se aktivitetet e parashikuara, si ndërhyrjet në zona kodrinore, trajtimet fitosanitare dhe menaxhimi i masiveve bimore, mbartnin potencial për ndikime mjedisore që duhet të parandalohen dhe kontrollohen në mënyrë profesionale, gjithashtu kërkesa për certifikimin si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave nuk duhet interpretuar si delegim i funksionit të supervizimit në kuptimin institucional,

por si nje tregues i nivelit te larte te kualifikimit dhe përgjegjesisë profesionale t drejtuesit teknik per mbikëqyrjen e brendshme te zbatimit te punimeve nga vete operatori ekonomik, çka eshte nje praktikë e zakonshme per garantimin e cilesise dhe perputhshmërisë teknike, pa cënuar rolin e Autoritetit Kontraktor ne mbikëqyrjen e kontratës, per më teper këto kërkesa janë vendosur ne mëshetje te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 41 të VKM nr. 285/2021, të cilat lejojne percaktimin e kriterëve që garantojnë kapacitetin teknik dhe profesional te operatoreve ekonomike ne raport me objektin e kontrates, dhe ne këtë kuptim ato nuk perbejne kufizim të pajustificuar te konkurrencës, por nje mekanizëm per te siguruar realizimin cilësor, te sigurt dhe ne perputhje me standardet mjedisore te sherbimit, per rrjedhoje kerkesa per heqjen e ketyre kriterëve vleresohet e pabazuar si ne aspektin ligjor ashtu edhe ne ate teknik.

Në lidhje me pikën 5 te ankeses se paraqitur nga shoqeria Alb garden sh.p.k., qe kundërshton formulimin e kriterit te percaktuar në pikën 2.3.5 te Shtojcës 9, KSHA-ja, pas shqyrtimit te pretendimeve dhe analizimit te kuadrit ligjor në fuqi, vlereson se kjo ankese nuk eshte e bazuar dhe per rrjedhoje nuk mund te pranohet, pasi kerkesa per pajisjen me certifikate fitosanitare te brendshme ose lidhjen e një kontrate furnizimi me një subjekt te pajisur me këtë certifikate eshte në perputhje me natyren e kontrates dhe synon garantimin e cilesise dhe sigurise se materialit bimor që do te perdoret gjat realizimit te shërbimit, duke enë se aktivitetet e parashikuara perfshijne në menyre te drejtperdrejte furnizimin, mbjelljen dhe trajimin e bimesise dekorative dhe drurëve ornamentale, te cilat duhet te jenë te kontrolluara nga pikëpamja fitosanitare per te shmangur perhapjen e semundjeve dhe demtuesve, nderkohe që pretendimi i ankuesit mbi nevojën per një formulim më te detajuar sipas akteve te veçanta nënligjore nuk e bën kriterin ekzistues te paligjshëm apo të pazbatueshëm, pasi kërkesa e Autoritetit Kontraktor është formuluar në mënyre te përgjithshme dhe funksionale, duke iu referuar konceptit të certifikimit fitosanitar sipas legjislacionit në fuqi, pa përjashtuar apo kundërshtuar zbatimin e dispozitave specifike të ligjit nr. 10416/2011 dhe VKM nr. 523/2016 gjatë fazës së zbatimit të kontratës, për më teper, kriteri është ndertuar në mënyrë proporcionale dhe jo diskriminuese, duke lejuar qe operatorët ekonomikë ta përmbushin ate jo vetëm përmes disponimit te drejtperdrejte te certifikates, por edhe përmes marrëdhënieve kontraktore me subjekte të autorizuar, çka zgjeron mundësinë e pjesëmarrjes dhe garanton respektimin e parimit të konkurrencës së lirë, ndërkohë qe qëllimi kryesor i këtij kriteri mbetet sigurimi i burimeve të kontrolluara dhe të certifikuara të materialit bimor, në funksion te mbrojtjes së mjedisit dhe realizimit cilësor të kontratës, për rrjedhojë kerkesa për modifikimin e këtij kriteri vlerësohet e pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Në lidhje me pikën 6 te ankesës së paraqitur nga shoqëria Alb garden sh.p.k., që kërkon modifikimin e kriterit te percaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 9, KSHA-ja, pas shqyrtimit te pretendimeve dhe analizimit të kuadrit ligjor në fuqi, vlerëson se kjo ankese është pjesërisht e bazuar dhe duhet pranuar vetëm në lidhje me saktësimin terminologjik te mjetit te kërkuar si “kamionçinë”, pasi konstatohet se ky term nuk është i parashikuar shprehimisht në perkufizimet

e dhena nga Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i cili përdor termin “kamion” si kategori për mjetet e destinuar për transport mallrash, dhe në këtë kuptim, për të shmangur çdo paqartësi apo interpretim të ndryshëm nga operatorët ekonomikë dhe për të garantuar përputhshmërinë e plotë me terminologjinë ligjore në fuqi, është e arsyeshme që ky element i kriterit të riformulohet duke përdorur terminologjinë e saktë ligjore, pa ndryshuar thelbin dhe qëllimin e kërkesës për disponimin e mjeteve transportuese me kapacitet të përshtatshëm për realizimin e kontratës, ndërkohë që pjesa tjetër e kriterit që lidhet me numrin, llojin dhe dokumentacionin e mjeteve dhe pajisjeve vlerësohet e drejtë, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës, duke qenë se garanton kapacitetin logjistik dhe teknik të operatorit ekonomik për realizimin cilësor dhe në kohë të shërbimeve të kërkuara, për rrjedhojë kërkesa e ankuesit pranohet vetëm në këtë aspekt të kufizuar dhe Autoriteti Kontraktor do të procedojë me saktësimin përkatës të dokumenteve të tenderit.

Në lidhje me pikën 7 të ankesës së paragitur nga shoqëria Albgarden sh.p.k., që kundërshton kërkesën për paraqitjen e analizës së detajuar për çdo zë të ofertës, KSHA-ja, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe interpretimit të kuadrit ligjor në fuqi, vlerëson se kjo ankesë nuk është e bazuar dhe për rrjedhojë nuk mund të pranohet, pasi kërkesa për paraqitjen e analizës së detajuar të zërave të ofertës nuk përbën detyrim për perlllogaritjen e vlerës së kontratës në kuptimin e nenit 34 të Ligjit nr. 162/2020, i cili i referohet fazës së përcaktimit të fondit limit nga Autoriteti Kontraktor, por lidhet me nevojën për të vlerësuar seriozitetin, realizueshmërinë dhe qëndrueshmërinë ekonomike të ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë, në funksion të garantimit të zbatimit korrekt të kontratës, ndërkohë që kjo kërkesë nuk bie në kundërshtim me nenin 29 të VKM nr. 285/2021, pasi nuk cenon pavarësinë e operatorit ekonomik në hartimin e ofertës ekonomike, por thjesht kërkon transparencë dhe argumentim të strukturës së kostos së saj, çka është një praktikë e njohur dhe e pranuar për të shmangur oferta jorealiste apo të pazbatueshme në praktikë, për më tepër kjo kërkesë nuk lidhet ekskluzivisht me rastet e ofertave anomalisht të ulëta, pasi Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë elementë shtesë sqarues që në fazën e paraqitjes së ofertës në funksion të një vlerësimi sa më të plotë dhe objektiv të tyre, pa cenuar parimet e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, duke qenë se kërkesa zbatohet njësoj për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe nuk favorizon apo diskriminon asnjë subjekt të veçantë, si dhe duke pasur parasysh kompleksitetin e shërbimeve të kërkuara dhe numrin e zërave që përbëjnë kontratën, paraqitja e një analize të detajuar ndihmon në verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me kërkesat teknike dhe në parandalimin e problematikave gjatë fazës së zbatimit të kontratës, për rrjedhojë kërkesa e ankuesit heqjen e këtij kriteri vlerësohet e pabazuar si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë teknik.

Ne lidhje me kërkesën e operatorit ekonomik për vendosjen në dispozicion të hartave dhe plan-vendosjeve sipas sistemit koordinativ shtetëror KRGJSH 2010, Autoriteti Kontraktor sqaron se nuk është e mundur të plotësohet kjo kërkesë. Operatorët ekonomikë janë të obliguar të bazohen në dokumentacionin e dhënë nga Autoriteti Kontraktor dhe të hartojnë ofertën e tyre teknike dhe

financiare duke u mbeshtetur në informacionin aktualisht te disponueshëm në dosjen e tenderit. Ky informacion përfshin termat e referencës, specifikimet teknike, preventivat dhe grafikun e punimeve, te cilat janë mjaftueshem te detajuara per te mundesuar hartimin e një oferte konkurruese dhe të plotë.

Sa më sipër, bazuar në nenin 114 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 102 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Regullarve të Prokurimit Publik” te ndryshuar, Komisioni i ngarkuar per Shqyrtimin e Ankesave:

Vendosi:

- 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së parqitur nga OE “Albgarden” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin te njoftojë per vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi pergjegjës për prokurimin te njoftojë per vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme te punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor.*

II.5. Me shkresën nr. 1149/1 prot, datë 17.04.2026, me objekt “Argumentim shtesë për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK pranë autoritetit kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra” me nr. REF-79017-03-12-2026, parashikuar për tu zhvilluar në datë 17.04.2026 ora 10:00”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 923/2 prot, datë 20.04.2026, si dhe shkresës nr. 1149/1 prot, datë 17.04.2026, me objekt “Argumentim shtesë për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK pranë autoritetit kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra” me nr. REF-79017-03-12-2026, parashikuar për tu zhvilluar në datë 17.04.2026 ora 10:00”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 923/3 prot, datë 21.04.2026 operatori ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK ka paraqitur argumenta shtesë për ankimin nr. A/2026/6456, datë 26.03.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me argumentin se: “Pika 1. Në Shtojcën 9, Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nën-pika 2.1.1 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kategoria III.2 Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis: nënkategoria III.2.B për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, kodi: 17 5 04 dhera dhe gurë të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kriteve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Kjo licencë është e domosdoshme, pasi shërbimi i mirëmbajtjes së gjelbërimit përfshin edhe menaxhimin, grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane, përfshirë materialet inertë si dhe dherat dhe gurët e përmendur në kodet e licencës. Prania e licencës garanton që operatori ekonomik është i certifikuar dhe i autorizuar për kryerjen e këtyre shërbimeve në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe normat e sigurisë. Licenca e Kategorisë III.2 siguron që operatori ekonomik plotëson kriteret teknike, kapacitetet profesionale dhe standardet administrative të kërkuara për ofrimin e shërbimeve me ndikim në mjedis, duke përfshirë aspektet e menaxhimit të mbetjeve dhe monitorimit të ndikimit mjedisor. Kërkesa për licencë të vlefshme nga QKL është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare për shërbime me ndikim në mjedis, dhe përbën një kriter proporcional dhe të domosdoshëm për garancinë e realizimit të shërbimit në mënyrë profesionale dhe ligjore. Kriteri 2.1.1 është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës duke garantuar që operatori ekonomik ka kapacitetet dhe autorizimet e nevojshme për realizimin korrekt të shërbimit të gjelbërimit, përfshirë grumbullimin dhe transportin e mbetjeve urbane. Lidhur me kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në pikën 2.1.1 për paraqitjen e licencës së vlefshme të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL), Kategoria III.2 Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis: nënkategoria III.2.B për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane, kodi: 17 5 04 dhera dhe gurë të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03 kërkojmë modifikimin e këtij kriteri. Më konkretisht sqarojmë Autoritetin Kontraktor se në VKM nr. 402, datë datë 30.6.2021 Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve në fq 17 përcaktohen kodet përkatëse të Mbetjeve nga Ndërtimet dhe Prishjet (Përfshi Dhera të Gërmuara nga Zona të Kontaminuara). Lidhur me Kodin e kërkuar nga AK me nr. 17504 në kriterin 2.1.1, referuar Katalogut të Mbetjeve rezulton se ky Kod nuk ekziston, ndërkohë që Kodi i saktë i parashikuar nga Katalogu i Mbetjeve është: 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03. Ne e kuptojmë faktin se ndoshta mund të jetë një lapsus i lehtë i AK por nga ana tjetër, me qëllim hartimin në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e më pas vlerësimin korrekt e në përputhje me Ligjin e Prokurimit të ofertave të paraqitura, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke vendosur numrin e saktë të Kodit të Mbetjeve sipas përcaktimit të katalogut të mbetjeve të miratuar me VKM nr. 402, datë datë 30.6.2021 Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve. Sa

mësipër, kërkojmë ndryshimin e kriterit duke përcaktuar numrin e saktë të Kodit të Mbetjeve dhe konkretisht duke saktësuar kodin: 17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr. 257/14 prot., datë 03.04.2025, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesës së OE Albgarden shpk*” protokolluar me tonën me nr. 923/1 prot., datë 03.04.2026 (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike), autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, ku nga verifikimi i tij konstatohet, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimes janë pranuar pjesërisht si më poshtë vijon:

Në zbatim të shkresës tuaj nr. 257/10 prot datë 27.03.2026 dhe shkresës nr. 257/13 prot, date 02.04.2026, morëm në shqyrtim ankesën e O.E. Albgarden shpk të paraqitur për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra”, REF-79017-03-12-2026 dhe fond limit 149,998,577.16 lekë pa TVSH.

Pasi shqyrtuam në tërësi ankesën, arritëm në këto konkluzione:

Në lidhje me pikën e ankesës se paraqitur nga shoqëria Albgarden sh.p.k., lidhur me kriterin e përcaktuar në pikën 2.1.1 te Shtojcës 9 “Formulari i kriterëve të perzgjedhjes/kualifikimit”, KSHA-ja, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe verifikimit të bazës ligjore në fuqi, vlerëson se kjo ankesë është e bazuar dhe duhet pranuar, pasi konstatohet se në formulimin e kriterit është përdorur një kod i pasaktë i mbetjeve, konkretisht “17 5 04”, i cili nuk përputhet me përcaktimet e bëra në VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, ku kodin e saktë është “17 05 04 Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03” , dhe kjo pasaktësi, megjithëse mund të konsiderohet si lapsus material, krijon paqartësi në interpretimin dhe zbatimin e kriterit nga operatorët ekonomikë, si dhe mund të ndikojë në mënyrë të padrejtë në procesin e kualifikimit dhe vlerësimit të ofertave, KSHA-ja pranon kërkesën e ankuesit për modifikimin e kriterit duke saktësuar kodin përkatës të mbetjeve në përputhje me katalogun zyrtar, pa ndryshuar thelbin e kërkesës për disponimin e licencës përkatëse.

Në lidhje me pikën 6 te ankesës së paraqitur nga shoqëria Albgarden sh.p.k., që kërkon modifikimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.6 të Shtojcës 9, KSHA-ja, pas shqyrtimit të pretendimeve dhe analizimit të kuadrit ligjor në fuqi, vlerëson se kjo ankesë është pjesërisht e bazuar dhe duhet pranuar vetëm në lidhje me saktësimin terminologjik të mjetit të kërkuar si “kamionçinë”, pasi konstatohet se ky term nuk është i parashikuar shprehimisht në përkufizimet e dhena nga Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i cili përdor termin “kamion” si kategori për mjetet e destinuar për transport mallrash, dhe në këtë kuptim, për të shmangur çdo paqartësi apo interpretim të ndryshëm nga operatorët ekonomikë dhe për të garantuar përputhshmërinë e plotë me terminologjinë ligjore në fuqi, është e arsyeshme që ky element i kriterit të riformulohet duke përdorur terminologjinë e saktë ligjore, pa ndryshuar thelbin dhe

qëllimin e kërkesës për disponimin e mjeteve transportuese me kapacitet të përshtatshëm për realizimin e kontrates, ndërkohë që pjesa tjetër e kriterit që lidhet me numrin, llojin dhe dokumentacionin e mjeteve dhe pajisjeve vlerësohet e drejtë, proporcionale dhe e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës, duke qenë se garanton kapacitetin logjistik dhe teknik të operatorit ekonomik për realizimin cilësor dhe në kohë të shërbimeve të kërkuara, për rrjedhojë kërkesa e ankuesit pranohet vetëm në këtë aspekt të kufizuar dhe Autoriteti Kontraktor do të procedojë me saktësimin përkatës të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër, bazuar në nenin 114 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 102 të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Regullarve të Prokurimit Publik” të ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave:

Vendosi:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga OE “Albgarden” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:
 - i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;
 - ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;
- b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë

të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Duke qenë, se pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues në lidhje saktësimin e kodit perkatës të mbetjeve në përputhje me katalogun zyrtar si dhe saktësimin terminologjik të mjetit të kërkuar si “kamionçinë”, pasi konstatohet se ky term nuk është i parashikuar shprehimisht në perkufizimet e dhena nga Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i cili përdor termin “kamion” si kategori për mjetet e destinuara për transport mallrash, dhe në këtë kuptim, për të shmangur çdo paqartësi apo interpretim të ndryshëm nga operatorët ekonomikë dhe për të garantuar përputhshmërinë e plotë me terminologjinë ligjore në fuqi, është e arsyeshme që ky element i kriterit të riformulohet duke përdorur terminologjinë e saktë ligjore janë pranuar nga ana e autoriteti kontraktor Komisioni Prokurimit Publik do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto dy pretendime të operatorit ekonomik ankimues. Gjithashtu Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, duhet të hartojë dhe publikojë shtojcën e modifikuar, me qëllim që si operatori ekonomik ankimues dhe të gjithë operatorët ekonomik të interesuar, që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të njihen me këto modifikime. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK, për modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se: “Pika 2. Në Shtojcën 9, Formular i Kriteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.1.3 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Prodhimi dhe tregëtimi i farave dhe fidanëve (Kodi II.4). Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kriteve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar). Ky kriter është i domosdoshëm, pasi kontrata përfshin mbjellje dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve të

gjelbra, përfshirë mbi 2,700 fidanë dekorativë, shkurre dhe fidanë të rinj, si dhe mbjellje bari në rreth 42,000 m² sipërfaqe. Për të garantuar që bimët dhe fidanët e përdorur janë të certifikuar, të shëndetshëm, të përshtatshëm për klimat dhe tokat vendore, është e nevojshme që operatori të ketë licencën përkatëse të prodhimit dhe tregtimit të farave dhe fidanëve. Licenca e lëshuar nga QKL (Kodi II.4) siguron që operatori posedon kapacitete ligjore dhe teknike për furnizim me fidanë dhe fara të cilësisë së certifikuar, duke garantuar integritetin biologjik të bimëve, përshtatshmërinë për ambientin urban dhe natyror, dhe respektimin e standardeve mjedisore dhe fito sanitare. Kjo redukton rrezikun e sëmundjeve ose problemeve mjedisore nga bimët e importuara ose të paprovuara. Dokumentacioni i kërkuar, përfshirë licencën, garanton që operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht dhe i kualifikuar për aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të bimëve, duke shmangur përdorimin e burimeve të paautorizuara dhe duke siguruar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet me standarde profesionale. Kriteri është proporcional me objektin e kontratës, i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për furnizim të sigurt dhe cilësor me bimë dhe fidanë, dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës. Ai siguron që operatorët që marrin pjesë kanë kapacitet të ligjshëm dhe teknik për të përmbushur kërkesat e shërbimit. Ky kriter është i domosdoshëm pasi garanton realizimin e shërbimit të gjelbërimit me përdorim të bimëve dhe fidanëve të certifikuar dhe të autorizuar. Lidhur me kriterin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e Licencës me Kod II.4, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi ky kriter është i paligjshëm. Më konkretisht, sqarojmë se në VKM nr. 34 datë 22.01.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.538 datë 26.05.2009 Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta, të ndryshuar, rezulton se në pikën 2 është shfuqizuar Kategoria II.4, Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor), e fushës II, Ushqimi dhe shëndeti. Sjellim në vëmendje të Autoritetit Kontraktor se në nenin 77 Kërkesat për kualifikim të Ligjit të Prokurimit Publik përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Më tej akoma, në pikën 2 po të nenit 77 parashikohet se: 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. Ndërsa në nenin 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, pika 4, të VKM 285 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik përcaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca

profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; Referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, rezulton se Autoriteti Kontraktor ka të drejtën ligjore e përcaktimit të kërkesave lidhur me përshtatshmërinë profesionale, por nga ana tjetër këto kërkesa duhet të jenë të bazuara në kuadrin ligjor në fuqi. Duke qenë se me VKM nr. 34 datë 22.01.2020 është shfuqizuar Licenca e lëshuar nga QKL për Kodin II.4, Kategoria II.4, Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor), e fushës II, Ushqimi dhe shëndeti , në këto kushte, vlerësojmë se kërkesa e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e kësaj license është e pambështetur ligjërisht, e për pasojë duhet të hiqet si kriter”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9/2, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.1.3 “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) “Prodhimi dhe tregtimi i farave dhe fidanëve” (Kodi II.4).

III.2.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Ky kriter është i domosdoshëm, pasi kontrata përfshin mbjellje dhe mirëmbajtje të sipërfaqeve të gjelbra, përfshirë mbi 2,700 fidane dekorative, shkurre dhe fidanë të rinj, si dhe mbjellje bari në rreth 42,000 m² sipërfaqe. Për të garantuar që bimët dhe fidanët e përdorur janë të certifikuar, të shëndetshëm, të përshtatshëm për klimat dhe tokat vendore, është e nevojshme që operatori të ketë licencën përkatëse të prodhimit dhe tregtimit të farave dhe fidanëve.

Licenca e lëshuar nga QKL (Kodi II.4) siguron që operatori posedon kapacitete ligjore dhe teknike për furnizim me fidanë dhe fara të cilësisë së certifikuar, duke garantuar integritetin biologjik të bimëve, përshtatshmërinë për ambientin urban dhe natyror, dhe respektimin e standardeve mjedisore dhe fitosanitare. Kjo redukton rrezikun e sëmundjeve ose problemeve mjedisore nga bimët e importuara ose të paprovuara. Dokumentacioni i kërkuar, përfshirë licencën, garanton që operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht dhe i kualifikuar për aktivitetet e prodhimit dhe tregtimit të bimëve, duke shmangur përdorimin e burimeve të paautorizuara dhe duke siguruar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet me standarde profesionale. Kriteri është proporcional me objektin e kontratës, i lidhur drejtpërdrejt me nevojën për furnizim të sigurt dhe cilësor me bimë dhe fidanë, dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës. Ai siguron që operatorët që marrin pjesë kanë kapacitet të ligjshëm dhe teknik për

të përmbushur kërkesat e shërbimit. Ky kriter është i domosdoshëm pasi garanton realizimin e shërbimit të gjelbërimit me përdorim të bimëve dhe fidanëve të certifikuar dhe të autorizuar.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.*

III.2.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj”.*

III.2.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.2.6. Në nenin 41 pika 4 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”.

III.2.7. Në Ligjin Nr 10416, datë 07.04.2011, “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, në nenin 1 “Qëllimi”, parashikohet shprehimisht:

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbështetjen e prodhimit bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit. Ky ligj përcakton:

a) kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

i) të bimëve bujqësore, të cilat përfshijnë drithërat, foragjeret, patatet, panxharin, bimët e vajit e të fibrave, perimet, pemët drufrutore, hardhitë, humulusit, bimët eterovajore dhe medicinale të kultivuara;

ii) të bimëve dekorative;

iii) të bimëve pyjore;

b) detyrimet e personave të angazhuar në prodhimin, përgatitjen për treg, tregtimin, importimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

* 32002L0054- Direktivë e Këshillit 2002/54/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së panxharit. OJ L 193.

20.7.2002, p. 12–32, Version i Konsoliduar 25.1.2005.

32002L0053 - Direktivë e Këshillit 2002/53/EC, 13 qershor 2002 për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore. OJ L 193, 20.7.2002, p. 1–11, Version i Konsoliduar 18.4.2004.

32002L0055 - Direktivë e Këshillit 2002/55/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farave të perimeve. OJ L 193.

20.7.2002, p. 33–59, Version i Konsoliduar 4.7.2009.

32002L0056 – Direktivë e Këshillit 2002/56/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së patates. OJ L 193.

20.7.2002, p. 60–73, Version i Konsoliduar 23.12.2008.

31966L0401 - Direktivë e Këshillit 66/401/EEC, 14 qershor 1966 për tregtimin e farës së bimëve foragjere. OJ L 125.

11.7.1966, p. 2298–2308, Version i Konsoliduar 4.7.2009.

31966L0402 – Direktivë e Këshillit 66/402/EEC, 14 qershor 1966 për marketingun e farave të drithërave. OJ L 125.

11.7.1966, Version i Konsoliduar 4.7.2009.

31992L0090 – Direktivë e Këshillit 92/90/EEC, 3 nëntor 1992, vendosjen e detyrimeve ndaj të cilave prodhuesit dhe importuesit e bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera, janë objekt dhe rregullimin e detajeve për regjistrimin e tyre. OJ L 344, 26.11.1992, p. 38–39.

31968L0193 Direktivë e Këshillit 68/193/EEC, 9 prill 1968 për tregtimin e materialit për shtimin vegetativ të hardhisë; OJ L 93, 17.4.1968, p. 15–23, Version i Konsoliduar 14.7.2005.

31992L0033 - Direktivë e Këshillit 92/33/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegetativ dhe mbjellës të perimeve, të ndryshëm nga fara. OJ L 157, 10.6.1992, p. 1–9 , Version i Konsoliduar 30.10.2007.

31992L0034 – Direktivë e Këshillit 92/34/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegetativ të bimëve frutore dhe bimëve frutore të destinuara për prodhimin e frutave. OJ L 157, 10.6.1992, p. 10–18, Version i Konsoliduar 30.11.2007.

31998L0056 – Direktivë e Këshillit 98/56/EC, 20 korrik 1998 për tregtimin e materialit të shtimit të bimëve zbukuruese. OJ L 226, 13.8.1998, p. 16–23 , Version i Konsoliduar 10.7.2003.

c) kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe mënyrat për të garantuar standardet e tij;

ç) rregullat për regjistrimin e varieteteve të bimëve në Katalogun Kombëtar, në vazhdim KK, mirëmbajtjen e tyre dhe për provën përkatëse të varieteteve të bimëve për t'u regjistruar në të;

d) mënyrën e përdorimit, të këmbimit të të dhënave dhe marrëdhëniet e sistemit të prodhimit e të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me sistemin e informacionit;

dh) rregullat e veprimtarisë së shërbimit publik në fushën e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

e) rregullat për inspektimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

III.2.8. Në Ligjin Nr 10416, datë 07.04.2011, “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, në nenin 2 “Fusha e zbatimit”, parashikohet shprehimisht:

1. Ky ligj zbatohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të të gjitha bimëve, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të nenit 1 të këtij ligji, si dhe për materialin mbjellës dhe shumëzues

bimor të bimëve të tjera, kur këto prodhohen ose tregtohen për t'u përdorur në prodhimin bujqësor.

2. Ky ligj nuk zbatohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që është importuar për qëllim eksporti, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

III.2.9. Në, nenin 3 “Përkufizime”, pika 5 të Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, i ndryshuar, përcaktohet:

“5. “Furnizues” është çdo person, fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që kryen të paktën njëërën nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) prodhim;

b) përgatitje për tregtim;

c) tregtim;

ç) import/eksport të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.”.

III.2.10. Ndërsa në Kreun V “Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor”, nenet 23, 24, e në vijim, si dhe neni 27 të Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, i ndryshuar, përcaktohet:

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet vetëm nga subjekte, të cilat janë të regjistruara në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

1. Shfuqizohet.

2. Inspektimi i ngarkesës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në pikën hyrëse të kalimit kufitar e doganor të Republikës së Shqipërisë, kryhet sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi është i licencuar për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve që ai importon.

4. Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, lidhur me plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj, kryhet në magazinat e furnizuesit ose në treg. Për këtë inspektori merr mostrat përkatëse, të cilat i dërgon për analiza laboratorike.

5. Tarifa e marrjes së mostrave dhe e kryerjes së analizave laboratorike përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

1. Përveç detyrimeve të përcaktuara për prodhimin, para nxjerrjes në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, furnizuesi duhet që, krahas etiketave shoqëruese në ambalazh, në gjuhë të huaj, të vendosë etiketë shtesë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, materiali

mbjellës dhe shumëzues bimor i importuar shoqërohet me dokumente në gjuhën shqipe ose angleze.

2. Furnizuesi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti të paregjistruar në KK, për riprodhim për qëllime eksporti, paraqet tek ESHFF-ja kontratën, si provë të eksportit.

III.2.11. Në, Vendimin Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”, përcaktohet:

II. KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse:

a) u përkasin varieteteve ose hibrideve ndërvarietore apo, në rastin e nënshartesave, u përkasin specieve ose hibrideve ndërmjet specieve, të regjistruara në katalogun kombëtar;

b) plotësojnë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe janë të pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuar, për çdo specie, në aneksin 2 bashkëngjitur këtij vendimi;

c) plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij kreu, për treguesit e cilësisë, identitetin dhe pastërtinë varietore;

ç) janë paketuar dhe etiketuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin 3, bashkëngjitur këtij vendimi;

d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Kërkesat e mësipërme vlerësohen të plotësuara nëse, gjatë verifikimeve të kryera nga furnizuesi, në përputhje me planin e prodhimit dhe nga mbikëqyrjet e kryera nga inspektori fitosanitar e nga autoriteti certifikues, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, është vendosur se:

a) nga ana pamore, materialet e shumëzimit dhe fidanët janë të pastër nga organizmat dhe sëmundjet karantinorë ose ndonjë shenjë apo simptomë e tyre;

b) gjatë sezonit të rritjes, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët kanë rezultuar të pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, që dëmtojnë cilësinë, të listuara në aneksin 2 të këtij vendimi;

c) në lidhje me treguesit e cilësisë, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese, nga ana pamore, kanë zhvillim dhe dimensione të kënaqshme për përdorim dhe nuk kanë defekte që dëmtojnë cilësinë ose që ulin vlerën e përdorimit;

ç) në lidhje me identitetin varietor, nga ana pamore, varieteti dallohet nga veçoritë botanike, morfologjike, biologjike e agroteknologjike dhe plotëson qëllimin e përdorimit;

d) në lidhje me pastërtinë varietore, plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi, për mbajtjen të papërziera të varieteteve dhe specieve të materialeve të shumëzimit e fidanëve të bimëve zbukuruese;

dh) në rastin e farërave, nga ana pamore kanë pamje dhe zhvillim të kënaqshëm.

III. KËRKESAT PËR FURNIZUESIT

1. Furnizuesit që prodhojnë, përgatisin për treg, importojnë dhe/ose tregtojnë materiale shumëzimi dhe fidanë të bimëve zbukuruese, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të jenë të regjistruar dhe të licencuar në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;

b) Të regjistrohen në regjistrin e furnizuesve, që mbahet nga autoriteti certifikues;

c) Të regjistrohen në regjistrin e mbajtësve të bimëve të caktuara, produkteve bimore dhe objekteve të rregulluara për qëllimet e shëndetit të bimëve, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të bimëve;

ç) Kur është e nevojshme, të autorizohen nga struktura përkatëse e mbrojtjes së bimëve për lëshimin e pasaportës bimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

2. Furnizuesit sigurojnë përputhshmërinë e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve me kërkesat e këtij vendimi, duke përmbytur detyrimet e mëposhtme:

a) Të kenë planin e prodhimit, i cili të përmbajë informacion për shqyrtim, kur kërkohet nga organi përgjegjës zyrtar për monitorimin, si më poshtë vijon:

i) Një kopje të planimetrisë kadastrale të vendndodhjes së veprimtarisë së furnizuesit, ku tregohen me saktësi objektet dhe fushat e tokës bujqësore që përdoren për prodhimin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, duke përfshirë edhe zonën mbrojtëse përkatëse;

ii) Planin e mbjelljes;

iii) Planin teknologjik;

iv) Planin për kryerjen e identifikimit dhe mbikëqyrjes së organizmave të dëmshëm në bimët, që ndikojnë në cilësinë e materialit, në objektet dhe në tokën ku materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët prodhohen ose përgatiten për treg;

b) Në mënyrë të përshtatshme, sipas planit të prodhimit, të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, të kryejnë:

i) procedurat e planifikuara teknologjike dhe të mbajnë të dhënat për zbatimin e tyre, sipas datave dhe llojit të procedurës ose detyrat e kryera dhe metodën e zbatimit;

ii) mbikëqyrjen e rregullt për organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuara në aneksin 2, të këtij vendimi;

iii) marrjen e mostrave dhe t'i dërgojnë ato në laboratorin e akredituar për analizat, si dhe të marrin masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut të shfaqjes ose përhapjes së tyre;

c) Mbajtjen e regjistrit të të dhënave për mbikëqyrjen e organizmave dhe të sëmundjeve të dëmshëm, në lidhje me:

i) datën e shfaqjes së mundshme për çdo organizëm dhe sëmundje të dëmshëm, të listuar në aneksin 2 të këtij vendimi dhe të gjitha masat që merren për parandalimin e përhapjen e tij, veçanërisht në lidhje me trajtimet ose heqjen dhe shkatërrimin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve;

ii) datën dhe metodën e marrjes së mostrave të bimëve ose të tokës;

ç) Të njoftojnë, menjëherë, inspektorin përgjegjës fitosanitar, në rast të shfaqjes ose dyshimit të shfaqjes së organizmave karantinorë;

d) Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes ose inspektimit zyrtar, marrjen e mostrave zyrtare, kur është e nevojshme për analiza në një laborator me pajisje dhe ekspertizë të përshtatshme dhe, menjëherë pas inspektimit, të marrin masat për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektori përgjegjës fitosanitar;

dh) Të sigurojnë që lotet ose porcionet e veçanta të materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, gjatë prodhimit, magazinimit, përgatitjes për treg dhe tregtimit, janë të ndara;

e) Të mbajnë shënime për origjinën e materialeve të shumëzimit të përdorura për prodhimin e fidanëve të bimëve zbukuruese.

Furnizuesit duhet të mbajnë shënime për speciet, varietetin, numrin referues të lotit ose porcionit, sasinë, datën e marrjes ose blerjes dhe të dhënat e prejardhjes së materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve në lidhje me furnizuesin dhe vendin e prodhimit;

ë) Të mbajnë shënime për prodhimin, blerjen, specien, varietetin, sasinë, numrin referues të lotit ose porcionit, sasinë dhe datën e prodhimit ose të blerjes së materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve;

f) Të mbajnë të dhëna për përbërjen e ngarkesave me materiale shumëzimi dhe/ose fidanë që shesin ose shpërndajnë, për datën e shitjes e të shpërndarjes, si dhe numrin referues të lotit ose porcionit, sipas specieve dhe varieteteve;

g) Në rastet kur, para tregtimit, lotet ose porcionet e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve me prejardhje të ndryshme vihen të përziera së bashku, furnizuesi të mbajë regjistrin e përbërjes së një ngarkese, me të dhëna për sasinë, numrin e njësisve të loteve ose të porcioneve të veçanta, që përbëjnë lotin ose porcionin e përzier;

gj) Të mbajnë të dhënat për dokumentet dhe etiketat e furnizuesit, të nxjerra në përputhje me kërkesat e përcaktuara për materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që tregtohen në porcione, sipas përcaktimit të këtij vendimi për paketimin dhe etiketimin.

3. Furnizuesit ruajnë të dhënat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj”, të pikës 2 të këtij kreu, si dhe provat në bazë të të cilave ata i kanë regjistruar të dhënat për të paktën tre vjet pas kalimit të vitit kalendarik, kur të dhënat janë regjistruar.

4. Furnizuesit, veprimtaria e të cilëve përqendrohet vetëm në tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve në blerjen me shumicë, brenda dhe jashtë vendit, si dhe shitjen me shumicë e pakicë, mbajnë të regjistruara, për të paktën 12 muaj, shënimet përkatëse për datën dhe sasinë e blerjeve, shitjeve, shpërndarjeve të tyre sipas specieve, varieteteve e numrit të referencës për lotin ose porcionin.

IV. KËRKESAT PËR CERTIFIKIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE TË BIMËVE ZBUKURUESE

IV.1 Kërkesa për certifikim

1. Certifikimi i materialeve të shumëzimit dhe /ose të fidanëve të bimëve zbukuruese kryhet mbi bazën e prodhimit të deklaruar nga furnizuesi në kërkesën e paraqitur tek autoriteti certifikues, sipas rregullave të mëposhtme:

a) Kërkesa paraqitet çdo vit, jo më vonë se data 30 prill ose, në rastin e bimëve me disa cikle vegetacioni në një vit, jo më vonë se një muaj para fillimit të prodhimit dhe përmban të dhëna për:

i) furnizuesin;

ii) aktivitetin që kryhet;

iii) personin përgjegjës të kualifikuar;

iv) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese.

b) Forma, përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet kërkesës është sipas modelit 1, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi;

c) Autoriteti certifikues shqyrton kërkesën për certifikim brenda 20 ditëve pune nga paraqitja e saj dhe njofton zyrtarisht furnizuesit për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 10 ditëve pune pas përfundimit të shqyrtimit;

ç) Kërkesa e furnizuesit për certifikim pranohet, nëse:

i) është paraqitur dhe plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij kreu;

ii) materialet e shumëzimit dhe fidanët prodhohen, etiketohen dhe vendosen në treg nga persona përgjegjës të kualifikuar;

iii) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që kërkohen për certifikim u përkasin varieteteve ose në rastin e nënshartesave, u përkasin specieve dhe hibrideve ndërmjet tyre e që janë regjistruar në katalogun kombëtar;

iv) modeli i etiketës së propozuar nga furnizuesi është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe modeli i certifikatës së origjinës është sipas modelit 5, të aneksit 4, të këtij vendimi.

2. Në rastet kur, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e bimëve, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese duhet të shoqërohen me pasaportë bimore, së bashku me kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, furnizuesi paraqet kërkesë pranë strukturave të shërbimit të mbrojtjes së bimëve për pajisjen me pasaportë bimore.

IV.2 Procedurat e lëshimit të certifikatës zyrtare për materialet e shumëzimit dhe/ose për fidanët e bimëve zbukuruese

1. Furnizuesi që prodhon materiale shumëzimi dhe/ose fidanë të bimëve zbukuruese për tregtim lejohet t'i tregtojë ato pasi të jenë certifikuar nga autoriteti certifikues dhe të jetë autorizuar për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave e të dokumenteve të tjera të furnizuesit.

2. Autoriteti certifikues lëshon certifikatën kur, nga mbikëqyrja e ushtruar, rezulton se plotësohen kërkesat e përcaktuara në këtë vendim. [...]

III.2.12. Në seksionin “Kategoria II.4. “Prodhimi dhe/ose Tregtimi i Farave dhe/ose Fidanëve”, të Vendimit nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se:

1. Veprimtaria e “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor)” është kategoria II.4 e shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Licenca e kategorisë II.4 është pa afat.

3. Kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve shoqëruese përkatëse për kategorinë II.4 jepen në tabelën 1 më poshtë. Kriteret e detajuara dhe dokumentet përkatëse provuese shpallen në regjistrin informativ të licencave e lejeve nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Licencimit.

Kriteret e posaçme	Mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme	Llojet e dokumenteve provuese lidhur me kriteret e posaçme
Përshtatshmëria e njohurive dhe eksperiencës së personelit	Drejtuuesi Teknik	Vetëdeklarim
Përshtatshmëria e pajisjeve, dhe mjediseve me standardet e shërbimit	Sipas veprimtarisë konkrete	Vetëdeklarim

4. Licencimi i veprimtarive të kategorisë II.4 bëhet sipas grupit I.

5. Licencimi i veprimtarive sipas këtij vendimi fillon më 9.6.2009.

III.2.13. Në Vendimin Nr. 34 Datë 22.01.2020 Të Këshillit Të Ministrave “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr. 538, Datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për Licencat dhe Lejet, që Trajtohen nga apo Njëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa Rregullime të tjera nën Ligjore të Përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: 1. Në kreun II, të kategorisë II.2, “Shërbimeve të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare”, të fushës II, “Ushqimi dhe shëndeti”, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Shkronja “b”, e pikës 4, shfuqizohet.

b) Në pikën 5, fjalët “... ndërsa kriteret e posaçme të licencimit dhe dokumentet e tjera shoqëruese për veprimtaritë me kodin II.2.A.2, përcaktohen në tabelën 2, më poshtë.” dhe “Tabela 2” hiqen.

c) Pika 7 shfuqizohet.

2. Kategoria II.4, “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor)”, e fushës II, “Ushqimi dhe shëndeti”, shfuqizohet.

III.2.14. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon se nuk ndodhet ne kushtet ku duhet të gjykojë mbi pretendime për heqjen apo modifikimin e kriterëve të kualifikimit, apo të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik, por në rastin konkreti KPP duhet të gjykojë mbi respektimin e parimeve kryesore të prokurimit publik, të cilat duhet të respektohen nga autoriteti kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit në një procedurë prokurimi. Referuar ligjit të prokurimit publik, në nenin 3 të tij, parashikohen parimet kryesore të cilat duhet të respektohen nga autoriteti kontraktor gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të një procedure prokurimi, ku çdo autoritet kontraktor dhe entet kontraktore duhet të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kriteret të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kriteret dhe kërkesa të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e mallit/punës/shërbimit që kërkohet të prokurohet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Kriteret e përcaktuara me ligj mund të parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, gjithashtu mund të përcaktohen kriteret të cilat bazohen në ligje specifike, në varësi të fushës apo objektit që kërkohet të realizohet. Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatojmë se objekti-prokurimit përvec mirëmbajtjes ka dhe zëra F.V fidanë lule dekorative dhe shkurre, për të cilat ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 10416, datë 07.04.2011 i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij).

Në vijim referuar nenit 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë të cilat duhet të bazohen në *a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; dhe c) aftësinë teknike dhe profesionale [...]*. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës

së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me kërkesën “**2.1.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) “Prodhimi dhe tregëtimi i farave dhe fidanëve” (Kodi II.4)**”. Komisioni Prokurimit Publik gjykon se, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin Licensë “Prodhimi dhe tregëtimi i farave dhe fidanëve”)” me Kodin II.4, është një kërkesë në kundërshtim me legjislacionin e fushës përkatëse konkretisht në Vendimin Nr. 34 datë 22.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të këshillit të ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar. Pasi Vendimi Nr. 34, datë 22.01.2020 ka shfuqizuar kodin II.4 konkretisht “*Kategoria II.4, “Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe fidanëve (materialit mbjellës bimor)”, e fushës II, “Ushqimi dhe shëndeti”, shfuqizohet*”. Në këtë kontekst përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të një kriteri i cili nuk ekziston më nuk parashikohet nga legjislacioni sektorial, pasi është shfuqizuar sjell si pasojë paqartësi dhe konfuzion si tek operatorët ekonomik në lidhje me mënyrën e plotësimit të këtij kriteri nga ana e tyre, por dhe të komisionit vlerësimit të ofertave duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rastin konkret kriteri i mësipërm i vendos në kushte të pabarabarta nga njëra anë operatorët ekonomik pjesëmarrës dhe nga ana tjetër edhe procesin e vlerësimit të ofertave, ku përsakohë që më Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 34, datë 22.01.2020, licenca me Kod II.4 është shfuqizuar. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit në pikën 2.1.3 nuk është në përputhje me legjislacionin sektorial, pasi autoriteti kontraktor ka kërkuar një licensë e cila në momentin e publikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi ka qenë e shfuqizuar. Ndaj autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin e vecanta të kualifikimit në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe legjislacioni e fushës përkatëse.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK, se: “Pika 3. Në Shtojcën 9, Formular i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të

Kualifikimit, nënpika 2.1.4 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: N.P-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit dhe N.S- 18 A Punime topogjeodezike. Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kriterëve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Ky kriter është i domosdoshëm, pasi realizimi i kontratës kërkon ndërhyrje të koordinuara në hapësira të gjelbra dhe infrastruktura të mbështetura në matje topografike dhe inxhinieri mjedisore. Punimet e mirëmbajtjes së varrezave, shëtitoreve, rrugëve dhe zonave kodrinore përfshijnë: - skarifikim dhe mbjellje bari në sipërfaqe të mëdha; - prerje dhe sistemim pemësh me diametra të ndryshëm; - vendosje dhe mirëmbajtje të fidanëve dekorativë dhe shkurreve; - mbjellje, transport dhe stabilizim të materialeve të ndryshme; - ndërhyrje në terrene të pjerrëta dhe zona urbane të ndjeshme, mjedisit, duke garantuar realizimin e punimeve me respektim të standardeve mjedisore, për sigurinë dhe funksionalitetin e hapësirave të gjelbra. Licenca N.S-18 A siguron që operatori ka kapacitet për matje dhe shënime topografike të terrenit, të cilat janë të domosdoshme për vendosjen e saktë të elementeve të gjelbërimit dhe për planifikimin e punimeve në zona kodrinore dhe urbane. Kërkesa për licensë profesionale të vlefshme siguron gjithashtu që shoqëria është e regjistruar dhe e autorizuar ligjërisht për kryerjen e punimeve të planifikuara dhe shmang veprime të paautorizuara, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi. Licenca është një dokument thelbësor për të verifikuar kapacitetin teknik të operatorit dhe aftësinë për realizim të punimeve inxhinierike mjedisore dhe topogjeodezike. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit A që i përgjigjet kësaj vlere. Kriteri është i domosdoshëm pasi garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin dhe autorizimin e nevojshëm për të realizuar shërbimin e gjelbërimit në përputhje me standardet profesionale dhe ligjore. Lidhur me kriterin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e Licensës N.S-18 A Punime topogjeodezike, kërkojmë heqjen e këtij kriteri si kriter i paligjshëm, i cili nuk është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës. Më konkretisht argumentojmë si vijon: Referuar argumentimit të vendosjes së këtij kriteri, rezulton se AK ka kërkuar që OE konkures të ketë kapacitet për matje dhe shënime topografike të terrenit. Sqarojmë AK se vendosja e këtij kriteri e për më tepër me këtë argumentim nuk është në përputhje me llojin dhe natyrën e kontratës. Sjellim në vëmendje të AK se kontrata e prokurimit është shërbime dhe jo punë, ndërsa objekti i procedurës së prokurimit është Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbra që do të thotë se hapësirat e gjelbërta që kërkon AK të mirëmbahen minimalisht janë identifikuar nga AK dhe nuk kërkohet të identifikohen me anë të shërbimeve topografike nga OE konkures. Kjo licencë qartazi nuk ka asnjë lidhje me objektin e procedurës së prokurimit. Për më tepër rezulton se Autoriteti Kontraktor nuk ka publikuar asnjë lloj harte me koordinatat përkatëse për sipërfaqet e gjelbërta që kërkon mirëmbajtje. Po kështu, referuar

Shtojcave të Dokuemnteve Standarde të tenderit rezulton se nuk ka asnjë fjalë, proces apo zë/punë konkrete që duhet të kryejë OE konkurues lidhur me shërbimet/punimet topogjeodezike. Më konkretisht: a) Shtojca 6 Formulari i Specifikimeve Teknike nuk përmban asnjë fjalë/term apo proces që identifikon ndonjë punim topogjeodezike; b) Shtojca 7 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, nuk përmban asnjë proces pune (aq më pak njësi apo sasi) që identifikon ndonjë punim topogjeodezike; c) Shtojca 8 Formulari i Termave të Referencës, nuk përmban asnjë proces pune, përshkrim të shërbimeve apo kërkesë teknike që identifikon ndonjë punim topogjeodezike; Sa mësipër, rezulton se ky kriter nuk është në përputhje me natyrën, kërkesat dhe llojin e kontratës. Ky kriter i vendosur si ciban pa rrënjë bie në kundërshtim të hapur me nenin 2 Qëllimi shkronja d të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik i ndryshuar ku përcaktohet se: Qëllim i këtij ligji është: d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; Qartazi vendosja e këtij kriteri është e paligjshme dhe diskriminon OE konkurues në këtë procedure prokurimi. Për pasojë, vlerësojmë se ky kriter është tërësisht abuziv dhe diskriminues dhe ne kërkojmë të hiqet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.1.4, “Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë”, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.1.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: “N.P-12 A “Punime të inxhinierisë së mjedisit dhe N.S- 18 A “Punime topogjeodezike”

III.3.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Ky kriter është i domosdoshëm, pasi realizimi i kontratës kërkon ndërhyrje të koordinuara në hapësira të gjelbra dhe infrastruktura të mbështetura në matje topografike dhe inxhinieri mjedisore. Punimet e mirëmbajtjes së varrezave, shëtitoreve, rrugëve dhe zonave kodrinore përfshijnë:

- skarifikim dhe mbjellje bari në sipërfaqe të mëdha,
- prerje dhe sistemim pemësh me diametra të ndryshëm,
- vendosje dhe mirëmbajtje të fidanëve dekorativë dhe shkurreve,
- mbjellje, transport dhe stabilizim të materialeve të ndryshme,

- ndërhyrje në terrene të pjerrëta dhe zona urbane të ndjeshme.

Licenca N.P-12 A siguron që operatori posedon kapacitet teknik dhe ekspertizë në inxhinierinë e mjedisit, duke garantuar realizimin e punimeve me respektim të standardeve mjedisore, për sigurinë dhe funksionalitetin e hapësirave të gjelbra. Licenca N.S-18 A siguron që operatori ka kapacitet për matje dhe shënime topografike të terrenit, të cilat janë të domosdoshme për vendosjen e saktë të elementeve të gjelbërimit dhe për planifikimin e punimeve në zona kodrinore dhe urbane.

Kërkesa për licensë profesionale të vlefshme siguron gjithashtu që shoqëria është e regjistruar dhe e autorizuar ligjërisht për kryerjen e punimeve të planifikuara dhe shmang veprime të paautorizuara, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi. Licenca është një dokument thelbësor për të verifikuar kapacitetin teknik të operatorit dhe aftësinë për realizim të punimeve inxhinierike mjedisore dhe topogjeodezike. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit "A" që i përgjigjet kësaj vlere. Kriteri është i domosdoshëm pasi garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin dhe autorizimin e nevojshëm për të realizuar shërbimin e gjelbërimit në përputhje me standardet profesionale dhe ligjore.

III.3.3. Në shtojcën 7 "Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit", të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi që kërkohet:

Nr	Nr.An.	Emërtimi	Njësia	Sasia
<i>I- Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe infrastrukturës në varreza</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	125,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	22,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	3,500
5	3.4	Prerje e sistemim pemësh Φ21-40cm	copë	2,100
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	1,000
7	3.161/1	Rrafshim skarpate	m ²	4,500
8	3.322	Mur guri, llaç çimento M25 (mirëmbajtje)	m ³	200
9	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	400
10	an.	Mirembajtje varrezat e dëshmorëve Kuç	m ²	1,750
<i>II - Mirëmbajtje rruge për shkolla, kosha, varreza etj</i>				
1	an	Mirëmbajtje rruge për 1,000 m ²	m ²	90,000
1	3.96	F.V. fidane lule dekorative	copë	2,200

2	3.962	F.V. fidane shkurre dekorative "Oleander"	copë	300
3	an.168	F.V. shkurre dekorative Juniperus V18 grup3 cdo 6.6m	copë	200
4	an.	Mirëmbajtje	m ²	2,500
<i>IV-Plehërim i pemëve me pleh kimik</i>				
1	an.	Pleh kimik lloji 12-12-17	kg	3,000
2	an.	Ure	kg	2,500
3	an.	Pleh kimik lloji 20-20-20	kg	2,000
4	an.	Ilaç për spërkatje pemë (kunder morave, krimbave etj)	kg	60
<i>V- Mirëmbajtje bari</i>				
1	an.	Mirëmbajtje bari	m ²	32,000
2	3.643	Mbjellje bari	m ²	10,000
<i>VI- Krasitje pemë në shëtitore dhe trotuare</i>				
1	an.	Krasitje pemë	copë	1,250
2	an	Mirëmbajtje e pemëve	copë	1,250
3	an.	Bordurë e gjelbërt	ml	350
4	an.	Transport mbetjesh	m ³	127
<i>VI-Vaditje e pemëve gjatë sezonit 6-mujor</i>				
1	an.	Vaditje pemësh	copë	1,250
<i>VIII- Mirëmbajtje pishat pranë fushës, kodra</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	95,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	12,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	2,000
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	250
7	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	220
<i>IX- Mirëmbajtje kodra e lisave në Pilur</i>				
1	an.	Mirëmbajtje	m ²	9,000
2	3.322	Mur guri mbajtës e themele, ilaç çimento M25, mirëmbajtje	m ³	122
3	an.	Gropa për fidanet e rinj 40x40x40cm	copë	200
4	an.	Mbjellja e fidanëve të rinj	copë	200
5	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	136

III.3.4. Në shtojcën 8 “Formulari i Termave të Referencës”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi i mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëruara

1. Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është realizimi i shërbimeve për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, prerjen dhe sistemimin e vegjetacionit, furnizimin dhe mbjelljen e fidaneve, plehërimin dhe trajtimin fitosanitar, transportin e materialeve dhe mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e elementeve ndërtimore dhe infrastrukturore në zona publike, rrugore, shkollore dhe memoriale.

2. Përshkrimi i shërbimeve

Shërbimet që do të realizohen përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon.

Skarifikimi manual i barit me lopatë në thellësi 3–5 cm dhe me distancë prerjesh 10–15 cm duke përfshirë pastrimin e mbetjeve, nivelimin dhe sipas nevojës mbjellje plotësuese dhe plehërim

Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm, shkulla e plotë e rrënjëve të tyre, grumbullimi dhe largimi i mbetjeve si dhe nivelimi i sipërfaqes.

Prerja dhe sistemimi i pemëve sipas kategorive të diametrit Φ 10–20 cm, Φ 21–40 cm dhe Φ 41–75 cm duke përfshirë rrëzimin e kontrolluar, segmentimin, transportin e materialit drunor dhe pastrimin përfundimtar të zonës.

Krasitja dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e pemëve duke përfshirë heqjen e degëve të thata ose të dëmtuara, trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe plehërimin sipas nevojës.

Rrafshimi dhe stabilizimi i skarpave sipas parametrave gjeoteknikë, me ngjeshje të kontrolluar dhe sistemim përfundimtar të sipërfaqes.

Mirëmbajtja dhe riparimi i mureve prej guri dhe mureve mbajtëse me llaç cemento M25 duke përfshirë pastrimin e fugave, zëvendësimin e elementeve të dëmtuara dhe përforcimet e nevojshme.

Transporti i materialeve të ndërtimit, dheut dhe mbetjeve deri në distancë 3 km duke përfshirë ngarkimin, shkarkimin dhe sistemimin sipas kërkesës.

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Kuç, Tërbaç dhe Shën Vasil duke përfshirë pastrim, prerje bari, riparime të elementeve memoriale dhe raportim periodik mbi gjendjen.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe oborreve të shkollave për sipërfaqe 1000 m² duke përfshirë pastrim, rrafshim, sistemim dhe garantim të sigurisë së qarkullimit.

Furnizimi, mbjellja dhe mirëmbajtja e fidaneve lule dekorative, shkurre dekorative Oleander, shkurre dekorative Juniperus V18 grup 3 të vendosura çdo 6 6 m, si dhe krijimi i bordurave të gjelbërta.

Hapja e gropave për fidane 40×40×40 cm dhe mbjellja e fidaneve të rinj me përgatitje toke dhe trajtim pas mbjelljes.

Mbjellja dhe mirëmbajtja e barit duke përfshirë përgatitjen e tokës, mbjelljen, ujitjen, plehërimin dhe kontrollin fitosanitar.

Plehërimi i pemëve me pleh kimik 12-12-17, 20-20-20 dhe ure sipas dozimit teknik dhe kushteve agronomike.

Trajtimi i pemëve me pesticide për spërkatje kundër morave, kribave dhe dëmtuesve të tjerë sipas udhëzimeve teknike dhe standardeve mjedisore.

Vaditja e pemëve sipas kërkesave biologjike dhe kushteve klimatike.

Mirëmbajtja e kodrave dhe lisave në Pilur duke përfshirë krasitje, pastrim, trajtim dhe stabilizim të terrenit.

3. Kërkesat teknike

Të gjitha punimet duhet të realizohen në përputhje me standardet teknike në fuqi dhe praktikën e mirë profesionale.

Kontraktori duhet të përdorë pajisje dhe makineri të përshtatshme për natyrën e punimeve. Duhet të sigurohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale dhe zbatimi i rregullave të sigurisë në punë.

Materialet e përdorura duhet të jenë cilësore dhe në përputhje me specifikimet teknike. Mbetjet dhe materialet e tepërta duhet të transportohen në vende të miratuara sipas legjislacionit mjedisor.

4. Afati i realizimit

Shërbimet do të realizohen sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe në varësi të kushteve klimatike dhe sezonalitetit të punimeve.

5. Detyrimet e kontraktorit

Të sigurojë staf të kualifikuar dhe të trajnuar.

Të garantojë cilësi dhe realizim korrekt të punimeve.

Të raportojë periodikisht mbi ecurinë e shërbimit.

Të riparojë çdo dëmtim të shkaktuar gjatë realizimit të punimeve.

6. Kontrolli dhe pranimi i shërbimeve

Punimet do të mbikëqyren nga përfaqësues të autoritetit kontraktor.

Pranimi i shërbimeve do të bëhet pas verifikimit të cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat teknike.

III.3.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.6. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.3.7. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.3.8. Neni 41 pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.3.9. Në Kreun I “Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime” dhe Kreu III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet” të VKM nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet se:

[...]

KREU I

QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLORES DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi dhe fusha e veprimit:

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë.

Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij.

Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- *profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- *Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;*

- *Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;*

- *Kapacitetet financiare.*

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- *Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;*

- *Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;*

- *Kapacitetet financiare.*

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

c) Shfuqizuar.

ç) Shfuqizuar.

d) Autoriteti kontraktues kërkon ndërprerjeje e punimeve dhe prishjen e kontratës për çdo vonesë në grafikun e punimeve, që rrezikon përfundimin e punimeve në afatin përfundimtar, të përcaktuar në kontratën e nënshkruar. Në këtë rast edhe për moskryerje të punimeve sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën “c” kërkohet heqja e licencës për shoqëri ndërtuese, në përputhje me këtë vendim dhe përjashtimin e saj nga prokurimet publike, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

2. Elementet e licencës:

a) Licenca përmban këto elemente:

I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2);

II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4);

III. Numrin e identifikimit;

IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni);

V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë;

VI. Selinë;

6

VII. Afatin e vlefshmërisë;

VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit;

IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).

b) Formulari i licencës miratohet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.

Ndërsa në Lidhjen 3 parashikohen

LIDHJA 3

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme

...

N.S – 18. Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rëlvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.3.11. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues se kategoria e licencës e kërkuara në pikën 2.1.4 të dokumentave të tenderit, e konkretisht kategoritë *N.S- 18 A “Punime topogjeodezike”*, është në kundërshtim me përcaktimet e VKM 42/2008 , si dhe me natyrën dhe zërave të shërbimeve që parashikon preventivi i kësaj kontrate, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Komisioni i Prokurimit Publik referuar natyrës së shërbimeve të objektit të kontratës, së bashku

me preventivin e shërbimeve të përcaktuar në shtojcën 7 të DST të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, vlerëson se nga autoriteti kontraktor është kërkuar kategori licence si *N.S- 18 A “Punime topogjeodezike”*, e cilat nuk lidhen me objektin e kontratës. Referuar zërave të shërbimeve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP vlerëson se kategoria e licencës e përcaktuara nga autoriteti kontraktor e konkretisht *N.S- 18 A “Punime topogjeodezike”*, vjenë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr 42/2008, pasi kjo kategori licence përfshin punime sipas Shtojcës 3 të VKM-së, të cilat nuk përfshihen në shërbimet objekt prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë të kësaj kategorie licence nuk është proporcionale me objektin dhe natyrën e kontratës objekt prokurimi, është një kërkesë në përpjestim të zhdrejtë me volumin e saj, objektin e prokurimit dhe zërat e shërbimeve të parashikuara në preventiv. KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë dokumentat e tenderit duke hequr këtë kategori licence, përcaktuar në pikën 2.1.4 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “*Albgarden*” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*Albgarden*” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.2. të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, se: “*Pika 4. Në Shtojcën 9, Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.3.2 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëra, i cili duhet të jetë inxhinier pyjesh i çertifikuar si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: a) Diplomë në inxhinieri pyjesh; b) Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor; c) Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave; d) CV-në përkatëse; e) Kontratë pune (e vlefshme). Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor. Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kritereve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: “në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar). Nga preventivi rezulton se kontrata përfshin ndërhyrje të gjera në pemë dhe sipërfaqe të gjelbra, konkretisht prerje dhe sistemime pemësh me diametra deri në 75 cm, mirëmbajtje në zona kodrinore dhe me pisha, mbjellje fidanësh të rinj, trajtime me plehra dhe produkte fito sanitare, si dhe ndërhyrje në zona me karakter natyror dhe gjysmë-natyror. Këto aktivitete kërkojnë njohuri të thelluara profesionale mbi biologjinë e pemëve, menaxhimin e masiveve drusore, stabilitetin e terrenit, ndikimin në biodiversitet dhe praktikën e qëndrueshme të mirëmbajtjes. Përcaktimi i një inxhinieri pyjesh si Drejtues Teknik është i domosdoshëm për të garantuar që ndërhyrjet në pemë*

dhe në zonat e gjelbëra të kryhen sipas praktikave profesionale dhe standardeve teknike, duke shmangur dëmtimet e pakthyeshme të vegjetacionit, prerjet e gabuara, destabilizimin e terrenit apo rreziqe për sigurinë publike. Duke qenë se në preventiv parashikohen ndërhyrje në mijëra elementë drusorë dhe sipërfaqe të mëdha natyrore, drejtimi teknik nga një specialist i fushës është thelbësor për planifikimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së punimeve. Kërkesa për certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor është e justifikuar nga fakti se ndërhyrjet në zona kodrinore, në pisha dhe në hapësira me karakter natyror mund të kenë ndikim mjedisor. Prania e një eksperti me këtë kualifikim garanton që aktivitetet do të vlerësohen dhe do të realizohen në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe me legjislacionin përkatës. Gjithashtu, kërkesa për certifikim si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për supervizimin e aktiviteteve siguron që drejtimi teknik të kryhet nga një profesionist i njohur dhe i autorizuar për të mbikëqyrur ndërhyrje në fondin pyjor dhe hapësirat e gjelbra, duke garantuar standard profesional dhe përgjegjësi teknike. Paraqitja e diplomës, certifikatave përkatëse, CV-së dhe kontratës së vlefshme të punës synon të garantojë që personi i deklaruar është realisht i kualifikuar, i angazhuar pranë operatorit ekonomik dhe i disponueshëm për zbatimin e kontratës, duke shmangur deklarime formale. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet nën drejtimin e një specialisti të kualifikuar në fushën e pyjeve dhe mjedisit, në përputhje me standardet profesionale dhe kuadrin ligjor në fuqi. Lidhur me kërkesën për pasjen e Certifikatës për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor, kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi ky kriter është abuziv, konfuz, si dhe bie në kundërshtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Më konkretisht argumentojmë se: Në Ligjin nr. 10440, datë 7.7. 2011 Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis , neni 2, pika 18 përcakton se: Ekspert i certifikuar i VNM-së është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor. Pra qartazi ligji 10440 dhe përkufizimi përkatës për certifikatën për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor bën fjalë për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ndërkohë në procedurën konkrete të prokurimit, referuar Shtojcës 8 Formulari i Termave të Referencës, rezulton se Qëllimi i kontratës është: realizimi i shërbimeve për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, prerjen dhe sistemimin e vegjetacionit, furnizimin dhe mbjelljen e fidaneve, plehërimin dhe trajtimin fitosanitar, transportin e materialeve dhe mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e elementeve ndërtimore dhe infrastrukturore në zona publike, rrugore, shkollore dhe memorial. Pra kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me shërbime mirëmbajtje në hapësira e sipërfaqe të gjelbërta (përfshirë mbjedhje dhe trajtim fitosanitar) dhe mirëmbajtje të elementëve ndërtimorë e infrastrukturorë në zona publike, rrugore, shkollore etj.. Lidhur me këtë kërkesë të AK sqarojmë se nuk jemi në një procedurë prokurimi ku kërkohet impakti dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis të ndonjë procesi (psh ndërtimi i një objekti industrial apo me karakter civil rrugë objekt ndërtimor etj), por jemi përballë një shërbimi rutinë mirëmbajtje. Nga ana tjetër, rezulton se në Shtojcën 6 Formulari i Specifikimeve Teknike dhe në Shtojcën 7 Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, Autoriteti Kontraktor nuk ka përcaktuar asnjë zë apo specifikim konkret që lidhet ne

procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Në këto kushte kjo kërkesë është e paligjshme, diskriminuose dhe ndikon drejtpërdrejt në konkurrencën e procedurës, e për pasojë duhet të hiqet. Lidhur me kërkesën për pasjen e Certifikatës si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, sjellim në vëmendje të Autoriteti Kontraktor se objekti i procedurës së prokurimit është shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta në Bashkinë Himarë dhe JO Supervizionim i këtij shërbimi. Kërkesa për pasjen e Certifikatës së supervizimit të punës dhe shërbimit që do të kryejë Operatori Ekonomik i shpallur fitues mund të realizohet ose nga një zyrtar i Autoriteti Kontraktor ose nga një Person Fizik apo Juridik i kontraktuar nga AK. E thënë thjesht, bukur dhe pastër ju bëjmë me dije se OE fitues që realizon kontratën nuk mund të supervizojë veten, pasi minimalisht do të ndodhet në një situatë konflikti interesi të pastër me veten e tij. Referuar VKM nr. 284, datë 29.4.2022 Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave dhe Kriteve për Pajisjen me Certifikatën e Ekspertit në Fushën e Pyjeve dhe Kullotave në pikat 2 dhe 3 parashikohet se: 2. Pajisja me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve është e detyrueshme për çdo individ, që kërkon të ushtrojë ekspertizë profesionale për veprimtari të tilla, si supervizimi, studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota në Republikën e Shqipërisë me fonde publike e private. 3. Shërbimi i ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota ushtrohet nga eksperti për veprimtaritë e mëposhtme: a) supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, mbikëqyrjen, kolaudimin dhe certifikimin e veprimtarive të prodhimit apo tregtimit të farave, kalemave e fidanëve pyjorë dhe të materialit mbjellës; b) hartimin e metodikave, udhëzuesve/manualeve, studimeve thellësisht teknike për përdorimin e territorit për zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor dhe vlerësimin e peizazhit, biodiversitetit, zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare, florës spontane (bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore), faunës së egër, të rrjetit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës dhe parandalimit të rrezikut të zjarreve; c) hartimin e projekteve të tilla, si projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse, projekte për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulturore, të sistemeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, të mbritshmërisë, ndërtimin e rrugëve autopsyjore dhe teleferikëve pyjorë; ç) zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve, ku përfshihet zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të pyllëzimit dhe projektet që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve . Referuar përcaktimeve të VKM nr. 284, date 29.04.2022 qartazi rezulton se shërbimi i ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave nevojitet për aktivitetet si: supervizimi, studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota në Republikën e Shqipërisë. Në rastin konkret rezulton se procedura e prokurimit është thjesht dhe vetëm Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra , pra nuk ndodhemi në asnjë nga kushtet për nevojën e shërbimit të specializuar të ekspertit. Në këto kushte është e qartë se ky kriter nuk është në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës duke shkelur kështu parashikimet e nenit 77 të Ligjit të Prokurimit Publik, dhe nenit 41 të VKM nr. 285, Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik ku përcaktohet se: 3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë

në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. Bazuar në sa mësipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke hequr kërkesën për pasjen e Certifikatës për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor si dhe duke hequr kërkesën për pasjen e Certifikatës si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.2, “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëra, i cili duhet të jetë inxhinier pyjesh i certifikuar si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:*

- a) Diplomë në inxhinieri pyjesh;*
- b) Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor.*
- c) Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave.*
- d) CV-në përkatëse;*
- e) Kontratë pune (e vlefshme).*

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.4.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: *Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

Nga preventivi rezulton se kontrata përfshin ndërhyrje të gjera në pemë dhe sipërfaqe të gjelbra, konkretisht prerje dhe sistemime pemësh me diametra deri në 75 cm, mirëmbajtje në zona kodrinore dhe me pisha, mbjellje fidanësh të rinj, trajtime me plehra dhe produkte fitosanitare, si dhe ndërhyrje në zona me karakter natyror dhe gjysmë-natyror. Këto aktivitete kërkojnë njohuri

të thelluara profesionale mbi biologjinë e pemëve, menaxhimin e masiveve drusore, stabilitetin e terrenit, ndikimin në biodiversitet dhe praktikën e qëndrueshme të mirëmbajtjes.

Përcaktimi i një inxhinieri pyjesh si Drejtues Teknik është i domosdoshëm për të garantuar që ndërhyrjet në pemë dhe në zonat e gjelbëra të kryhen sipas praktikave profesionale dhe standardeve teknike, duke shmangur dëmtimet e pakthyeshme të vegjetacionit, prerjet e gabuara, destabilizimin e terrenit apo rreziqe për sigurinë publike. Duke qenë se në preventiv parashikohen ndërhyrje në mijëra elementë drusorë dhe sipërfaqe të mëdha natyrore, drejtimi teknik nga një specialist i fushës është thelbësor për planifikimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së punimeve.

Kërkesa për certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor është e justifikuar nga fakti se ndërhyrjet në zona kodrinore, në pisha dhe në hapësira me karakter natyror mund të kenë ndikim mjedisor. Prania e një eksperti me këtë kualifikim garanton që aktivitetet do të vlerësohen dhe do të realizohen në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe me legjislacionin përkatës.

Gjithashtu, kërkesa për certifikim si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për supervizionin e aktiviteteve siguron që drejtimi teknik të kryhet nga një profesionist i njohur dhe i autorizuar për të mbikëqyrur ndërhyrje në fondin pyjor dhe hapësirat e gjelbra, duke garantuar standard profesional dhe përgjegjësi teknike.

Paraqitja e diplomës, certifikatave përkatëse, CV-së dhe kontratës së vlefshme të punës synon të garantojë që personi i deklaruar është realisht i kualifikuar, i angazhuar pranë operatorit ekonomik dhe i disponueshëm për zbatimin e kontratës, duke shmangur deklaratime formale.

Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet nën drejtimin e një specialisti të kualifikuar në fushën e pyjeve dhe mjedisit, në përputhje me standardet profesionale dhe kuadrin ligjor në fuqi.

III.4.3. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Skarifikimi i barit me lopatë është proces manual i ajrosjes së sipërfaqes së gjelbëruar përmes prerjes vertikale të shtresës së that-it dhe dekompaktimit të shtresës sipërfaqësore të tokës. Thellësia e depërtimit në tokë duhet të jetë 3–5 cm, me distancë ndërmjet prerjeve 10–15 cm, duke siguruar prerje të njëtrajtshme në drejtim linear ose kryqëzor sipas nevojës së sipërfaqes. Punimet realizohen në tokë me lagështi mesatare për të shmangur dëmtimin e rrënjëve dhe ngjeshjen shtesë të dheut. Prosesi përfshin heqjen dhe largimin e mbetjeve organike të krijuara pas prerjes, nivelimin e lehtë të sipërfaqes dhe, sipas nevojës, mbjellje plotësuese dhe plehërim. Shërbimi do të kryhet në periudhën pranverë ose vjeshtë, në temperatura të tokës 10–18°C.

Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm përfshin largimin manual ose mekanik të trungjeve dhe degëve me diametër maksimal deri në 10 cm, të matura në lartësi rreth 10–15 cm nga niveli i tokës. Prerja kryhet në nivel sa më afër tokës ose sipas kërkesës teknike të projektit, me kënd prerjeje të rregullt për të shmangur çarjen e trungut dhe për të mundësuar rigjenerim të kontrolluar kur kërkohet. Prosesi përfshin grumbullimin, transportin dhe largimin e mbetjeve bimore nga vendpunimi, si dhe pastrimin dhe nivelimin e sipërfaqes pas ndërhyrjes.

Shkulja e rrënjëve të bimëve të vogla përfshin largimin e plotë të sistemit rrënjor për bimë me diametër trungu deri në 10 cm, me qëllim eliminimin e rigjenerimit dhe pastrimin përfundimtar të sipërfaqes. Gërmimi kryhet rreth perimetrit të trungut me diametër pune 30–60 cm për të liruar rrënjët anësore dhe për të mundësuar nxjerrjen e plotë të trungut me rrënjë. Gjatë procesit sigurohet minimizimi i dëmtimit të terrenit përreth dhe ruajtja e stabilitetit të sipërfaqeve ekzistuese. Punimet përfshijnë grumbullimin, ngarkimin, transportin dhe largimin e rrënjëve dhe mbetjeve bimore në vend të miratuar, si dhe mbushjen e gropës së krijuar me dhe të përshtatshëm dhe ngjeshjen e lehtë për rikthimin e nivelit fillestar të terrenit.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër trungu Φ 10–20 cm përfshin prerjen e kontrolluar të trungut dhe degëve kryesore për pemë me diametër 10–20 cm të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe trajtimin pasues të materialit drunor dhe sipërfaqes së terrenit. Lartësia e prerjes në trung kryhet sa më afër nivelit të tokës, ndërsa degët anësore priten dhe sistemohen para ose pas rrëzimit sipas kushteve të terrenit. Prosesi përfshin prerjen në segmente të

transportueshme, grumbullimin, ngarkimin dhe largimin e materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimin dhe nivelimin e sipërfaqes pas përfundimit të punimeve.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër trugu Φ 21–40 cm përfshin prerjen e kontrolluar dhe rrëzimin e pemëve me diametër 21–40 cm të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe trajtimin, segmentimin dhe largimin e materialit drunor nga vendpunimi. Para rrëzimit kryhet pastrimi i degëve anësore sipas nevojës për të siguruar qasje dhe stabilitet gjatë prerjes, ndërsa trungjet priten në segmente të menaxhueshme për transport ose magazinim. Lartësia e cungut pas prerjes nuk duhet të kalojë 5–10 cm nga niveli i tokës, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në projekt. Punimet përfshijnë grumbullimin, ngarkimin, transportin dhe largimin e materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimin dhe sistemimin e sipërfaqes së ndërhyrjes. Zbatimi realizohet në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale dhe masave të kontrollit të zonës së punës.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër trugu Φ 41–75 cm përfshin prerjen profesionale, rrëzimin e kontrolluar dhe trajtimin e pemëve me diametër 41–75 cm të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe segmentimin dhe largimin e materialit drunor nga vendpunimi. Lartësia e cungut pas prerjes nuk duhet të kalojë 5–10 cm nga niveli i tokës. Punimet përfshijnë grumbullimin, ngarkimin, transportin dhe largimin e materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimin dhe sistemimin përfundimtar të sipërfaqes së ndërhyrjes. Zbatimi kryhet në përputhje me standardet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, me izolimin e zonës së punës dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale.

Rrafshimi i skarpatës përfshin formësimin, nivelimin dhe stabilizimin e sipërfaqeve të pjerrëta të terrenit me qëllim arritjen e profilit të projektuar dhe sigurimin e qëndrueshmërisë gjeoteknike. Pjerrësia e skarpatës përcaktohet sipas kushteve të tokës dhe parametrave teknikë, zakonisht në raporte 1:1.5 deri 1:2 ose sipas specifikimeve gjeoteknike, ndërsa sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e njëtrajtshme, pa gropa, dalje apo masa të paqëndrueshme dheu. Trashësia e shtresës së punimit dhe thellësia e ndërhyrjes varen nga konfigurimi ekzistues i terrenit, ndërsa materialet e tepërta ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar. Pas rrafshimit kryhet ngjeshja e kontrolluar e sipërfaqes me mjete vibruese ose me kalim të përsëritur të makinerisë për të siguruar stabilitet dhe për të reduktuar rrezikun e erozionit ose rrëshqitjes. Në rast nevoje parashikohet vendosja e shtresës mbrojtëse me dhe vegjetativ ose masa të tjera stabilizuese. Zbatimi realizohet në përputhje me kërkesat e sigurisë në punë dhe me kontroll të vazhdueshëm të parametrave gjeometrikë, ndërsa shërbimi aplikohet në infrastrukturë rrugore, parcela ndërtimore dhe zona të gjelbëruara ku kërkohet formësim dhe stabilizim i terrenit të pjerrët.

Mirëmbajtja e murit prej guri me llaç çimento M25 përfshin riparimin, përforcimin dhe rikthimin e integritetit strukturor të muraturës ekzistuese të ndërtuar me gurë natyrorë dhe llaç çimentoje me klasë rezistence M25. Procesi konsiston në pastrimin e fugave të dëmtuara ose të zbrazura deri në thellësi të mjaftueshme për ankorim të ri, largimin e pjesëve të lira ose të degraduara të llaçit dhe gurëve, si dhe zëvendësimin ose rivendosjen e elementeve të dëmtuara me gurë me karakteristika të ngjashme fiziko-mekanike. Përgatitja e llaçit realizohet me çimento që siguron rezistencë karakteristike në shtypje rreth 25 MPa, me raport përzierjeje sipas kërkesave teknike

dhe me përdorim agregatesh të pastra dhe ujë të kontrolluar për të garantuar punueshmëri dhe qëndrueshmëri. Fugat mbushen plotësisht dhe ngjeshen për të siguruar aderencë të mirë ndërmjet gurit dhe llaçit, ndërsa sipërfaqja përfundimtare trajtohet për të ruajtur pamjen ekzistuese të murit. Në rast nevojë përfshihet edhe stabilizimi lokal i murit përmes përforsimeve të pjesshme, rregullimi i pjerrësisë dhe sistemimi i pjesës së sipërme për të parandaluar depërtimin e ujërave. Punimet realizohen në përputhje me standardet e sigurisë në punë dhe me kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së materialeve dhe zbatimit, ndërsa shërbimi aplikohet në mure mbajtëse, rrethuese ose dekorative prej guri ku kërkohet mirëmbajtje dhe rikthim i funksionalitetit strukturor.

Transporti i materialeve të ndërtimit dhe dheut me automjetet deri në distancë 3 km përfshin ngarkimin, bartjen, shkarkimin dhe shpërndarjen e materialeve ndërtimore ose masave të dheut nga vendi i origjinës në destinacionin e përcaktuar brenda rrezes maksimale prej 3 km. Ngarkimi kryhet me mjete mekanike si eskavator ose ngarkues frontal, ose në mënyrë manuale kur kërkohet, duke siguruar shpërndarje të barabartë të ngarkesës dhe mbulim të materialit për të shmangur derdhjen gjatë transportit. Shkarkimi realizohet në vendin e përcaktuar, me vetëshkarkim ose me mjete ndihmëse, dhe përfshin sistemimin paraprak sipas kërkesës. Çmimi përfshin të gjitha kostot e operimit të automjetit, karburantin, amortizimin, fuqinë punëtore, si dhe kohën e pritjes së arsyeshme për ngarkim dhe shkarkim brenda kushteve normale të punës. Shërbimi zbatohet në përputhje me rregullat e sigurisë në punë dhe të qarkullimit rrugor, si dhe me masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë transportit të materialeve.

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Kuç, Tërbaç dhe Shën Vasil përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe prezantimin e sipërfaqeve të varrezave në përputhje me standardet e kujdesit memorial dhe respektit për të rënët. Procesi përfshin pastrimin e gjelbërimit të mbetur, prerjen e barit dhe bimëve të panevojshme, pastrimin e rrugicave dhe hapësirave përreth, si dhe kontrollin dhe riparimin e elementeve të muraturës, pllakatave, gurëve dhe tabelave për identifikim. Në rast nevojë do të kryhen punime për restaurimin e shtresës mbrojtëse të gurëve dhe përforsimin e strukturave të dëmtuara. Gjethet, mbeturinat dhe materialet bimore të grumbulluara largohen dhe transportohen në vend të miratuar sipas rregullave të mjedisit. Punimet realizohen me përdorimin e mjeteve manuale ose mekanike sipas nevojës dhe duke respektuar ambientin dhe qetësinë e zonës, si dhe me respekt të plotë për memorialin dhe të rënët. Procedura përfshin gjithashtu kontroll të rregullt dhe raportim mbi gjendjen e varrezave, për të siguruar që hapësirat të mbeten të rregulluara, të pastra dhe të sigurt për vizitorët. Shërbimi zbatohet në përputhje me rregullat e sigurisë në punë dhe masat për mbrojtjen e mjedisit, duke garantuar respekt dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të hapësirave memoriale.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe oborreve të shkollave për sipërfaqe 1000 m² përfshin një gamë punimesh të organizuara për pastrimin, rregullimin dhe sigurimin e qarkullimit të sigurt brenda hapësirave të shkollës. Procesi përfshin heqjen e mbeturinave, gjeheve, mbetjeve të bimëve dhe materialeve të tjera të lëshuara nga aktivitetet e përditshme, pastrimin mekanik ose manual të sipërfaqes së rrugëve dhe oborreve, rrafshimin e pjesëve të dëmtuara të tokës ose asfaltit dhe

nivelimin e zonave me pabarazi. Në rast nevojë realizohet riparimi i shtresës sipërfaqësore, pastrimi i kanalizimeve të ujërave dhe rregullimi i pengesave që mund të rrezikojnë qarkullimin e fëmijëve dhe stafit. Punimet kryhen me përdorim të mjeteve manuale dhe mekanike sipas kushteve të terrenit, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e infrastrukturës ekzistuese. Mbledhja dhe largimi i mbeturinave realizohet në vend të miratuar, në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, sipërfaqe të pastra, të sigurt dhe funksionale për nxënësit dhe personelin, duke përmirësuar higjienën dhe paraqitjen e hapësirave të shkollës.

Fidane lule dekorative përfshin furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e bimëve të reja të përdorura për qëllime dekorative në hapësira publike, kopshtore ose brenda ambienteve të organizuara. Procesi realizohet duke përzgjedhur fidane me cilësi të lartë, me rrënjë të shëndetshme dhe me karakteristika të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës së vendosjes. Fidane lule dekorative vendosen në tokë të përgatitur paraprakisht, ku janë pastruar mbeturinat dhe është kryer përgatitja e shtresës së mbjelljes me dhe të ushqyeshëm dhe drenazh të përshtatshëm. Pas vendosjes, fidanet ujitën në mënyrë të kontrolluar dhe trajtohen sipas nevojës me plehëra, mbrojtje ndaj sëmundjeve dhe përkujdesje për rritjen e shëndetshme. Punimet përfshijnë gjithashtu sistemimin estetik të grupimeve të bimëve, mbrojtjen e tyre nga dëmtimet fizike dhe kontrollin e rregullt të gjendjes së fidaneve. Mbledhja e mbeturinave bimore dhe pastrimi i hapësirës realizohen në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve dhe standardet e higjienës. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të hapësirave ku vendosen fidane lule dekorative.

Fidane shkurre dekorative “Oleander” përfshin furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shkurreve Oleander në hapësira dekorative, kopshtore ose përgjatë rrugëve dhe hapësirave publike. Procesi realizohet duke përzgjedhur fidane të shëndetshme, me rrënjë të forta dhe karakteristika të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës së vendosjes. Tokat për mbjellje përgatiten paraprakisht duke pastruar mbeturinat dhe duke siguruar shtresë toke të ushqyeshme me drenazh të mirë. Fidane Oleander vendosen në distanca të rregulluara dhe trajtohen pas mbjelljes me ujitje të rregullt, plehërim dhe masat e nevojshme për mbrojtje nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Punimet përfshijnë gjithashtu sistemimin estetik të shkurreve, mbledhjen e mbeturinave bimore dhe pastrimin e zonës së punës në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve dhe higjienës. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme, mirëmbajtje të vazhdueshme dhe prezantim estetik të hapësirave ku vendosen fidane shkurre dekorative Oleander, duke kontribuar në përmirësimin e pamjes vizuale dhe funksionalitetit të hapësirave publike.

Fidane shkurre dekorative Juniperus V18 grup 3, vendosur çdo 6.6 m, përfshin furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shkurreve dekorative Juniperus me madhësi V18, në grupe prej tre njësi, për krijimin e vijave dekorative ose mbrojtëse në hapësira publike, kopshtore ose përgjatë rrugëve. Procesi realizohet duke përzgjedhur fidane të shëndetshme, me rrënjë të forta dhe karakteristika të përshtatshme për klimën dhe tokën e vendosjes. Tokat për mbjellje përgatiten paraprakisht duke pastruar mbeturinat, duke siguruar shtresë toke të ushqyeshme dhe drenazh të mirë, dhe duke krijuar hapësirën e nevojshme për grupimin e tre shkurreve në distancën e

përcaktuar 6.6 m. Fidane Juniperus vendosen në mënyrë të kontrolluar dhe trajtohen pas mbjelljes me ujitje të rregullt, plehërim dhe masat e nevojshme për mbrojtje nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Punimet përfshijnë gjithashtu mbledhjen e mbeturinave bimore, pastrimin e zonës së punës dhe sigurimin e prezantimit estetik të grupeve të shkurreve. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme, mirëmbajtje të vazhdueshme dhe paraqitje vizuale të harmonizuara të hapësirave ku vendosen fidane shkurre dekorative Juniperus V18, duke kontribuar në funksionalitetin dhe bukurinë e hapësirave publike ose kopshtore.

Mirëmbajtja e luleve dekorative përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe kujdesin e vazhdueshëm të luleve të vendosura në hapësira publike, kopshtore ose dekorative. Procesi përfshin ujitjen e rregullt sipas nevojës së bimëve dhe kushteve klimatike, plehërimin me lëndë ushqyese të përshtatshme për llojin e luleve, heqjen e pjesëve të vyera ose të dëmtuara dhe trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave bimore, mbledhjen e gjetheve dhe lulave të thata, si dhe nivelimin dhe sistemimin estetik të sipërfaqes për të ruajtur paraqitjen vizuale të luleve. Për siguri dhe shëndet të bimëve, fushat e mbjelljes kontrollohen rregullisht për lagështinë e tokës, dendësinë e bimëve dhe rritjen e shëndetshme. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të hapësirave dekorative, duke kontribuar në bukurinë vizuale dhe funksionalitetin e hapësirave publike ose kopshtore.

Plehrimi i pemëve me pleh kimik lloji 12-12-17 përfshin aplikimin e një përzierjeje të kontrolluar të lëndëve ushqyese (azot, fosfor dhe kalium në raport 12-12-17) për të siguruar rritje të shëndetshme, forcim të sistemit rrënjor dhe zhvillim optimal të frutave dhe gjetheve. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e plehut sipas madhësisë dhe gjendjes së pemëve, duke shpërndarë materialin në bazamentin e trungut ose sipas metodave të projektit, në mënyrë të barabartë dhe të kontrolluar. Pas aplikimit, plehu mund të përthithet më mirë duke ujitur pemët sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të siguruar tretje dhe absorbim maksimal nga rrënjët. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të mbetura pas shpërndarjes dhe kontrollin e gjendjes së pemëve pas aplikimit për të vlerësuar efektivitetin e plehimit. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme të pemëve dhe përmirësim të prodhimit frutor dhe estetik, duke kontribuar në stabilitetin dhe bukurinë e hapësirave të gjelbërta dhe kopshtore.

Plehrimi i pemëve me ure përfshin aplikimin e azotit në formë të përqendruar për të stimuluar rritjen e gjetheve, rigjenerimin e pjesëve të reja dhe forcimin e sistemit rrënjor. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e duhur të ure-s sipas madhësisë, gjendjes dhe llojit të pemës, dhe shpërndarjen e saj rreth bazamentit të trungut në mënyrë të barabartë, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me trungun ose gjethët për të parandaluar djegien. Pas aplikimit, pemët ujitin sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të favorizuar tretjen dhe absorbimin e azotit nga rrënjët. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të plehut nga sipërfaqja dhe kontrollin e gjendjes së pemëve pas aplikimit për të vlerësuar efektivitetin e plehimit. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme dhe të kontrolluar të pemëve, përmirësim të prodhimit frutor dhe forcim të

gjelbërimin, duke kontribuar në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe bukurinë e hapësirave kopshtore ose publike.

Plehrimi i pemëve me pleh kimik lloji 20-20-20 përfshin aplikimin e një përzierjeje të balancuar të azotit, fosforit dhe kaliumit në raport 20-20-20 për të stimuluar rritjen e përgjithshme të pemëve, forcimin e sistemit rrënjor dhe zhvillimin optimal të gjethëve dhe frutave. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e plehut sipas madhësisë dhe gjendjes së pemëve, dhe duke shpërndarë materialin në bazamentin e trungut në mënyrë të barabartë dhe të kontrolluar, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me gjethët ose trungun për të parandaluar dëmtimin. Pas aplikimit, pemët ujitën sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të siguruar tretje dhe absorbim maksimal të lëndëve ushqyese. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të mbetura pas shpërndarjes dhe kontrollin e gjendjes së pemëve pas aplikimit për të vlerësuar efektivitetin e plehimit. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe të kontrolluar të pemëve, përmirësim të prodhimit frutor dhe forcim të gjelbërimit, duke kontribuar në stabilitetin, shëndetin dhe bukurinë e hapësirave kopshtore ose publike.

Trajtimi i pemëve me ilaç për spërkatje kundër morave, krimbave dhe dëmtuesve të tjerë përfshin aplikimin e një pesticide të përshtatshëm për kontrollin e insekteve dhe parazitëve që mund të dëmtojnë gjethët, degët dhe frutat. Procesi realizohet duke përzgjedhur ilaçin e duhur sipas llojit të pemës, dëmtuesve të pranishëm dhe udhëzimeve teknike të produktit, dhe duke përgatitur përzierjen në përqindjet e rekomanduara për spërkatje. Spërkatja kryhet në mënyrë uniforme në të gjithë pjesët e pemës, duke përfshirë gjethët, degët dhe trungun sipas nevojës, me përdorimin e pompave ose spërkatësve mekanikë, dhe duke respektuar masat e sigurisë për operatorët dhe ambientin. Pas aplikimit, mbeturinat e ilaçit menaxhohen në përputhje me rregullat e mbrojtjes së mjedisit, ndërsa pemët monitorohen për efektivitetin e trajtimit dhe mundësinë e nevojës për spërkatje përsëritëse. Shërbimi garanton mbrojtje të vazhdueshme të pemëve nga dëmtuesit, ruajtjen e shëndetit të tyre, përmirësimin e prodhimit frutor dhe ruajtjen e gjelbërimit, duke kontribuar në qëndrueshmëri dhe bukuri të hapësirave kopshtore ose publike.

Mirëmbajtja e barit përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe zhvillimin e shëndetshëm të sipërfaqeve të gjelbëruara. Procesi përfshin prerjen e rregullt të barit në lartësinë e duhur për të siguruar densitet, uniformitet dhe rigjenerim të shëndetshëm të rrënjëve, largimin e mbeturinave bimore, gjetheve dhe pjesëve të thata, si dhe përmirësimin e ajrosjes së tokës përmes veprimeve të lehta mekanike ose manuale si skarifikimi. Gjatë mirëmbajtjes mund të aplikohet plehërim i kontrolluar dhe ujitje sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të ruajtur shëndetin dhe ngjyrën e gjelbër të barit. Punimet përfshijnë gjithashtu kontrollin e dëmtuesve dhe trajtimin kundër sëmundjeve ose insekteve që mund të dëmtojnë sipërfaqen e gjelbëruar. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme, densitet dhe paraqitje estetike të barit, duke kontribuar në funksionalitetin dhe bukurinë e hapësirave kopshtore, oborreve, lëndinave sportive dhe zonave publike.

Mbjellja e barit përfshin përgatitjen, kultivimin dhe vendosjen e farës ose trungjeve të barit për krijimin e sipërfaqeve të gjelbëruara të shëndetshme dhe uniforme. Procesi fillon me pastrimin e tokës nga mbeturinat, gurët dhe bimët e padëshiruara, nivelimin dhe tharjen e sipërfaqes, dhe

përmirësimin e tokës me shtresa toke të ushqyeshme, plehërim dhe drenazh të përshtatshëm për rritje optimale. Farat ose trungjet e barit shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme dhe sipas dendësisë së kërkuar, pasuar nga ngjeshja e lehtë e tokës për të siguruar kontakt të mirë me substratin dhe mundësinë e një mbirjeje uniforme. Pas mbjelljes, bari ujitet sipas nevojës dhe kushtimeve klimatike për të favorizuar mbirjen dhe zhvillimin e shëndetshëm, dhe mund të trajtohet me plehërim të kontrolluar ose masa mbrojtëse ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave, monitorimin e mbirjes dhe mirëmbajtjen fillestare për të siguruar dendësi, ngjyrë dhe shëndet optimal të barit. Shërbimi garanton krijimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, funksionale dhe estetike tërheqëse në hapësira kopshtore, oborre, lëndina sportive ose zona publike.

Krasitja e pemëve përfshin prerjen dhe formësimin e degëve dhe kurorës së pemës për të siguruar rritje të shëndetshme, forcim të strukturës dhe prezantim estetik të pemës. Procesi realizohet duke hequr degët e thata, të sëmura, të dëmtuara ose të panevojshme, si dhe duke rregulluar formën e kurorës për të lehtësuar qarkullimin e ajrit, depërtimin e dritës dhe zhvillimin e pjesëve të reja. Pas kryerjes së krasitjes, degët dhe mbeturinat bimore grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar sipas rregullave të menaxhimit të mbetjeve, ndërsa sipërfaqja e ndërhyrjes pastrohet dhe sistemohen zonat përreth. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme të pemëve, forcim të strukturës dhe prezantim estetik të hapësirave publike, kopshtore ose oborreve, duke kontribuar në funksionalitetin, bukurinë dhe sigurinë e hapësirave të gjelbëruara.

Mirëmbajtja e pemëve përfshin një seri punimesh të organizuara për ruajtjen, zhvillimin e shëndetshëm dhe prezantimin estetik të pemëve në hapësira publike, kopshtore ose oborre. Procesi përfshin krasitjen e degëve të thata, të sëmura ose të panevojshme, kontrollin dhe trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve, plehërimin dhe ujitjen sipas nevojës për të siguruar rritje optimale, forcim të sistemit rrënjor dhe zhvillim të gjethëve dhe frutave. Gjithashtu përfshihet grumbullimi dhe largimi i mbeturinave bimore, pastrimi i zonës së punës dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së pemëve për të vlerësuar efektivitetin e masave të mirëmbajtjes. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme, forcim të strukturës, mbrojtje nga dëmtuesit dhe prezantim estetik të hapësirave me pemë, duke kontribuar në bukurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e gjelbërimit në zonat publike, kopshtore dhe oborret.

Bordura e gjelbërt përfshin krijimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e një vijë dekorative me bimë të ulëta ose shkurre të kontrolluara që përdoren për ndarjen vizuale të hapësirave, formësimin e kopshtit dhe përmirësimin estetik të mjedisit. Procesi fillon me përzgjedhjen e bimëve të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës, përgatitjen e tokës për mbjellje duke pastruar mbeturinat, shtresuar dhe ushqyer tokën dhe siguruar drenazh të mjaftueshëm. Bimët vendosen në distanca të njëtrajtshme sipas projektit dhe trajtohen pas mbjelljes me ujitje të rregullt, plehërim dhe kujdes kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu mbledhjen e mbeturinave bimore, kontrollin e rritjes dhe sistemimin estetik të bordurës për të ruajtur uniformitetin dhe prezantimin vizual. Shërbimi garanton krijimin dhe mirëmbajtjen e një bordure të gjelbërt të shëndetshme, estetike dhe funksionale, duke kontribuar në organizimin e

hapësirave kopshtore, oborreve dhe zonave publike dhe në përmirësimin e paraqitjes së përgjithshme të mjedisit.

Transporti i mbetjeve përfshin mbledhjen, ngarkimin, bartjen dhe largimin e materialeve të mbetura nga një vendpunim ose hapësirë në një vend të miratuar për trajtim ose asgjësim. Procesi realizohet me mjete të përshtatshme transporti, si kamionë, automjete vetëshkarkuese ose kontenierë, duke siguruar ngarkesë të barabartë dhe mbulim të materialeve të lirshme për të shmangur shpërndarjen gjatë transportit. Mbledhja përfshin grumbullimin e mbetjeve, përfshirë mbeturinat bimore, materiale ndërtimi ose të tjera, dhe ngarkimin me mjete manuale ose mekanike sipas nevojës. Shkarkimi kryhet në vendin e miratuar sipas rregullave të menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Transporti i mbetjeve zbatohet duke respektuar rregullat e sigurisë në punë dhe të qarkullimit rrugor, duke minimizuar rrezikun për operatorët dhe ambientin. Shërbimi garanton pastrim, mirëmbajtje dhe ruajtje të higjienës në vendpunime, oborre, hapësira publike dhe kopshtore, duke kontribuar në organizimin, funksionalitetin dhe estetikën e hapësirave të trajtuara.

Vaditja e pemëve përfshin furnizimin e pemëve me ujë të mjaftueshëm dhe të kontrolluar për të siguruar rritje të shëndetshme, zhvillim optimal të gjethëve, frutave dhe sistemit rrënjor, veçanërisht gjatë periudhave me mungesë reshjesh ose kushte të thata. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e ujit sipas madhësisë, moshës dhe llojit të pemës, si dhe kushteve klimatike dhe tipit të tokës. Ujitja kryhet në mënyrë të drejtuar në bazamentin e trungut ose në zonën rrënjore, me mjete manuale, shiringa ujitëse ose sisteme vaditëse mekanike, për të siguruar depërtim të ujit dhe absorbim maksimal. Gjatë punës sigurohet që të shmangët përmbytja e tokës ose dëmtimi i trungut dhe rrënjëve. Procedura përfshin gjithashtu kontrollin e gjendjes së pemëve pas vaditjes dhe mbikëqyrjen e nivelit të lagështisë së tokës për të përcaktuar nevojat e ardhshme për ujitje. Shërbimi garanton ruajtjen e shëndetit, forcimin e sistemit rrënjor, zhvillim të gjelbërimit dhe prodhim frutor optimal, duke kontribuar në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe bukurinë e hapësirave kopshtore, publike ose oborreve.

Skarifikimi i barit me lopatë përfshin hapjen, pastrimin dhe përpunimin e sipërfaqes së barit për të përmirësuar ajrosjen, thithjen e ujit dhe depërtimin e lëndëve ushqyese në tokë, duke stimuluar rritjen e shëndetshme dhe densitetin e barit. Pasi të kryhet skarifikimi, sipërfaqja mund të ujitet ose të përgatitet për mbjellje ose mbulim të shtresave të reja të tokës ose farës, sipas nevojës. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të mbledhura dhe kontrollin e uniformitetit të sipërfaqes së përpunuar për të garantuar efekt optimal. Shërbimi siguron përmirësim të densitetit, shëndetit dhe prezantimit estetik të barit, duke kontribuar në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe bukurinë e lëndinave, oborreve ose hapësirave kopshtore.

Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm përfshin heqjen e bimëve të vogla, të pangjitura ose të dëmtuara për të kontrolluar zhvillimin e vegjetacionit, liruar hapësirat e gjelbëruara dhe përmirësuar paraqitjen estetike të terrenit. Procesi realizohet duke përdorur mjete manuale si sharrë dore, gërrshërë ose lopatë për të prerë trungjet dhe degët e vogla në lartësi të përshtatshme, duke shmangur dëmtimin e bimëve të afërta të shëndetshme. Pjesët e prerë grumbullohen, ngarkohen dhe largohen në vend të miratuar, ndërsa sipërfaqja pastrohet dhe

sistemohen zonat përreth për të siguruar qasje dhe paraqitje të rregullt. Punimet përfshijnë gjithashtu monitorimin e bimëve të mbetura dhe trajtimin sipas nevojës për të parandaluar rritjen e pakontrolluar ose shfaqjen e dëmtuesve. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, zhvillim të shëndetshëm të bimëve, rritje të estetikës dhe funksionalitetit të hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Shkulja e rrënjëve të bimëve të vogla përfshin heqjen e plotë të rrënjëve të bimëve të vogla, të pangjitura ose të dëmtuara për të parandaluar rigjenerimin e tyre, liruar hapësirat e gjelbëruara dhe përgatitur terrenin për mbjellje, mirëmbajtje ose punime të tjera. Rrënjët e nxjerra grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar për asgjësim ose përdorim tjetër sipas rregullave të menaxhimit të mbetjeve. Pas punës, sipërfaqja pastrohet dhe nivelizohet për të siguruar paraqitje të rregullt dhe qasje të lirë për ndërhyrje të mëtejshme. Shërbimi garanton kontroll të qëndrueshëm të bimëve të padëshiruara, mirëmbajtje të vazhdueshme të hapësirave gjelbëruese dhe krijim të kushteve të favorshme për rritjen e bimëve të dëshiruara, duke kontribuar në estetikën, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër Φ 10–20 cm përfshin prerjen profesionale, rregullimin dhe trajtimin e pemëve me diametër të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe largimin ose segmentimin e materialit drunor sipas nevojës. Degët e panevojshme ose të dëmtuara hiqen paraprakisht për të siguruar qasje dhe stabilitet gjatë operacionit, ndërsa trungjet priten në segmente të transportueshme sipas kërkesave të projektit. Pas prerjes kryhet grumbullimi, ngarkimi dhe transporti i materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimi dhe nivelimi i sipërfaqes për të ruajtur estetikën dhe funksionalitetin e hapësirës. Punimet zbatohet duke respektuar standardet e sigurisë në punë dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, ndërsa kapaciteti i realizimit varet nga numri i pemëve, konfigurimi i terrenit dhe qasja në lokacion. Shërbimi siguron mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të pemëve, duke kontribuar në bukurinë dhe funksionalitetin e hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër Φ 41–75 cm përfshin prerjen profesionale, rregullimin dhe trajtimin e pemëve të mëdha me diametër të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, për të siguruar shëndet, stabilitet dhe prezantim estetik, si dhe për të lehtësuar qarkullimin ose punimet në hapësirë. Degët e panevojshme, të sëmura ose të dëmtuara hiqen paraprakisht për të siguruar qasje të sigurt dhe stabilitet gjatë prerjes, ndërsa trungjet priten në segmente të transportueshme sipas kërkesave të projektit. Pas prerjes, pjesët e drurit grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar, ndërsa sipërfaqja pastruar dhe sistemuar për të ruajtur estetikën dhe funksionalitetin e hapësirës. Punimet kryhen duke respektuar standardet e sigurisë në punë dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, dhe kapaciteti i zbatimit varet nga madhësia e pemëve, konfigurimi i terrenit dhe qasja në lokacion. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme, forcim të strukturës dhe prezantim estetik të hapësirave me pemë, duke kontribuar në bukurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Transporti i materialeve të ndërtimit dhe dheut me automjetet deri në distancë 3 km përfshin ngarkimin, bartjen dhe shkarkimin e materialeve nga vendi i origjinës në destinacionin e përcaktuar brenda rrezes maksimale prej 3 km. Procesi realizohet me automjete të përshtatshme transporti, si kamionë vetëshkarkues ose kamionë me karroceri të hapur, me kapacitet mbajtës sipas ngarkesave të lejuara, duke siguruar shpërndarje të barabartë dhe mbulim të materialit për të shmangur derdhjen gjatë lëvizjes. Ngarkimi kryhet me mjete mekanike, si eskavator ose ngarkues frontal, ose manualisht kur kërkohet, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e materialeve. Shkarkimi realizohet në vendin e përcaktuar, me sistem vetëshkarkimi ose mjete ndihmëse, dhe materialet mund të sistemohen sipas kërkesës për përdorim të mëtejshëm. Çmimi njësi përfshin të gjitha kostot operative, duke përfshirë karburantin, amortizimin, fuqinë punëtore dhe kohën e pritjes për ngarkim dhe shkarkim brenda kushteve normale. Shërbimi garanton transport të sigurt, të shpejtë dhe efikas të materialeve të ndërtimit dhe dheut, duke kontribuar në funksionalitetin dhe vijimësinë e punimeve ndërtimore.

Mirëmbajtja e kodrave dhe lisave në Pilur përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe zhvillimin e shëndetshëm të pemëve dhe hapësirave gjelbëruese në terrenet kodrinore. Procesi përfshin krasitjen e degëve të thata ose të dëmtuara, shkëlqjen e bimëve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit ekzistues, për të përmirësuar prezantimin vizual dhe stabilitetin e pemëve. Tokat dhe zonat rreth lisave pastrohen nga mbeturinat bimore, gjethet e thata dhe pjesët e vyera, ndërsa bari dhe bimët e vogla rregullohen ose priten sipas nevojës. Në rast të nevojës, kryhet plehërim, vaditje ose trajtim kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve për të siguruar rritje të shëndetshme dhe forcim të sistemit rrënjor. Punimet realizohen me mjete manuale ose mekanike, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e pemëve ose mjedisit përreth. Gjithashtu përfshihet grumbullimi dhe largimi i mbeturinave, pastrimi i sipërfaqeve dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së pemëve dhe kodrave. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme, stabilitet dhe prezantim estetik të lisave dhe hapësirave kodrinore, duke kontribuar në bukurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e zonës në Pilur.

Mirëmbajtja e murit prej guri mbajtës dhe themeleve të ndërtuara me llac cemento M25 përfshin një seri punimesh për ruajtjen, përforcimin dhe restaurimin e strukturës ekzistuese të murit. Procesi përfshin inspektimin e murit për të identifikuar dëmtime, çarje ose dobësime në lidhjet e gurëve dhe llacit, pastrimin e sipërfaqeve nga pluhuri, gëlqeri e rrënojat e tjera, dhe riparimin e pjesëve të dëmtuara duke përdorur llac cemento M25 sipas standardeve të ndërtimit. Punimet mund të përfshijnë rivendosjen e gurëve të zhvendosur, mbushjen e çarjeve, përforcimin e themeleve dhe sigurimin e stabilitetit të murit. Gjatë mirëmbajtjes respektohen masat e sigurisë dhe përdoren mjete manuale ose mekanike sipas nevojës, duke shmangur dëmtimin e strukturës ekzistuese. Pas kryerjes së ndërhyrjeve, zona pastrohet nga mbeturinat e gurëve dhe llacit, ndërsa murit i sigurohet trajtim mbrojtës për rezistencë të zgjatur ndaj erozionit dhe faktorëve atmosferikë. Shërbimi garanton ruajtjen e integritetit struktural, stabilitetin dhe prezantimin estetik të murit mbajtës dhe themeleve, duke kontribuar në funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e objekteve ndërtimore.

Gropat për fidanet e rinj 40×40×40 cm përfshijnë përgatitjen e tokës dhe hapjen e gropave të përshtatura për vendosjen e fidaneve të reja në hapësira kopshtore, oborre ose zona publike. Procesi realizohet duke përcaktuar vendet sipas projektit, pastruar zonën nga mbeturinat dhe bimët e padëshiruara, dhe hapur gropa me dimensionet e kërkuara 40×40×40 cm, duke siguruar thellësi dhe gjerësi të mjaftueshme për zhvillimin optimal të sistemit rrënjor. Tokat e nxjerra mund të përpunohen me pleh ushqyes ose të kombinohen me tokë të pasur për të favorizuar rritjen e shëndetshme të fidaneve. Pas hapjes, gropat ujiten lehtë dhe fidanet vendosen me kujdes, duke mbuluar rrënjët me tokë të përgatitur dhe ngjeshur butësisht për stabilitet. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të nxjerra, sistemimin estetik të hapësirës përreth dhe monitorimin fillestar të ujitjes dhe gjendjes së fidaneve për të siguruar mbirje të shëndetshme. Shërbimi garanton vendosje të saktë, rritje optimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të fidaneve, duke kontribuar në bukurinë dhe funksionalitetin e hapësirave kopshtore dhe publike.

Mbjellja e fidaneve të rinj përfshin vendosjen e bimëve të reja në tokë të përgatitur për të siguruar rritje të shëndetshme, zhvillim optimal të rrënjëve dhe prezantim estetik të hapësirave kopshtore, oborre ose publike. Procesi fillon me përzgjedhjen e fidaneve të shëndetshme dhe të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës, si dhe përgatitjen e tokës duke pastruar mbeturinat, gërmuar sipërfaqen dhe përforcuar shtresën e tokës me lëndë ushqyese sipas nevojës. Fidanet vendosen në gropa të përgatitura paraprakisht, me thellësi dhe gjerësi të përshtatshme për rrënjët, dhe mbulohen me tokë të ngjeshur butësisht për stabilitet. Pas mbjelljes, fidanet ujiten në mënyrë të kontrolluar dhe mund të trajtohen me plehëra ose mbrojtje kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave, sistemimin estetik të hapësirës dhe monitorimin fillestar të zhvillimit të fidaneve për të siguruar mbirje të shëndetshme. Shërbimi garanton vendosje të saktë, mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të hapësirave gjelbëruese, duke kontribuar në bukurinë dhe funksionalitetin e kopshtit, oborrit ose hapësirave publike.

Transporti i materialeve të ndërtimit dhe dheut me automjetet deri në distancë 3 km përfshin ngarkimin, bartjen dhe shkarkimin e materialeve nga vendi i origjinës në destinacionin e përcaktuar brenda rrezes maksimale prej 3 km. Procesi realizohet me automjete të përshtatshme transporti, si kamionë vetëshkarkues ose kamionë me karroceri të hapur, me kapacitet të përshtatshëm për ngarkesën, duke siguruar shpërndarje të barabartë dhe mbulim të materialit për të shmangur derdhjen gjatë lëvizjes. Ngarkimi kryhet me mjete mekanike si eskavator ose ngarkues frontal, ose manualisht kur është e nevojshme, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e materialeve. Shkarkimi realizohet në vendin e destinacionit, ku materialet mund të sistemohen sipas kërkesave të punimeve të mëtejshme. Çmimi njësi përfshin të gjitha kostot operative, duke përfshirë karburantin, fuqinë punëtore, amortizimin e automjeteve dhe kohën e pritjes për ngarkim dhe shkarkim brenda kushteve normale. Shërbimi garanton transport të sigurt, të shpejtë dhe efikas të materialeve të ndërtimit dhe dheut, duke kontribuar në vijimësinë dhe funksionalitetin e punimeve ndërtimore.

III.4.4. Në shtojcën 7 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, të dokumenteveve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi që kërkohet:

Nr	Nr.An.	Emërtimi	Njësia	Sasia
<i>I- Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe infrastrukturës në varreza</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	125,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	22,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	3,500
5	3.4	Prerje e sistemim pemësh Φ21-40cm	copë	2,100
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	1,000
7	3.161/1	Rrafshim skarpate	m ²	4,500
8	3.322	Mur guri, Ilaç çimento M25 (mirëmbajtje)	m ³	200
9	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	400
10	an.	Mirëmbajtje varrezat e dëshmorëve Kuç	m ²	1,750
<i>II - Mirëmbajtje rruge për shkolla, kosha, varreza etj</i>				
1	an	Mirëmbajtje rruge për 1,000 m ²	m ²	90,000
1	3.96	F.V. fidane lule dekorative	copë	2,200
2	3.962	F.V. fidane shkurre dekorative "Oleander"	copë	300
3	an.168	F.V. shkurre dekorative Juniperus V18 grup3 cdo 6.6m	copë	200
4	an.	Mirëmbajtje	m ²	2,500
<i>IV-Plehërim i pemëve me pleh kimik</i>				
1	an.	Pleh kimik lloji 12-12-17	kg	3,000
2	an.	Ure	kg	2,500
3	an.	Pleh kimik lloji 20-20-20	kg	2,000
4	an.	Ilaç për spërkatje pemë (kunder morave, krimbave etj)	kg	60
<i>V- Mirëmbajtje bari</i>				
1	an.	Mirëmbajtje bari	m ²	32,000
2	3.643	Mbjellje bari	m ²	10,000
<i>VI- Krasitje pemë në shëtitore dhe trotuare</i>				
1	an.	Krasitje pemë	copë	1,250
2	an	Mirëmbajtje e pemëve	copë	1,250
3	an.	Bordurë e gjelbërt	ml	350

4	an.	Transport mbetjesh	m ³	127
<i>VI-Vaditje e pemëve gjatë sezonit 6-mujor</i>				
1	an.	Vaditje pemësh	copë	1,250
<i>VIII- Mirëmbajtje pishat pranë fushës, kodra</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	95,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	12,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	2,000
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	250
7	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	220
<i>IX- Mirëmbajtje kodra e lisave në Pilur</i>				
1	an.	Mirëmbajtje	m ²	9,000
2	3.322	Mur guri mbajtës e themele, llaç çimento M25, mirëmbajtje	m ³	122
3	an.	Gropa për fidanet e rinj 40x40x40cm	copë	200
4	an.	Mbjellja e fidanëve të rinj	copë	200
5	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	136

III.4.5. Në shtojcën 8 “*Formulari i Termave të Referencës*”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi i mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëruara

1. Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është realizimi i shërbimeve për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, prerjen dhe sistemimin e vegjetacionit, furnizimin dhe mbjelljen e fidaneve, plehërimin dhe trajtimin fitosanitar, transportin e materialeve dhe mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e elementeve ndërtimore dhe infrastrukturore në zona publike, rrugore, shkollore dhe memoriale.

2. Përshkrimi i shërbimeve

Shërbimet që do të realizohen përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon.

Skarifikimi manual i barit me lopatë në thellësi 3–5 cm dhe me distancë prerjesh 10–15 cm duke përfshirë pastrimin e mbetjeve, nivelimin dhe sipas nevojës mbjellje plotësuese dhe plehërim Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm, shkulja e plotë e rrënjëve të tyre, grumbullimi dhe largimi i mbetjeve si dhe nivelimi i sipërfaqes.

Prerja dhe sistemimi i pemëve sipas kategorive të diametrit Φ 10–20 cm, Φ 21–40 cm dhe Φ 41–75 cm duke përfshirë rrëzimin e kontrolluar, segmentimin, transportin e materialit drunor dhe pastrimin përfundimtar të zonës.

Krasitja dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e pemëve duke përfshirë heqjen e degëve të thata ose të dëmtuara, trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe plehërimin sipas nevojës.

Rrafshimi dhe stabilizimi i skarpatave sipas parametrave gjeoteknikë, me ngjeshje të kontrolluar dhe sistemim përfundimtar të sipërfaqes.

Mirëmbajtja dhe riparimi i mureve prej guri dhe mureve mbajtëse me llaç cemento M25 duke përfshirë pastrimin e fugave, zëvendësimin e elementeve të dëmtuara dhe përforcimet e nevojshme.

Transporti i materialeve të ndërtimit, dheut dhe mbetjeve deri në distancë 3 km duke përfshirë ngarkimin, shkarkimin dhe sistemimin sipas kërkesës.

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Kuç, Tërbaç dhe Shën Vasil duke përfshirë pastrim, prerje bari, riparime të elementeve memoriale dhe raportim periodik mbi gjendjen.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe oborreve të shkollave për sipërfaqe 1000 m² duke përfshirë pastrim, rrafshim, sistemim dhe garantim të sigurisë së qarkullimit.

Furnizimi, mbjellja dhe mirëmbajtja e fidaneve lule dekorative, shkurre dekorative Oleander, shkurre dekorative Juniperus V18 grup 3 të vendosura çdo 6 6 m, si dhe krijimi i bordurave të gjelbërta.

Hapja e gropave për fidane 40×40×40 cm dhe mbjellja e fidaneve të rinj me përgatitje toke dhe trajtim pas mbjelljes.

Mbjellja dhe mirëmbajtja e barit duke përfshirë përgatitjen e tokës, mbjelljen, ujitjen, plehërimin dhe kontrollin fitosanitar.

Plehërimi i pemëve me pleh kimik 12-12-17, 20-20-20 dhe ure sipas dozimit teknik dhe kushteve agronomike.

Trajtimi i pemëve me pesticide për spërkatje kundër morave, krimbave dhe dëmtuesve të tjerë sipas udhëzimeve teknike dhe standardeve mjedisore.

Vaditja e pemëve sipas kërkesave biologjike dhe kushteve klimatike.

Mirëmbajtja e kodrave dhe lisave në Pilur duke përfshirë krasitje, pastrim, trajtim dhe stabilizim të terrenit.

3. Kërkesat teknike

Të gjitha punimet duhet të realizohen në përputhje me standardet teknike në fuqi dhe praktikën e mirë profesionale.

Kontraktori duhet të përdorë pajisje dhe makineri të përshtatshme për natyrën e punimeve. Duhet të sigurohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale dhe zbatimi i rregullave të sigurisë në punë.

Materialet e përdorura duhet të jenë cilësore dhe në përputhje me specifikimet teknike. Mbetjet dhe materialet e tepërta duhet të transportohen në vende të miratuara sipas legjislacionit mjedisor.

4. Afati i realizimit

Shërbimet do të realizohen sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe në varësi të kushteve klimatike dhe sezonalitetit të punimeve.

5. Detyrimet e kontraktorit

Të sigurojë staf të kualifikuar dhe të trajnuar.

Të garantojë cilësi dhe realizim korrekt të punimeve.

Të raportojë periodikisht mbi ecurinë e shërbimit.

Të riparojë çdo dëmtim të shkaktuar gjatë realizimit të punimeve.

6. Kontrolli dhe pranimi i shërbimeve

Punimet do të mbikëqyren nga përfaqësues të autoritetit kontraktor.

Pranimi i shërbimeve do të bëhet pas verifikimit të cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat teknike.

III.4.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.7. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës*

dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurorjve të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.8. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.4.9. Neni 41 pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.4.10. Në Vendimin Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 29.04.2022 “Për Përcaktimin e Rregullave, Procedurave dhe Kritereve për Pajisjen me Certifikatën e Ekspertit në Fushën e Pyjeve dhe Kullotave”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatë të ekspertëve në fushën e pyjeve dhe kullotave, në përputhje me veprimtaritë që kërkojnë shërbimin e ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota.

2. Pajisja me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve është e detyrueshme për çdo individ, që kërkon të ushtrojë ekspertizë profesionale për veprimtari të tilla, si supervizimi, studimi, projektimi dhe zbatimi për investimet në pyje dhe kullota në Republikën e Shqipërisë me fonde publike e private.

3. Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Aplikim elektronik”, kërkesa e dorëzuar nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve dhe dorëzimi i dokumenteve që shoqërojnë kërkesën.

b) “Certifikatë”, dokumenti zyrtar i lëshuar nga ministri përgjegjës për pyjet në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, pas plotësimit të kritereve të certifikimit.

c) “Certifikimi i ekspertit në fushën e pyjeve”, ka kuptimin sipas pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

ç) “Ekspert i certifikuar”, ka kuptimin e dhënë sipas pikës 13, të nenit 3, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

d) “Specialist i mesëm”, individi që ka përfunduar studimet dhe është certifikuar dhe/apo diplomuar, referuar përkatësisht niveleve 4 e 5, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, miratuar me ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, të ndryshuar, në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional.

dh) “Veprimtari”, ka kuptimin e dhënë sipas ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për lejet, licencat dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Termat “cikël studimi”, titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, të përdorur në këtë vendim, kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

II. RREGULLAT PËR CERTIFIKIMIN E EKSPERTIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

1. Certifikimi i ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave kryhet nga struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, nëpërmjet aplikimit elektronik në portalin qeveritar “e-Albania”.

2. Kërkuesi aplikon në portalin “e-Albania” për marrjen e certifikatës si ekspert për ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës profesionale në fushën e pyjeve dhe kullotave.

3. Shërbimi i ekspertizës profesionale në pyje dhe kullota ushtrohet nga eksperti për veprimtaritë e mëposhtme:

a) supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, mbikëqyrjen, kolaudimin dhe certifikimin e veprimtarive të prodhimit apo tregtimit të farave, kalemave e fidanëve pyjorë dhe të materialit mbjellës;

b) hartimin e metodikave, udhëzuesve/manualëve, studimeve thellësisht teknike për përdorimin e territorit për zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullor dhe vlerësimin e peizazhit, biodiversitetit, zonave të mbrojtura dhe parqeve kombëtare, florës spontane (bimët mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore), faunës së egër, të rrjetit të burimeve gjenetike, konservimit të germoplazmës dhe parandalimit të rrezikut të zjarreve;

c) hartimin e projekteve të tilla, si projekte komplekse të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhëse, projekte për hartimin e planeve të mbarështimit të pyjeve, kullotave, florës dhe faunës, për pyllëzimet, fidanishtet, trajtimin e pyjeve me prerje kulturore, të sistemeve malore, përmirësimit të kullotave dhe veprave ujëpirëse në to, të mbritshmërisë, ndërtimin e rrugëve autopyjore dhe teleferikëve pyjorë;

ç) zbatimin e projekteve në fushën e pyjeve, ku përfshihet zbatimi i projekteve të shfrytëzimit, të pyllëzimit dhe projektet që dalin në zbatim të objektivave të planit të mbarështimit të pyjeve.

4. Certifikimi i ekspertit kryhet nga ministria përgjegjëse për pyjet, pas verifikimit të plotësisht të kriterëve të certifikimit dhe të dokumentacionit përkatës, të përcaktuara sipas këtij vendimi. Individët, që kanë dorëzuar kërkesë për certifikim, nuk i nënshtrohen testimin të njohurive për marrjen e certifikatës së ekspertit.

5. Tarifa e aplikimit për pajisjen me certifikatën e ekspertit në pyje është 2 000 (dy mijë) lekë.

Kjo tarifë depozitohet në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat, në degën e thesarit ose/dhe elektronikisht përmes platformës qeveritare të pagesave elektronike. Të ardhurat

e përfituara prej tyre derdhen në buxhetin e shtetit.

6. Certifikata e ekspertit në fushën e pyjeve dhe kullotave miratohet nga ministri përgjegjës për pyjet, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”.

7. Lista e ekspertëve të certifikuar sipas shërbimeve të ekspertizës profesionale që ata ofrojnë publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për pyjet e kullotat dhe përditësohet çdo fillim muaji nga struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat në ministri.

III.4.13. Në nenet 3, të ligjit nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se:

Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

III.4.14. Në nenet 7, të ligjit nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

1/1. Zhvilluesi, nëse është e nevojshme, kërkon mendim paraprak nga ministria ose AKM-ja nëse projekti që synon të zhvillojë është objekt i këtij ligji.

2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

3. Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;

b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

4. Metodologjia kombëtare e procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit.

5. Rregullat, përgjegjësitë dhe afatet për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. 6. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton me udhëzim shpjegimin e detajuar të projekteve të parashikuara në shtojcat I dhe II të këtij ligji.

III.4.15. Në nenet 24, të ligjit nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se:

1. Zhvilluesi për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së ngarkon ekspertin e certifikuar nga ministri, i cili mund ta ushtrojë veprimtarinë si person fizik ose si person juridik.

2. Të drejtën për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së e kanë subjektet:

a) personi fizik, i cili është certifikuar si ekspert nga ministri;

b) personi juridik, administratori i të cilit është certifikuar si ekspert nga ministri dhe ka të punësuar me kontratë pune të paktën edhe 1 ekspert të certifikuar nga ministri.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni hartojnë raportin e VNM-së duke krijuar grup specialistësh të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raporti i VNM-së. Raporti i VNM së nënshkruhet nga personi fizik/juridik dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së.

4. Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën.

5. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie hartimin e raporteve të VNM-së.

III.4.16. Në nenin 1 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar parashikohet se:

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

III.4.17. Në nenin 2 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar parashikohet se:

Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

III.4.18. Në nenin 4 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar parashikohet se:

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III.4.19. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.4.20. Autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 “Kapacitetin teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëra, i cili duhet të jetë inxhinier pyjesh i çertifikuar si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme: b) Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor. c) Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave. Vendosijen e kësaj kërkesë për kualifikim autoriteti kontraktor e ka argumentuar, duke u bazuar në parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik dhe konkretisht “në nenin 77, pika 4, e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Nga preventivi rezulton se kontrata përfshin ndërhyrje të gjera në pemë dhe sipërfaqe të gjelbra, konkretisht prerje dhe sistemime pemësh me diametra deri në 75 cm, mirëmbajtje në zona kodrinore dhe me pisha, mbjellje fidanësh të rinj, trajtime me plehra dhe produkte fitosanitare, si dhe ndërhyrje në zona me karakter natyror dhe gjysmë-natyror. Këto aktivitete kërkojnë njohuri të thelluara profesionale mbi biologjinë e pemëve, menaxhimin e masiveve drusore, stabilitetin e terrenit, ndikimin në biodiversitet dhe praktikën e qëndrueshme të mirëmbajtjes. Përcaktimi i një inxhinieri pyjesh si Drejtues Teknik është i domosdoshëm për të garantuar që ndërhyrjet në pemë dhe në zonat e gjelbëra të kryhen sipas praktikave profesionale dhe standardeve teknike, duke shmangur dëmtimet e pakthyeshme të vegjetacionit, prerjet e gabuara, destabilizimin e terrenit apo rreziqe për sigurinë publike. Duke qenë se në preventiv parashikohen ndërhyrje në mijëra elementë drusorë dhe sipërfaqe të mëdha natyrore, drejtimi teknik nga një specialist i fushës është thelbësor për planifikimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së punimeve. Kërkesa për certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor është e justifikuar nga fakti se ndërhyrjet në zona kodrinore, në pisha dhe në hapësira me karakter natyror mund të kenë ndikim mjedisor. Prania e një eksperti me këtë kualifikim garanton që aktivitetet do të vlerësohen dhe do të realizohen në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe me legjislacionin përkatës. Gjithashtu, kërkesa për certifikim si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për supervizimin e aktiviteteve siguron që drejtimi teknik të kryhet nga një profesionist i njohur dhe i autorizuar për të mbikëqyrur ndërhyrje në fondin pyjor dhe hapësirat e gjelbra, duke garantuar standard profesional dhe përgjegjësi teknike. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që shërbimi i gjelbërimit të realizohet nën drejtimin e një specialisti të kualifikuar në fushën e pyjeve dhe mjedisit, në përputhje me standardet profesionale dhe kuadrin ligjor në fuqi”. Nga shqyrtimi i pretendimit të ankimuesit për këtë kriter kualifikues dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit kualifikues lidhur me disponimin në stafin e operatorit ekonomik ofertues të një (një) drejtues teknik inxhinieri pyjesh i pajisur me Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor dhe Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave, është

në porporcion dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës që prokurohet, pasi kjo procedurë prokurimi është kontratë shërbimi dhe furnizimi malli ashtu sikurse përcaktohet edhe vetë nga autoriteti kontraktor në Seksionin 2 “Objekti i Kontratës” pika 2.3 “Lloji i kontratës” të dokumenteve të tenderit të kësaj procedure prokurimi dhe referuar shtojcës 7, ndërkohë që argumentimi i autoriteti kontraktor, i cili shprehet se: “...Përcaktimi i një inxhinieri pyjesh si Drejtues Teknik është i domosdoshëm për të garantuar që ndërhyrjet në pemë dhe në zonat e gjelbëra të kryhen sipas praktikave profesionale dhe standardeve teknike, duke shmangur dëmtimet e pakthyeshme të vegjetacionit, prerjet e gabuara, destabilizimin e terrenit apo rreziqe për sigurinë publike. Duke qenë se në preventiv parashikohen ndërhyrje në mijëra elementë drusorë dhe sipërfaqe të mëdha natyrore, drejtimi teknik nga një specialist i fushës është thelbësor për planifikimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë së punimeve. Kërkesa për certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për auditim mjedisor është e justifikuar nga fakti se ndërhyrjet në zona kodrinore, në pisha dhe në hapësira me karakter natyror mund të kenë ndikim mjedisor. Prania e një eksperti me këtë kualifikim garanton që aktivitetet do të vlerësohen dhe do të realizohen në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe me legjislacionin përkatës. Gjithashtu, kërkesa për certifikim si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për supervizimin e aktiviteteve siguron që drejtimi teknik të kryhet nga një profesionist i njohur dhe i autorizuar për të mbikëqyrur ndërhyrje në fondin pyjor dhe hapësirat e gjelbra, duke garantuar standard profesional dhe përgjegjësi teknike”, qëndron, pasi referuar Shtojcës 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” të dokumenteve të tenderit konstatohet, se objekt - prokurimi është kryerja e shërbimit, gjithashtu edhe objekt - prokurimi është shërbim mirëmbajtje e hapsirave të gjelbëra. Për më tepër, vetë ligji nr.10 440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, fusha e zbatimit të këtij ligji lidhet me zbatimin e projekteve të propozuara nga subjekte private apo publike, ku këto projekte mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre, ndërkohë që edhe objekti i prokurimit të kësaj procedure prokurimi është mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëra dhe për më tepër referuar Shtojcës 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” të dokumenteve të tenderit, konstatohet që procedura ka edhe mirëmbajtje punimesh ndërtimore të cilat mund të shkaktojnë ndikim në mjedisë në mënyrë të tërthortë dhe të drejtpërdrejtë.

Sa më sipër, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatorëve ekonomikë ofertues në stafin e tyre të 1 (një) drejtues teknik inxhinieri pyjesh i pajisur *Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor dhe Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave* sikurse është parashikuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “Kapacitetin teknik” të shtojcës 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit është i argumentuar dhe në porporcion me natyrën dhe llojin e objektit të prokurimit, si dhe për më tepër referuar Shtojcës 7 “Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit” të dokumenteve të tenderit konstatohet se është e nevojshme disponimi i 1

(një) drejtues teknik inxhinieri pyjesh i pajisur *Certifikatë për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditim mjedisor dhe Certifikatë si ekspert në fushën e pyjeve dhe kullotave për: supervizimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e pyjeve dhe kullotave* sikurse është përcaktuar në këtë shtojcë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimus “Albgarden” SHPK nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Albgarden” SHPK, për modifikimin e kriterit 2.3.5. të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, se: *“Pika 5. Në Shtojcën 9, Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, nënpika 2.3.5 nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar kriteri: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë fitosanitare e brendshme të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose të ketë kontratë furnizimi me një subjekt i cili të jetë i pajisur me këtë certifikatë . Nga verifikimi i Procesverbalit të argumentimit të kritereve të kualifikimit të publikuara nga AK rezulton se vendosja e këtij kriteri argumentohet duke u bazuar në: në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Objekti i kontratës përfshin mbjelljen, zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e bimësisë dekorative, drurëve ornamentalë, shkurreve dhe sipërfaqeve me bar, si dhe trajtimin e tyre me produkte fitosanitare kur është e nevojshme. Këto aktivitete lidhen drejtpërdrejt me qarkullimin dhe përdorimin e materialit bimor, i cili duhet të jetë i kontrolluar nga pikëpamja fitosanitare për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, dëmtuesve dhe organizmave të dëmshëm. Kërkesa për pajisje me certifikatë fitosanitare të brendshme është teknikisht e domosdoshme, pasi garanton që operatori ekonomik ose furnizuesi i tij është i autorizuar për tregtimin dhe qarkullimin e materialit bimor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se produktet bimore janë subjekt i kontrollit zyrtar. Në mungesë të këtij autorizimi, ekziston rreziku i përdorimit të materialeve të pakontrolluara, të cilat mund të sjellin pasoja negative për shëndetin e bimësisë ekzistuese, biodiversitetin urban dhe mjedisin në tërësi. Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, pasi cilësia dhe siguria e materialit bimor përbëjnë element thelbësor për realizimin e qëndrueshëm të shërbimit të gjelbërimit. Përdorimi i fidanëve apo bimëve të infektuara mund të shkaktojë dëme afatgjata, kosto shtesë për zëvendësime dhe ndërhyrje korigjuese, si dhe rrezik për përhapjen e sëmundjeve në hapësirat publike. Parashikimi që operatori ekonomik mund të përmbushë kriterin edhe përmes një kontrate furnizimi me një subjekt të pajisur me certifikatë fitosanitare garanton respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe moskufizimit të konkurrencës. Në këtë mënyrë, kriteri nuk kufizon pjesëmarrjen vetëm te subjektet që e disponojnë drejtpërdrejt certifikatën, por lejon përmbushjen e tij edhe përmes bashkëpunimit të ligjshëm me subjekte të autorizuar, duke siguruar njëkohësisht që materiali bimor të vijë nga burime të kontrolluara. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatori ekonomik fitues do të furnizohet me material bimor të kontrolluar dhe të certifikuar, duke siguruar realizimin e shërbimit të gjelbërimit në përputhje*

me standardet ligjore dhe mjedisore në fuqi. Lidhur me kriterin për pasjen e certifikatës fitosanitare e brendshme të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ose të ketë kontratë furnizimi me një subjekt i cili të jetë i pajisur me këtë certifikatë kërkojmë modifikimin e këtij kriteri dhe përcaktimin e tij sipas kuadrit ligjor në fuqi. Paraprakisht ju bëjmë me dije se mënyra se si është kërkuar kriteri nga ana e AK sjell konfuzion dhe krijon paqartësi te OE konkures. Më konkretisht sqarojmë se në Ligjin nr.10416, datë 07.04.2011 Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor dhe VKM nr. 523, datë 13.07.2016 Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e çertifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese përcaktohen rregullat, kriteret dhe dokumentacioni shoqërues i tregtimit të fidanëve dhe bimëve zbukuruese. Në pikën II, Kërkesat për Tregtimin e Materialeve të Shumëzimit dhe Fidanëve , shkronja d të VKM 523 përcaktohet se: 1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse: d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi . Referuar kuadrit dhe përcaktimeve ligjore të sipërcituara, rezulton se kriteri për paraqitjen e Certifikatës Fitosanitare, do të ishte në formën dhe mënyrë e duhur ligjore nëse kërkohet si vijon: Certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur VKM nr. 523 datë 13.07.2016 . Gjithashtu, ju bëjmë me dije se Institucioni kompetent në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i ngarkuar me detyrën e zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor , si dhe të akteve nënligjore, të miratuara, është Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve (ESHFF). Disa Autoritete të tjera Kontraktore si Bashkia Tiranë, Bashkia Durrës, etj, në rastet kur kanë prokuruar procedura të prokurimi të njëjta dhe/ose të ngjashme me procedurën aktuale, i janë drejtuar me kërkesë zyrtare ESHFF lidhur me kërkesën për paraqitjen e Certifikatës fitosanitare, dhe ky Institucion ka dhënë përgjigje zyrtare duke sqaruar se: Dokumentacioni shoqërues që duhet të kenë fidanët e bimëve zbukuruese, drurë apo shkurre dekorative, për tu tregëtuar, është: 1) Të jenë të çertifikuar nga Autoriteti Çertifikues (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve) duke i pajisur me Çertifikatën Zyrtare model 3, aneksi 4 i VKM nr. 523, datë 13.07.2016; 2) Të jenë të Autorizuar nga Organi Çertifikues (Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve) për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit. Autorizimi nxirret sipas modelit 4 të aneksit 4, të VKM nr. 523, datë 13.07.2016.; 3) të kenë Çertifikatë Origjine , që nxirret dhe plotësohet nga furnizuesi dhe që ka vlerë pasi nënshkruhet dhe vuloset nga Autoriteti Çertifikues . Sa mësipër vlerësojmë se të njëjtën praktikë ligjore dhe institucionale duhet të zbatohet dhe Autoriteti Juaj Kontraktor. Bashkëngjitur kësaj ankese po ju paraqesim përgjigjet zyrtare të Entit Shtetëror të Farërave dhe Fidanëve, si dhe modelet e Certifikatave zyrtare fitosanitare siç përcakton VKM nr. 523 datë 13.07.2016. Përsa mësipër kërkojmë modifikimin e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5, “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë fitosanitare e brendshme të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Zhvillimit Rural ose të ketë kontratë furnizimi me një subjekt i cili të jetë i pajisur me këtë certifikatë.

III.5.2. Në procesverbalin “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues, si më poshtë:

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 41, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Objekti i kontratës përfshin mbjelljen, zëvendësimin dhe mirëmbajtjen e bimësisë dekorative, drurëve ornamentalë, shkurreve dhe sipërfaqeve me bar, si dhe trajtimin e tyre me produkte fitosanitare kur është e nevojshme. Këto aktivitete lidhen drejtpërdrejt me qarkullimin dhe përdorimin e materialit bimor, i cili duhet të jetë i kontrolluar nga pikëpamja fitosanitare për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, dëmtuesve dhe organizmave të dëmshëm.

Kërkesa për pajisje me certifikatë fitosanitare të brendshme është teknikisht e domosdoshme, pasi garanton që operatori ekonomik ose furnizuesi i tij është i autorizuar për tregtimin dhe qarkullimin e materialit bimor në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe se produktet bimore janë subjekt i kontrollit zyrtar. Në mungesë të këtij autorizimi, ekziston rreziku i përdorimit të materialeve të pakontrolluara, të cilat mund të sjellin pasoja negative për shëndetin e bimësisë ekzistuese, biodiversitetin urban dhe mjedisin në tërësi.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e kontratës, pasi cilësia dhe siguria e materialit bimor përbëjnë element thelbësor për realizimin e qëndrueshëm të shërbimit të gjelbërimit. Përdorimi i fidanëve apo bimëve të infektuara mund të shkaktojë dëme afatgjata, kosto shtesë për zëvendësime dhe ndërhyrje korigjuese, si dhe rrezik për përhapjen e sëmundjeve në hapësirat publike.

Parashikimi që operatori ekonomik mund të përmbushë kriterin edhe përmes një kontrate furnizimi me një subjekt të pajisur me certifikatë fitosanitare garanton respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe moskufizimit të konkurrencës. Në këtë mënyrë, kriteri nuk kufizon pjesëmarrjen vetëm te subjektet që e disponojnë drejtpërdrejt certifikatën, por lejon përmbushjen e tij edhe përmes bashkëpunimit të ligjshëm me subjekte të autorizuar, duke siguruar njëkohësisht që materiali bimor të vijë nga burime të kontrolluara.

Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që operatori ekonomik fitues do të furnizohet me material bimor të kontrolluar dhe të certifikuar, duke siguruar realizimin e shërbimit të gjelbërimit në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore në fuqi.

III.5.3. Në shtojcën 7 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi që kërkohet:

Nr	Nr.An.	Emërtimi	Njësia	Sasia
<i>I- Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe infrastrukturës në varreza</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	125,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	22,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	3,500
5	3.4	Prerje e sistemim pemësh Φ21-40cm	copë	2,100
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	1,000
7	3.161/1	Rrafshim skarpate	m ²	4,500
8	3.322	Mur guri, llaç çimento M25 (mirëmbajtje)	m ³	200
9	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	400
10	an.	Mirembajtje varrezat e dëshmorëve Kuç	m ²	1,750
<i>II - Mirëmbajtje rruge për shkolla, kosha, varreza etj</i>				
1	an	Mirëmbajtje rruge për 1,000 m ²	m ²	90,000
1	3.96	F.V. fidane lule dekorative	copë	2,200
2	3.962	F.V. fidane shkurre dekorative "Oleander"	copë	300
3	an.168	F.V. shkurre dekorative Juniperus V18 grup3 cdo 6.6m	copë	200
4	an.	Mirëmbajtje	m ²	2,500
<i>IV-Plehërim i pemëve me pleh kimik</i>				
1	an.	Pleh kimik lloji 12-12-17	kg	3,000
2	an.	Ure	kg	2,500
3	an.	Pleh kimik lloji 20-20-20	kg	2,000
4	an.	Ilaç për spërkatje pemë (kunder morave, krimbave etj)	kg	60
<i>V- Mirëmbajtje bari</i>				
1	an.	Mirëmbajtje bari	m ²	32,000
2	3.643	Mbjellje bari	m ²	10,000
<i>VI- Krasitje pemë në shëtitore dhe trotuare</i>				
1	an.	Krasitje pemë	copë	1,250
2	an	Mirëmbajtje e pemëve	copë	1,250
3	an.	Bordurë e gjelbërt	ml	350

4	an.	Transport mbetjesh	m ³	127
<i>VI-Vaditje e pemëve gjatë sezonit 6-mujor</i>				
1	an.	Vaditje pemësh	copë	1,250
<i>VIII- Mirëmbajtje pishat pranë fushës, kodra</i>				
1	3.1	Skarifim bari me lopatë	m ²	95,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	12,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	2,000
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	250
7	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	220
<i>IX- Mirëmbajtje kodra e lisave në Pilur</i>				
1	an.	Mirëmbajtje	m ²	9,000
2	3.322	Mur guri mbajtës e themele, llaç çimento M25, mirëmbajtje	m ³	122
3	an.	Gropa për fidanet e rinj 40x40x40cm	copë	200
4	an.	Mbjellja e fidanëve të rinj	copë	200
5	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	136

III.5.4. Në shtojcën 8 “*Formulari i Termave të Referencës*”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi i mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëruara

1. Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është realizimi i shërbimeve për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, prerjen dhe sistemimin e vegjetacionit, furnizimin dhe mbjelljen e fidaneve, plehërimin dhe trajtimin fitosanitar, transportin e materialeve dhe mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen e elementeve ndërtimore dhe infrastrukturore në zona publike, rrugore, shkollore dhe memoriale.

2. Përshkrimi i shërbimeve

Shërbimet që do të realizohen përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon.

Skarifikimi manual i barit me lopatë në thellësi 3–5 cm dhe me distancë prerjesh 10–15 cm duke përfshirë pastrimin e mbetjeve, nivelimin dhe sipas nevojës mbjellje plotësuese dhe plehërim Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm, shkulja e plotë e rrënjëve të tyre, grumbullimi dhe largimi i mbetjeve si dhe nivelimi i sipërfaqes.

Prerja dhe sistemimi i pemëve sipas kategorive të diametrit Φ 10–20 cm, Φ 21–40 cm dhe Φ 41–75 cm duke përfshirë rrëzimin e kontrolluar, segmentimin, transportin e materialit drunor dhe pastrimin përfundimtar të zonës.

Krasitja dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e pemëve duke përfshirë heqjen e degëve të thata ose të dëmtuara, trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe plehërimin sipas nevojës.

Rrafshimi dhe stabilizimi i skarpave sipas parametrave gjeoteknikë, me ngjeshje të kontrolluar dhe sistemim përfundimtar të sipërfaqes.

Mirëmbajtja dhe riparimi i mureve prej guri dhe mureve mbajtëse me llaç cimento M25 duke përfshirë pastrimin e fugave, zëvendësimin e elementeve të dëmtuara dhe përforcimet e nevojshme.

Transporti i materialeve të ndërtimit, dheut dhe mbetjeve deri në distancë 3 km duke përfshirë ngarkimin, shkarkimin dhe sistemimin sipas kërkesës.

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Kuç, Tërbaç dhe Shën Vasil duke përfshirë pastrim, prerje bari, riparime të elementeve memoriale dhe raportim periodik mbi gjendjen.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe oborreve të shkollave për sipërfaqe 1000 m² duke përfshirë pastrim, rrafshim, sistemim dhe garantim të sigurisë së qarkullimit.

Furnizimi, mbjellja dhe mirëmbajtja e fidaneve lule dekorative, shkurre dekorative Oleander, shkurre dekorative Juniperus V18 grup 3 të vendosura çdo 6 6 m, si dhe krijimi i bordurave të gjelbërta.

Hapja e gropave për fidane 40×40×40 cm dhe mbjellja e fidaneve të rinj me përgatitje toke dhe trajtim pas mbjelljes.

Mbjellja dhe mirëmbajtja e barit duke përfshirë përgatitjen e tokës, mbjelljen, ujitjen, plehërimin dhe kontrollin fitosanitar.

Plehërimi i pemëve me pleh kimik 12-12-17, 20-20-20 dhe ure sipas dozimit teknik dhe kushteve agronomike.

Trajtimi i pemëve me pesticide për spërkatje kundër morave, krimbave dhe dëmtuesve të tjerë sipas udhëzimeve teknike dhe standardeve mjedisore.

Vaditja e pemëve sipas kërkesave biologjike dhe kushteve klimatike.

Mirëmbajtja e kodrave dhe lisave në Pilur duke përfshirë krasitje, pastrim, trajtim dhe stabilizim të terrenit.

3. Kërkesat teknike

Të gjitha punimet duhet të realizohen në përputhje me standardet teknike në fuqi dhe praktikën e mirë profesionale.

Kontraktori duhet të përdorë pajisje dhe makineri të përshtatshme për natyrën e punimeve

Duhet të sigurohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale dhe zbatimi i rregullave të sigurisë në punë.

Materialet e përdorura duhet të jenë cilësore dhe në përputhje me specifikimet teknike

Mbetjet dhe materialet e tepërta duhet të transportohen në vende të miratuara sipas legjislacionit mjedisor.

4. Afati i realizimit

Shërbimet do të realizohen sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe në varësi të kushteve klimatike dhe sezonalitetit të punimeve.

5. Detyrimet e kontraktorit

Të sigurojë staf të kualifikuar dhe të trajnuar.

Të garantojë cilësi dhe realizim korrekt të punimeve.

Të raportojë periodikisht mbi ecurinë e shërbimit.

Të riparojë çdo dëmtim të shkaktuar gjatë realizimit të punimeve.

6. Kontrolli dhe pranimi i shërbimeve

Punimet do të mbikëqyren nga përfaqësues të autoritetit kontraktor.

Pranimi i shërbimeve do të bëhet pas verifikimit të cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat teknike.

III.5.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.5.6. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për*

prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.5.7. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.5.8. Neni 41 pika 4, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- d) *Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

III.5.9. Në Ligjin Nr 10416, datë 07.04.2011, “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, në nenin 1 “Qëllimi”, parashikohet shprehimisht:

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për sigurimin e cilësisë së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për mbështetjen e prodhimit bujqësor, mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit. Ky ligj përcakton:

a) kushtet për prodhimin, përgatitjen për tregtim, tregtimin, përfshirë importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

i) të bimëve bujqësore, të cilat përfshijnë drithërat, foragjeret, patatet, panxharin, bimët e vajit e të fibrave, perimet, pemët drufrutore, hardhitë, humulusit, bimët eterovajore dhe medicinale të kultivuara;

ii) të bimëve dekorative;

iii) të bimëve pyjore;

b) detyrimet e personave të angazhuar në prodhimin, përgatitjen për treg, tregtimin, importimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

* 32002L0054- Direktivë e Këshillit 2002/54/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së panxharit. OJ L 193.

20.7.2002, p. 12–32, Version i Konsoliduar 25.1.2005.

32002L0053 - Direktivë e Këshillit 2002/53/EC, 13 qershor 2002 për katalogun e përbashkët të varieteteve të specieve të bimëve bujqësore. OJ L 193, 20.7.2002, p. 1–11, Version i Konsoliduar 18.4.2004.

32002L0055 - Direktivë e Këshillit 2002/55/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farave të perimeve. OJ L 193.

20.7.2002, p. 33–59, Version i Konsoliduar 4.7.2009.

32002L0056 – Direktivë e Këshillit 2002/56/EC, 13 qershor 2002 për tregtimin e farës së patates. OJ L 193.

20.7.2002, p. 60–73, Version i Konsoliduar 23.12.2008.

31966L0401 - Direktivë e Këshillit 66/401/EEC, 14 qershor 1966 për tregtimin e farës së bimëve foragjere. OJ 125.

11.7.1966, p. 2298–2308, Version i Konsoliduar 4.7.2009.

31966L0402 – Direktivë e Këshillit 66/402/EEC, 14 qershor 1966 për marketingun e farave të drithërave. OJ 125.

11.7.1966, Version i Konsoliduar 4.7.2009.

31992L0090 – Direktivë e Këshillit 92/90/EEC, 3 nëntor 1992, vendosjen e detyrimeve ndaj të cilave prodhuesit dhe importuesit e bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera, janë objekt dhe rregullimin e detajeve për regjistrimin e tyre. OJ L 344, 26.11.1992, p. 38–39.

31968L0193 Direktivë e Këshillit 68/193/EEC, 9 prill 1968 për tregtimin e materialit për shtimin vegjetativ të hardhisë; OJ L 93, 17.4.1968, p. 15–23, Version i Konsoliduar 14.7.2005.

31992L0033 - Direktivë e Këshillit 92/33/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegjetativ dhe mbjellës të perimeve, të ndryshëm nga fara. OJ L 157, 10.6.1992, p. 1–9, Version i Konsoliduar 30.10.2007.

31992L0034 – Direktivë e Këshillit 92/34/EEC, 28 prill 1992 për tregtimin e materialit të shtimit vegetativ të bimëve frutore dhe bimëve frutore të destinuara për prodhimin e frutave. OJ L 157, 10.6.1992, p. 10–18, Version i Konsoliduar 30.11.2007.

31998L0056 – Direktivë e Këshillit 98/56/EC, 20 korrik 1998 për tregtimin e materialit të shtimit të bimëve zbukuruese. OJ L 226, 13.8.1998, p. 16–23, Version i Konsoliduar 10.7.2003.

c) kërkesat për tregtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor dhe mënyrat për të garantuar standardet e tij;

ç) rregullat për regjistrimin e varieteteve të bimëve në Katalogun Kombëtar, në vazhdim KK, mirëmbajtjen e tyre dhe për provën përkatëse të varieteteve të bimëve për t'u regjistruar në të;

d) mënyrën e përdorimit, të këmbimit të të dhënave dhe marrëdhëniet e sistemit të prodhimit e të tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor me sistemin e informacionit;

dh) rregullat e veprimtarisë së shërbimit publik në fushën e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor;

e) rregullat për inspektimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

III.5.10. Në Ligjin Nr 10416, datë 07.04.2011, “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, në nenin 2 “Fusha e zbatimit”, parashikohet shprehimisht:

1. Ky ligj zbatohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të të gjitha bimëve, sipas përcaktimit të shkronjës “a” të nenit 1 të këtij ligji, si dhe për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të bimëve të tjera, kur këto prodhohen ose tregtohen për t'u përdorur në prodhimin bujqësor.

2. Ky ligj nuk zbatohet për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që është importuar për qëllim eksporti, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

III.5.11. Në, nenin 3 “Përkufizime”, pika 5 të Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, i ndryshuar, përcaktohet:

“5. “Furnizues” është çdo person, fizik ose juridik, vendas apo i huaj, që kryen të paktën njërën nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) prodhim;

b) përgatitje për tregtim;

c) tregtim;

ç) import/eksport të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.”.

III.5.12. Ndërsa në Kreun IV “Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor”, neni 14 i Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor”, i ndryshuar, përcaktohet:

Autoriteti certifikues

1. ESHFF-ja është organi përgjegjës për kryerjen e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Procedurat e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të prodhuar në vend, realizohen nga ESHFF-ja ose subjekte publike apo private, sipas përcaktimit të bërë në kreun IX të këtij ligji.

3. Procedurat dhe kriteret e kryerjes së certifikimit për specie të veçanta ose grup speciesh përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

III.5.13. Ndërsa në Kreun IV “*Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor*”, neni 15 i Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “*Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor*”, i ndryshuar, përcaktohet:

Kërkesa për certifikim zyrtar

1. Furnizuesi njofton çdo vit organin e certifikimit, në një afat kohor të përcaktuar, për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve të përcaktuara sipas këtij ligji, me anë të kërkesës, së cilës i bashkëlidhet dokumentacioni që vërteton të dhënat për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të përdorur për mbjellje.

2. Furnizuesi paraqet kërkesën me kusht që:

a) në vetëdeklarimin, sipas legjislacionit për licencat, të ketë përcaktuar speciet për të cilat ai ka paraqitur kërkesë për certifikim;

b) varieteti të jetë i regjistruar në KK ose furnizuesit t’i jetë lëshuar një vërtetim për depozitimin e kërkesës për regjistrimin e varietetit.

3. Forma, përmbajtja, afatet kohore dhe dokumentacioni, që i bashkëlidhet kërkesës për certifikim zyrtar, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

III.5.14. Ndërsa në Kreun IV “*Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor*”, neni 16 i Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “*Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor*”, i ndryshuar, përcaktohet:

Procedurat e certifikimit zyrtar

1. Procedura për certifikimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor ka të bëjë:

a) me kontrollin zyrtar dhe aprovimin e parcelave të prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor për zbatimin e kushteve teknike të përcaktuara;

b) me kontrollin zyrtar të makinerive e të pajisjeve për prodhimin dhe përgatitjen për treg;

c) me kontrollin e të dhënave të mbajtura nga furnizuesi për mirëmbajtjen e një varietetit, për sigurimin ose blerjen e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, prodhimin, furnizimin ose importin, përgatitjen për treg, stoqet dhe shitjet;

ç) me marrjen e mostrave zyrtare dhe analizimin e tyre vetëm nga ESHFF-ja për të provuar nëse materiali mbjellës dhe shumëzues bimor plotëson kërkesat për tregtimin dhe certifikimin jopërfundimtar.

2. Shpenzimet për realizimin e procedurave për certifikimin zyrtar, për lëshimin e etiketave dhe etiketimin zyrtar përballohen nga furnizuesi.

3. Tarifat për certifikimin zyrtar, për etiketat dhe etiketimin zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe të ministrit përgjegjës për financat.

4. Procedura të tjera për certifikimin zyrtar, përmbajtja, ngjyra dhe forma e etiketës zyrtare, përmbajtja dhe forma e certifikatës zyrtare, certifikatës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor jo përfundimisht të certifikuar dhe mënyra e njoftimit të drejtuesit të ESHFF-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

III.5.15. Ndërsa në Kreun V “*Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor*”, neni 23 i Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “*Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor*”, i ndryshuar, përcaktohet:

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet vetëm nga subjekte, të cilat janë të regjistruara në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor.

2. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor importohet nëse plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

III.5.16. Ndërsa në Kreun V “*Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor*”, neni 24 i Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “*Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor*”, i ndryshuar, përcaktohet:

1. Shfuqizohet.

2. Inspektimi i ngarkesës së materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në pikën hyrëse të kalimit kufitar e doganor të Republikës së Shqipërisë, kryhet sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, inspektori verifikon nëse furnizuesi është i licencuar për importin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të specieve që ai importon.

4. Inspektimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, lidhur me plotësimin e kërkesave për tregtim, të përcaktuara në këtë ligj, kryhet në magazinat e furnizuesit ose në treg. Për këtë inspektori merr mostrat përkatëse, të cilat i dërgon për analiza laboratorike.

5. Tarifa e marrjes së mostrave dhe e kryerjes së analizave laboratorike përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe të ministrit përgjegjës për financat.

III.5.17. Ndërsa në Kreun V “*Importi i materialit mbjellës dhe shumëzuesit bimor*”, neni 27 i Ligjit Nr.10 416, datë 7.4.2011 “*Për Materialin Mbjellës dhe Shumëzues Bimor*”, i ndryshuar, përcaktohet:

1. Përveç detyrimeve të përcaktuara për prodhimin, para nxjerrjes në treg të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të importuar, furnizuesi duhet që, krahas etiketave shoqëruese në

ambalazh, në gjuhë të huaj, të vendosë etiketë shtesë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i importuar shoqërohet me dokumente në gjuhën shqipe ose angleze.

2. Furnizuesi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të një varieteti të paregjistruar në KK, për riprodhim për qëllime eksporti, paraqet tek ESHFF-ja kontratën, si provë të eksportit.

III.5.18. Në, Vendimin Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese”, përcaktohet:

II. KËRKESAT PËR TREGTIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve zbukuruese mund të tregtohen, nëse:

a) u përkasin varieteteve ose hibrideve ndërvarietore apo, në rastin e nënshartesave, u përkasin specieve ose hibrideve ndërmjet specieve, të regjistruara në katalogun kombëtar;

b) plotësojnë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe janë të pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuar, për çdo specie, në aneksin 2 bashkëngjitur këtij vendimi;

c) plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të këtij kreu, për treguesit e cilësisë, identitetin dhe pastërtinë varietore;

ç) janë paketuar dhe etiketuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin 3, bashkëngjitur këtij vendimi;

d) janë pajisur me certifikatë fitosanitare, sipas modelit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve dhe me certifikatë zyrtare, të lëshuar nga autoriteti certifikues, sipas modeleve 2 dhe 3, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Kërkesat e mësipërme vlerësohen të plotësuara nëse, gjatë verifikimeve të kryera nga furnizuesi, në përputhje me planin e prodhimit dhe nga mbikëqyrjet e kryera nga inspektori fitosanitar e nga autoriteti certifikues, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, është vendosur se:

a) nga ana pamore, materialet e shumëzimit dhe fidanët janë të pastër nga organizmat dhe sëmundjet karantinorë ose ndonjë shenjë apo simptomë e tyre;

b) gjatë sezonit të rritjes, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët kanë rezultuar të pastër nga organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, që dëmtojnë cilësinë, të listuara në aneksin 2 të këtij vendimi;

c) në lidhje me treguesit e cilësisë, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese, nga ana pamore, kanë zhvillim dhe dimensione të kënaqshme për përdorim dhe nuk kanë defekte që dëmtojnë cilësinë ose që ulin vlerën e përdorimit;

ç) në lidhje me identitetin varietor, nga ana pamore, varieteti dallohet nga veçoritë botanike, morfologjike, biologjike e agroteknologjike dhe plotëson qëllimin e përdorimit;

d) në lidhje me pastërtinë varietore, plotësohen kërkesat e përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të këtij vendimi, për mbajtjen të papërziera të varieteteve dhe specieve të materialeve të shumëzimit e fidanëve të bimëve zbukuruese;

dh) në rastin e farërave, nga ana pamore kanë pamje dhe zhvillim të kënaqshëm.

III. KËRKESAT PËR FURNIZUESIT

1. Furnizuesit që prodhojnë, përgatisin për treg, importojnë dhe/ose tregtojnë materiale shumëzimi dhe fidanë të bimëve zbukuruese, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) Të jenë të regjistruar dhe të licencuar në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;
- b) Të regjistrohen në regjistrin e furnizuesve, që mbahet nga autoriteti certifikues;
- c) Të regjistrohen në regjistrin e mbajtësve të bimëve të caktuara, produkteve bimore dhe objekteve të rregulluara për qëllimet e shëndetit të bimëve, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e shëndetit të bimëve;
- ç) Kur është e nevojshme, të autorizohen nga struktura përkatëse e mbrojtjes së bimëve për lëshimin e pasaportës bimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

2. Furnizuesit sigurojnë përputhshmërinë e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve me kërkesat e këtij vendimi, duke përmbushur detyrimet e mëposhtme:

- a) Të kenë planin e prodhimit, i cili të përmbajë informacion për shqyrtim, kur kërkohet nga organi përgjegjës zyrtar për monitorimin, si më poshtë vijon:
 - i) Një kopje të planimetrisë kadastrale të vendndodhjes së veprimtarisë së furnizuesit, ku tregohen me saktësi objektet dhe fushat e tokës bujqësore që përdoren për prodhimin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, duke përfshirë edhe zonën mbrojtëse përkatëse;
 - ii) Planin e mbjelljes;
 - iii) Planin teknologjik;
 - iv) Planin për kryerjen e identifikimit dhe mbikëqyrjes së organizmave të dëmshëm në bimët, që ndikojnë në cilësinë e materialit, në objektet dhe në tokën ku materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët prodhohen ose përgatiten për treg;
- b) Në mënyrë të përshtatshme, sipas planit të prodhimit, të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, të kryejnë:
 - i) procedurat e planifikuara teknologjike dhe të mbajnë të dhënat për zbatimin e tyre, sipas datave dhe llojit të procedurës ose detyrat e kryera dhe metodën e zbatimit;
 - ii) mbikëqyrjen e rregullt për organizmat dhe sëmundjet e dëmshëm, të listuara në aneksin 2, të këtij vendimi;
 - iii) marrjen e mostrave dhe t'i dërgojnë ato në laboratorin e akredituar për analizat, si dhe të marrin masat e nevojshme për zvogëlimin e rrezikut të shfaqjes ose përhapjes së tyre;
- c) Mbajtjen e regjistrit të të dhënave për mbikëqyrjen e organizmave dhe të sëmundjeve të dëmshëm, në lidhje me:
 - i) datën e shfaqjes së mundshme për çdo organizëm dhe sëmundje të dëmshëm, të listuar në aneksin 2 të këtij vendimi dhe të gjitha masat që merren për parandalimin e përhapjen e tij, veçanërisht në lidhje me trajtimet ose heqjen dhe shkatërrimin e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve;
 - ii) datën dhe metodën e marrjes së mostrave të bimëve ose të tokës;

ç) Të njoftojnë, menjëherë, inspektorin përgjegjës fitosanitar, në rast të shfaqjes ose dyshimit të shfaqjes së organizmave karantinorë;

d) Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes ose inspektimit zyrtar, marrjen e mostrave zyrtare, kur është e nevojshme për analiza në një laborator me pajisje dhe ekspertizë të përshtatshme dhe, menjëherë pas inspektimit, të marrin masat për zbatimin e detyrave të lëna nga inspektori përgjegjës fitosanitar;

dh) Të sigurojnë që lotet ose porcionet e veçanta të materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve, gjatë prodhimit, magazinimit, përgatitjes për treg dhe tregtimit, janë të ndara;

e) Të mbajnë shënime për origjinën e materialeve të shumëzimit të përdorura për prodhimin e fidanëve të bimëve zbukuruese.

Furnizuesit duhet të mbajnë shënime për speciet, varietetin, numrin referues të lotit ose porcionit, sasinë, datën e marrjes ose blerjes dhe të dhënat e prejardhjes së materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve në lidhje me furnizuesin dhe vendin e prodhimit;

ë) Të mbajnë shënime për prodhimin, blerjen, specien, varietetin, sasinë, numrin referues të lotit ose porcionit, sasinë dhe datën e prodhimit ose të blerjes së materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve;

f) Të mbajnë të dhëna për përbërjen e ngarkesave me materiale shumëzimi dhe/ose fidanë që shesin ose shpërndajnë, për datën e shitjes e të shpërndarjes, si dhe numrin referues të lotit ose porcionit, sipas specieve dhe varieteteve;

g) Në rastet kur, para tregtimit, lotet ose porcionet e materialeve të shumëzimit dhe/ose të fidanëve me prejardhje të ndryshme vihen të përziera së bashku, furnizuesi të mbajë regjistrin e përbërjes së një ngarkese, me të dhëna për sasinë, numrin e njërive të loteve ose të porcioneve të veçanta, që përbëjnë lotin ose porcionin e përzier;

gj) Të mbajnë të dhënat për dokumentet dhe etiketat e furnizuesit, të nxjerra në përputhje me kërkesat e përcaktuara për materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që tregtohen në porcione, sipas përcaktimit të këtij vendimi për paketimin dhe etiketimin.

3. Furnizuesit ruajnë të dhënat e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj”, të pikës 2 të këtij kreu, si dhe provat në bazë të të cilave ata i kanë regjistruar të dhënat për të paktën tre vjet pas kalimit të vitit kalendarik, kur të dhënat janë regjistruar.

4. Furnizuesit, veprimtaria e të cilëve përqendrohet vetëm në tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve në blerjen me shumicë, brenda dhe jashtë vendit, si dhe shitjen me shumicë e pakicë, mbajnë të regjistruara, për të paktën 12 muaj, shënimet përkatëse për datën dhe sasinë e blerjeve, shitjeve, shpërndarjeve të tyre sipas specieve, varieteteve e numrit të referencës për lotin ose porcionin.

IV. KËRKESAT PËR CERTIFIKIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE FIDANËVE TË BIMËVE ZBUKURUESE

IV.1 Kërkesa për certifikim

1. Certifikimi i materialeve të shumëzimit dhe /ose të fidanëve të bimëve zbukuruese kryhet mbi bazën e prodhimit të deklaruar nga furnizuesi në kërkesën e paraqitur tek autoriteti certifikues, sipas rregullave të mëposhtme:

a) Kërkesa paraqitet çdo vit, jo më vonë se data 30 prill ose, në rastin e bimëve me disa cikle vegjetacioni në një vit, jo më vonë se një muaj para fillimit të prodhimit dhe përmban të dhëna për:

i) furnizuesin;

ii) aktivitetin që kryhet;

iii) personin përgjegjës të kualifikuar;

iv) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese.

b) Forma, përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet kërkesës është sipas modelit 1, të aneksit 4, bashkëngjitur këtij vendimi;

c) Autoriteti certifikues shqyrton kërkesën për certifikim brenda 20 ditëve pune nga paraqitja e saj dhe njofton zyrtarisht furnizuesit për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 10 ditëve pune pas përfundimit të shqyrtimit;

ç) Kërkesa e furnizuesit për certifikim pranohet, nëse:

i) është paraqitur dhe plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij kreu;

ii) materialet e shumëzimit dhe fidanët prodhohen, etiketohen dhe vendosen në treg nga persona përgjegjës të kualifikuar;

iii) materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët që kërkohen për certifikim u përkasin varieteteve ose në rastin e nënshartesave, u përkasin specieve dhe hibrideve ndërmjet tyre e që janë regjistruar në katalogun kombëtar;

iv) modeli i etiketës së propozuar nga furnizuesi është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe modeli i certifikatës së origjinës është sipas modelit 5, të aneksit 4, të këtij vendimi.

2. Në rastet kur, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e bimëve, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve zbukuruese duhet të shoqërohen me pasaportë bimore, së bashku me kërkesën e përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, furnizuesi paraqet kërkesë pranë strukturave të shërbimit të mbrojtjes së bimëve për pajisjen me pasaportë bimore.

IV.2 Procedurat e lëshimit të certifikatës zyrtare për materialet e shumëzimit dhe/ose për fidanët e bimëve zbukuruese

1. Furnizuesi që prodhon materiale shumëzimi dhe/ose fidanë të bimëve zbukuruese për tregtim lejohet t'i tregtojë ato pasi të jenë certifikuar nga autoriteti certifikues dhe të jetë autorizuar për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave e të dokumenteve të tjera të furnizuesit.

2. Autoriteti certifikues lëshon certifikatën kur, nga mbikëqyrja e ushtruar, rezulton se plotësohen kërkesat e përcaktuara në këtë vendim. [...]

III.5.19. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, KPP gjykon se nuk ndodhet ne kushtet ku duhet të gjykojë mbi pretendime për heqjen apo modifikimin e kriterëve të kualifikimit, apo të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriteret kualifikimi në një procedurë të prokurimit publik, por në rastin konkreti KPP duhet të gjykojë mbi respektimin e parimeve kryesore të prokurimit publik, të cilat duhet të respektohen nga autoriteti kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit në një procedurë prokurimi. Referuar ligjit të prokurimit publik, në nenin 3 të tij, parashikohen parimet kryesore të cilat duhet të respektohen nga autoriteti kontraktor gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të një procedure prokurimi, ku çdo autoritet kontraktor dhe entet kontraktore duhet të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Në interpretim të dispozitave ligjore të fushës së prokurimit, vlen të theksojmë se së pari, ligjvënësi ka parashikuar dy natyra kriteresh kualifikimi, kriteret të cilat përcaktohen me ligj, si dhe kriteret dhe kërkesat të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me llojin, volumin, sasinë, specifikat e mallit/punës/shërbimit që kërkohet të prokurimet, me qëllim realizimin me sukses dhe cilësi të tij. Kriteret e përcaktuara me ligj mund të parashikohen nga ligji për prokurimin publik dhe rregullat në përputhje me të, gjithashtu mund të përcaktohen kriteret të cilat bazohen në ligje specifike, në varësi të fushës apo objektit që kërkohet të realizohet. Referuar procedurës konkrete objekt-shqyrtimi, konstatojmë se objekti-prokurimit përveç mirëmbajtjes ka dhe zëra F.V fidanë lule dekorative dhe shkurre, për të cilat ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 10416, datë 07.04.2011 i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij).

Në vijim referuar nenit 77 të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë të cilat duhet të bazohen në *a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; dhe c) aftësinë teknike dhe profesionale [...]*. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen

ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në lidhje me kërkesën “**2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë fitosanitare e brendshme të lëshuar nga Ministria e Buqësisë dhe Zhvillimit Rural ose të ketë kontratë furnizimi me një subjekt i cili të jetë i pajisur me këtë certifikatë**”. Komisioni Prokurimit Publik gjykon se, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatë fitosanitare, është një kërkesë në kundërshtim me legjislacionin e fushës përkatëse konkretisht Ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij. Pasi në këtë legjislacion përcaktohet në mënyrë të qartë procedura e certifikimit të materialeve bimore dhe fidanëve. Në këtë kontekst përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të një kriteri i cili nuk është në përputhje me parashikimet ligjore sektorial, sjell si pasojë paqartësi dhe konfuzion si tek operatorët ekonomik në lidhje me mënyrën e plotësimit të këtij kriteri nga ana e tyre, por dhe të komisionit vlerësimit të ofertave duke bërë kështu totalisht të paqartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rastin konkret kriteri i mësipërm i vendos në kushte të pabarabarta nga njëra anë operatorët ekonomik pjesëmarrës dhe nga ana tjetër edhe procesin e vlerësimit të ofertave, ku përsakohë që Ligji nr. 10416, datë 07.04.2011 i ndryshuar dhe aktet në zbatim të tij, përcaktojnë në mënyrë të qartë mënyrën e certifikimit dhe dokumentacionin shoqëruar për secilën bimë apo fidanë. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit në pikën 2.3.5 nuk është në përputhje me legjislacionin sektorial, ndaj autoriteti kontraktor duhet të rishikojë kriterin e vecanta të kualifikimit në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik si dhe legjislacioni e fushës përkatëse.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK se: “Pika 7. Në Shtojcën 7, Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit, nga Autoriteti Kontraktor është kërkuar që: *Oferta e operatorit ekonomik duhet të shoqërohet me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar . Lidhur me këtë kërkesë të Autoritetit Kontraktor, ju bëjmë me dije se ajo është totalisht e paligjshme, e pambështetur ligjërisht, dhe diskriminuese duke kufizuar në mënyrë drastike konkurrencën dhe garën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë konkurrues për këtë procedurë prokurimi. Më konkretisht argumentojmë si vijon: Në nenin 34*

Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik parashikohet se: 1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përlllogarit vlerën e prokurimit. 2. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit të këtij ligji, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive. Metodatat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit parashikohen në rregullat e prokurimit publik. Më tej Akoma në nenin 12 Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik përcaktohet si vijon: 1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar, pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti/enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, duhet t'i mbajë ato parasysh kur përlllogarit vlerën e prokurimit. 2. Autoriteti/enti kontraktor, në rastet e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, konverton vlerën limit të kontratës me një monedhë ndërkombëtare, të përzgjedhur prej tij sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën në të cilën dërgohet për publikim njoftimi i kontratës. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor vendos dhe kursin e këmbimit të përdorur prej tij. 3. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të LPP-së dhe këtyre rregullave, apo për të copëzuar kontratën me qëllim shmangien e procedurave sipas kufijve monetarë. 4. Autoriteti/enti kontraktor, në fazën e hartimit të nevojave për mallra, punë ose shërbime mban në konsideratë, metodat e përlllogaritjes së vlerës së prokurimit. Vlera e përlllogaritur e prokurimit duhet të jetë vlerë reale e përlllogaritur përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit?. Referuar këtyre parashikimeve ligjore si mësipër cituar, rezultoni e qartë se detyrimi për përlllogaritjen e vlerës së kontratës duke analizuar koston për çdo zë apo element të kontratës është vetëm i Autoritetit Kontraktor dhe kurrsesi nuk mund të jetë detyrim për OE konkurrues në një garë. Në vijim, në nenin 29 Oferta ekonomike të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik përcaktohet si vijon: 1. Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH. 2. Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike. Sjellim në vëmendje të Autoritetit Kontraktor se kërkesa e tij për shoqërimin e ofertës me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar, është një kërkesë që bie në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenin 29 të VKM 285. Kjo kërkesë është abuzive, diskriminuese dhe është në kundërshtim me të paktën 4 nga qëllimet e ligjit të prokurimit publik dhe konkretisht qëllimet që: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit

publik. Po kështu, ky kriter i paligjshëm dhe diskriminues bie në kundërshtim të hapur me nenin 3 Parime të përgjithshme të Ligjit 162/2020 ku parashikohet se: 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Sjellim në vëmendje të AK se rasti i vetëm kur mund të kërkohet analiza e kostos së ofertës ekonomike (dhe jo për çdo zë të ofertës) është ai rast kur Oferta e Paraqitur nga Operatori Ekonomik konkurrues rezulton të jetë Anomalisht e Ulët sipas parashikimeve të nenit 93 të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik dhe nenit 82 të VKM 285 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik . Në çdo rast tjetër kërkesa e AK për shoqërimin e ofertës me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar, është e paligjshme, qartazi abuzive dhe tregon nivelin e paditurisë së Autoritetit Kontraktor. Referuar gjithë parashikimeve ligjore të sipërcituara kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë nga Shtojca 7, Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren

III.6.1. Në shtojcën 7 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi që kërkohet:

Nr	Nr.An.	Emërtimi	Njësia	Sasia
<i>I- Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe infrastrukturës në varreza</i>				
1	3.1	Skarifim bari me lopatë	m ²	125,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	22,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	3,500
5	3.4	Prerje e sistemim pemësh Φ21-40cm	copë	2,100
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	1,000
7	3.161/1	Rrafshim skarpate	m ²	4,500
8	3.322	Mur guri, llaç çimento M25 (mirëmbajtje)	m ³	200
9	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	400
10	an.	Mirembajtje varrezat e dëshmorëve Kuç	m ²	1,750
<i>II - Mirëmbajtje rruge për shkolla, kosha, varreza etj</i>				
1	an	Mirëmbajtje rruge për 1,000 m ²	m ²	90,000
1	3.96	F.V. fidane lule dekorative	copë	2,200
2	3.962	F.V. fidane shkurre dekorative "Oleander"	copë	300
3	an.168	F.V. shkurre dekorative Juniperus V18 grup3 cdo 6.6m	copë	200

4	an.	Mirëmbajtje	m ²	2,500
<i>IV- Plehërim i pemëve me pleh kimik</i>				
1	an.	Pleh kimik lloji 12-12-17	kg	3,000
2	an.	Ure	kg	2,500
3	an.	Pleh kimik lloji 20-20-20	kg	2,000
4	an.	Ilaç për spërkatje pemë (kunder morave, krimbave etj)	kg	60
<i>V- Mirëmbajtje bari</i>				
1	an.	Mirëmbajtje bari	m ²	32,000
2	3.643	Mbjellje bari	m ²	10,000
<i>VI- Krasitje pemë në shëtitore dhe trotuare</i>				
1	an.	Krasitje pemë	copë	1,250
2	an	Mirëmbajtje e pemëve	copë	1,250
3	an.	Bordurë e gjelbërt	ml	350
4	an.	Transport mbetjesh	m ³	127
<i>VI-Vaditje e pemëve gjatë sezonit 6-mujor</i>				
1	an.	Vaditje pemësh	copë	1,250
<i>VIII- Mirëmbajtje pishat pranë fushës, kodra</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	95,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	12,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	2,000
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	250
7	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	220
<i>IX- Mirëmbajtje kodra e lisave në Pilur</i>				
1	an.	Mirëmbajtje	m ²	9,000
2	3.322	Mur guri mbajtës e themele, Ilaç çimento M25, mirëmbajtje	m ³	122
3	an.	Gropa për fidanet e rinj 40x40x40cm	copë	200
4	an.	Mbjellja e fidanëve të rinj	copë	200
5	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	136

Oferta e operatorit ekonomik duhet të shoqërohet me analizën përkatëse të detajuar për çdo zë të parashikuar.

Afatet e ekzekutimit: 36 (tridhjetegjashtë) muaj

III.6.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.6.3. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, shprehimisht thuhet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

III.6.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.6.5. Në Vendimin nr. 629, datë 15.7.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018)”, parashikohet se: “1. Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që do të përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi. 4. Çmimet e zërave të punimeve, të përcaktuara në manualet teknike, janë orientuese dhe referuese për planifikimin e buxhetit vjetor”.

III.6.6. Në Vendim nr. 514, datë 15.8.2007 “Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”, parashikohet se:

1. Unifikimin e metodologjisë së llogaritjes dhe të formatit të paraqitjes së preventivave e të analizës së kostos për punimet e ndërtimit, sipas programeve kompjuterike të miratuara për lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve, që zhvillojnë veprimtari në këtë fushë, lehtësimin e kontrollit tekniko-financiar të punimeve të ndërtimit dhe shmangien e informalitetit në veprimtarinë prodhuese, në tregun e ndërtimeve në Shqipëri.

2. Hartimi i çdo preventivi në fushën e ndërtimit, si dhe zbatimi e mbikëqyrja e çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona, fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, vendas ose të huaj, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhet në përputhje me këtë vendim.

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e përdorura në këtë vendim kanë kuptimin, si më poshtë vijon: dh) manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit ose thjesht manuali i çmimeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të këtij vendimi; e) buletini i çmimeve të materialeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të materialeve të ndërtimit dhe i produkteve për ndërtim, të ofruara nga tregu përkatës, brenda vendit;

9. Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual.

10. Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tendera publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.

11. Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.

III.6.7. Në Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, parashikohet se:

b) Pas pikës 3 shtohen pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3, me këtë përmbajtje: “3.1. Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit.”. Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv.

III.6.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriteve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.6.9. Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues lidhur me përcaktimin e bërë nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 KPP gjykon, se kërkesa në fjalë për sa i përket Analizës Teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, nuk është në përputhje me asnjë nga përcaktimet e nenit 77 të lex specialis, pra autoriteti kontraktor nuk i është përmbajtur parashikimeve ligjore të lex specialis, në lidhje me hartimin e këtij kriteri kualifikimi. KPP gjykon të merret në analizë legjislacioni sektorial në fushën specifike mbi këtë kërkesë, rastet kur kjo është e aplikueshme dhe qëllimi në vetvete i kërimit të analizës teknike të çmimeve në kuadër të pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik.

Referuar legjislacioni sektorial të fushës së ndërtimit, konkretisht udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar, parashikohet specifikisht momenti procedural i kërimit të analizës teknike, moment të cilin e lidhë me fazën e projektimit, konkretisht, “Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr.514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv”.

Gjithashtu, edhe në Vendimin nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018) dhe në Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ligjvënësi ka parashikuar unifikimin e metodologjisë së llogaritjes si dhe të formatit të paraqitjes së analizave të kostos për punimet e ndërtimit, çmimet e të cilave sipas manualit teknik të ndërtimit janë orientuese dhe referuese, si dhe subjektet e interesuara që marrin pjesë në tendera publikë, janë të detyruar të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr.2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave “Për Klasifikimin dhe Strukturën e Kostos së Punimeve të Ndërtimit”.

KPP konstaton se autoriteti kontraktor e ka justifikuar vendosjen e këtij kriteri kualifikimi bazuar në VKM nr.514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Referuar këtij vendimi, parashikohet dorëzimi sipas formatit të analizës së çmimeve për operatorët ekonomikë të cilët marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik, por momenti i kërimit dhe dorëzimit të tyre rregullohet në legjislacinin e posaçëm, ligjin për prokurimin publik, konkretisht në nenin 93 të tij. Në këtë

kontekst, kërkesa në lidhje me paraqitjen e analizës teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës është në kundërshtim me nenin 93 *“Oferta anomalisht e ulët”* të LPP-së dhe pikën 4, të nenit 82 *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”* të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, pasi referuar mënyrës së plotësimit të kësaj kërkesë nga ana e operatorëve ekonomikë, mbi dorëzimin e analizave teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, siç është kërkuar në dokumentet e tenderit, ligjvënësi ka parashikuar momentin procedural në ligjin e prokurimit publik, rastet kur autoriteti kontraktor evidenton rastin e një oferte anomalisht të ulët. Komisioni konstaton, se legjislacioni specifik, konkretisht Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 *“Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, parashikon se: *“Preventivat e objekteve të reja, pa përjashtim, që paraqiten për marrjen e lejes së ndërtimit me financim publik ose privat, të projektuara nga subjekte publike apo private, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit nga Këshilli i Ministrave. Në rastet kur në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit mungojnë çmimet e zërave të punimeve të vendosura në projekt, projektuesi harton analizën teknike përkatëse të çmimeve dhe vepron në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 8 të vendimit nr. 514, datë 15.8.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”. Subjekti projektues, privat apo shtetëror, është përgjegjës për saktësinë e volumeve të ndërtimit, të cilat jepen në preventiv”*. Pra nga sa më sipër, rezulton se analiza e kostos hartohet në fazën e projektimit për t’i shërbyer autoritetit kontraktor për hartimin e fondeve limite, ndërkohë që autoriteti kontraktor po prokuron një kontratë shërbimi. Në këtë kuadër KPP gjykon, se kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor për paraqitjen e analizës - teknike në këtë fazë të procedurës për të gjithë zërat e preventivit të ofertës, nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit sektorial në fuqi e konkretisht Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 *“Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”*, të ndryshuar dhe Vendimin nr. 514, datë 15.8.2007 *“Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit”*. Pra, analiza teknike nuk është e nevojshme në fazën e zbatimit, me përjashtim të rastit kur autoriteti kontraktor gjatë shqyrtimit të ofertës, e konstaton ofertën e operatorit ekonomik si ofertë anomalisht të ulët. Në këtë rast e ngarkon me detyrim autoritetin, që ti kërkojë operatorit ekonomik analizën teknike për të justifikuar ofertën e tij të konstatuar si anomalisht të ulët.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimures *“Albgarden”* SHPK qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik *“Albgarden”* SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit me argumentin se: *“Pika 8. Pasi jemi njohur me gjithë dosjen e tenderit përfshirë kriteret e kualifikimit, termat e referencës, grafikun e punimeve, preventivat dhe*

specifikimet teknike të publikuara për këtë procedurë prokurimi, vlerësojmë se me qëllim hartimin e një oferte të plotë teknike, financiare dhe ligjore është e nevojshme që AK të publikojë dhe të na vëri në dispozicion hartat dhe plan-vendosjen e objekteve sipas sistemit koordinativ shtetëror KRGJSH 2010. Ky informacion është shumë i nevojshëm me qëllim që ne të ndërtojmë një panoramë të qartë lidhur me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke llogaritur kostot tona të brendshme të gjithë volumeve të punimeve. Sjellim në vëmendje se në nenin 36 Specifikimet teknike të Ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik përcaktohet se: 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Ndërsa në nenin 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik parashikohet se: Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. Bazuar në kuadrin ligjor si mësipër cituar, si dhe referuar argumenteve të cituara, me qëllim hartimin dhe paraqitjen e një oferte objektive e konkurruese ju bëjmë me dije se është shumë e nevojshme paraqitja nga Autoriteti Kontraktor e informacionit lidhur me dispozicion hartat dhe plan-vendosjen e objekteve sipas sistemit koordinativ shtetëror KRGJSH 2010. Vetëm kështu do të respektohet qëllimi dhe parimet e përcaktuara në nenet 2 dhe 3 të LPP duke konkurruar në mënyrë të drejtë dhe të ndershme. Përsa mësipër kërkojmë marrjen parasysh të kësaj kërkesë dhe vendosjen në dispozicion të hartave dhe plan-vendosjeve të objekteve sipas sistemit koordinativ shtetëror KRGJSH 2010”, Komisioni Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e

aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Skarifikimi i barit me lopatë është proces manual i ajrosjes së sipërfaqes së gjelbëruar përmes prerjes vertikale të shtresës së thatë dhe dekompaktimit të shtresës sipërfaqësore të tokës. Thellësia e depërtimit në tokë duhet të jetë 3–5 cm, me distancë ndërmjet prerjeve 10–15 cm, duke siguruar prerje të njëtrajtshme në drejtim linear ose kryqëzor sipas nevojës së sipërfaqes. Punimet realizohen në tokë me lagështi mesatare për të shmangur dëmtimin e rrënjëve dhe ngjeshjen shtesë të dheut. Prosesi përfshin heqjen dhe largimin e mbetjeve organike të krijuara pas prerjes, nivelimin e lehtë të sipërfaqes dhe, sipas nevojës, mbjellje plotësuese dhe plehërim. Shërbimi do të kryhet në periudhën pranverë ose vjeshtë, në temperatura të tokës 10–18°C.

Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm përfshin largimin manual ose mekanik të trungjeve dhe degëve me diametër maksimal deri në 10 cm, të matura në lartësi rreth 10–15 cm nga niveli i tokës. Prerja kryhet në nivel sa më afër tokës ose sipas kërkesës teknike të projektit, me kënd prerjeje të rregullt për të shmangur çarjen e trungut dhe për të mundësuar rigjenerim të kontrolluar kur kërkohet. Prosesi përfshin grumbullimin, transportin dhe largimin e mbetjeve bimore nga vendpunimi, si dhe pastrimin dhe nivelimin e sipërfaqes pas ndërhyrjes.

Shkulja e rrënjëve të bimëve të vogla përfshin largimin e plotë të sistemit rrënjor për bimë me diametër trunq deri në 10 cm, me qëllim eliminimin e rigjenerimit dhe pastrimin përfundimtar të sipërfaqes. Gërmimi kryhet rreth perimetrit të trungut me diametër pune 30–60 cm për të liruar rrënjët anësore dhe për të mundësuar nxjerrjen e plotë të trungut me rrënjë. Gjatë procesit sigurohet minimizimi i dëmtimit të terrenit përreth dhe ruajtja e stabilitetit të sipërfaqeve

ekzistuese. Punimet përfshijnë grumbullimin, ngarkimin, transportin dhe largimin e rrënjëve dhe mbetjeve bimore në vend të miratuar, si dhe mbushjen e gropës së krijuar me dhe të përshtatshëm dhe ngjeshjen e lehtë për rikthimin e nivelit fillestar të terrenit.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër trugu Φ 10–20 cm përfshin prerjen e kontrolluar të trugut dhe degëve kryesore për pemë me diametër 10–20 cm të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe trajtimin pasues të materialit drunor dhe sipërfaqes së terrenit. Lartësia e prerjes në trung kryhet sa më afër nivelit të tokës, ndërsa degët anësore priten dhe sistemohen para ose pas rrëzimit sipas kushteve të terrenit. Procesi përfshin prerjen në segmente të transportueshme, grumbullimin, ngarkimin dhe largimin e materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimin dhe nivelimin e sipërfaqes pas përfundimit të punimeve.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër trugu Φ 21–40 cm përfshin prerjen e kontrolluar dhe rrëzimin e pemëve me diametër 21–40 cm të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe trajtimin, segmentimin dhe largimin e materialit drunor nga vendpunimi. Para rrëzimit kryhet pastrimi i degëve anësore sipas nevojës për të siguruar qasje dhe stabilitet gjatë prerjes, ndërsa trungjet priten në segmente të menaxhueshme për transport ose magazinim. Lartësia e cingut pas prerjes nuk duhet të kalojë 5–10 cm nga niveli i tokës, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në projekt. Punimet përfshijnë grumbullimin, ngarkimin, transportin dhe largimin e materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimin dhe sistemimin e sipërfaqes së ndërhyrjes. Zbatimi realizohet në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale dhe masave të kontrollit të zonës së punës.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër trugu Φ 41–75 cm përfshin prerjen profesionale, rrëzimin e kontrolluar dhe trajtimin e pemëve me diametër 41–75 cm të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe segmentimin dhe largimin e materialit drunor nga vendpunimi. Lartësia e cingut pas prerjes nuk duhet të kalojë 5–10 cm nga niveli i tokës. Punimet përfshijnë grumbullimin, ngarkimin, transportin dhe largimin e materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimin dhe sistemimin përfundimtar të sipërfaqes së ndërhyrjes. Zbatimi kryhet në përputhje me standardet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, me izolimin e zonës së punës dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale.

Rrafshimi i skarpatës përfshin formësimin, nivelimin dhe stabilizimin e sipërfaqeve të pjerrëta të terrenit me qëllim arritjen e profilit të projektuar dhe sigurimin e qëndrueshmërisë gjeoteknike. Pjerrësia e skarpatës përcaktohet sipas kushteve të tokës dhe parametrave teknikë, zakonisht në raporte 1:1.5 deri 1:2 ose sipas specifikimeve gjeoteknike, ndërsa sipërfaqja përfundimtare duhet të jetë e njëtrajtshme, pa gropa, dalje apo masa të paqëndrueshme dheu. Trashësia e shtresës së punimit dhe thellësia e ndërhyrjes varen nga konfigurimi ekzistues i terrenit, ndërsa materialet e tepërta ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar. Pas rrafshimit kryhet ngjeshja e kontrolluar e sipërfaqes me mjete vibruese ose me kalim të përsëritur të makinerisë për të siguruar stabilitet dhe për të reduktuar rrezikun e erozionit ose rrëshqitjes. Në rast nevojë parashikohet vendosja e shtresës mbrojtëse me dhe vegjetativ ose masa të tjera stabilizuese. Zbatimi realizohet në përputhje me kërkesat e sigurisë në punë dhe me kontroll të vazhdueshëm

të parametrave gjeometrikë, ndërsa shërbimi aplikohet në infrastrukturë rrugore, parcela ndërtimore dhe zona të gjelbëruara ku kërkohet formësim dhe stabilizim i terrenit të pjerrët.

Mirëmbajtja e murit prej guri me llaç çimento M25 përfshin riparimin, përforcimin dhe rikthimin e integritetit strukturor të muraturës ekzistuese të ndërtuar me gurë natyrorë dhe llaç çimentoje me klasë rezistence M25. Procesi konsiston në pastrimin e fugave të dëmtuara ose të zbrazura deri në thellësi të mjaftueshme për ankorim të ri, largimin e pjesëve të lira ose të degraduara të llaçit dhe gurëve, si dhe zëvendësimin ose rivendosjen e elementeve të dëmtuara me gurë me karakteristika të ngjashme fiziko-mekanike. Përgatitja e llaçit realizohet me çimento që siguron rezistencë karakteristike në shtypje rreth 25 MPa, me raport përzierjeje sipas kërkesave teknike dhe me përdorim agregatesh të pastra dhe ujë të kontrolluar për të garantuar punueshmëri dhe qëndrueshmëri. Fugat mbushen plotësisht dhe ngjeshen për të siguruar aderencë të mirë ndërmjet gurit dhe llaçit, ndërsa sipërfaqja përfundimtare trajtohet për të ruajtur pamjen ekzistuese të murit. Në rast nevojë përfshihet edhe stabilizimi lokal i murit përmes përforcimeve të pjesshme, rregullimi i pjerrësisë dhe sistemimi i pjesës së sipërme për të parandaluar depërtimin e ujërave. Punimet realizohen në përputhje me standardet e sigurisë në punë dhe me kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së materialeve dhe zbatimit, ndërsa shërbimi aplikohet në mure mbajtëse, rrethuese ose dekorative prej guri ku kërkohet mirëmbajtje dhe rikthim i funksionalitetit strukturor.

Transporti i materialeve të ndërtimit dhe dheut me automjetet deri në distancë 3 km përfshin ngarkimin, bartjen, shkarkimin dhe shpërndarjen e materialeve ndërtimore ose masave të dheut nga vendi i origjinës në destinacionin e përcaktuar brenda rrezes maksimale prej 3 km. Ngarkimi kryhet me mjete mekanike si eskavator ose ngarkues frontal, ose në mënyrë manuale kur kërkohet, duke siguruar shpërndarje të barabartë të ngarkesës dhe mbulim të materialit për të shmangur derdhjen gjatë transportit. Shkarkimi realizohet në vendin e përcaktuar, me vetëshkarkim ose me mjete ndihmëse, dhe përfshin sistemimin paraprak sipas kërkesës. Çmimi përfshin të gjitha kostot e operimit të automjetit, karburantin, amortizimin, fuqinë punëtore, si dhe kohën e pritjes së arsyeshme për ngarkim dhe shkarkim brenda kushteve normale të punës. Shërbimi zbatohet në përputhje me rregullat e sigurisë në punë dhe të qarkullimit rrugor, si dhe me masat për mbrojtjen e mjedisit gjatë transportit të materialeve.

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Kuç, Tërbaç dhe Shën Vasil përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe prezantimin e sipërfaqeve të varrezave në përputhje me standardet e kujdesit memorial dhe respektit për të rënë. Procesi përfshin pastrimin e gjelbërimit të mbetur, prerjen e barit dhe bimëve të panevojshme, pastrimin e rrugicave dhe hapësirave përreth, si dhe kontrollin dhe riparimin e elementeve të muraturës, pllakatave, gurëve dhe tabelave për identifikim. Në rast nevojë do të kryhen punime për restaurimin e shtresës mbrojtëse të gurëve dhe përforcimin e strukturave të dëmtuara. Gjethet, mbeturinat dhe materialet bimore të grumbulluara largohen dhe transportohen në vend të miratuar sipas rregullave të mjedisit. Punimet realizohen me përdorimin e mjeteve manuale ose mekanike sipas nevojës dhe duke respektuar ambientin dhe qetësinë e zonës, si dhe me respekt të plotë për memorialin dhe të rënë. Procedura përfshin gjithashtu kontroll të rregullt dhe raportim mbi

gjendjen e varrezave, për të siguruar që hapësirat të mbeten të rregulluara, të pastra dhe të sigurt për vizitorët. Shërbimi zbatohet në përputhje me rregullat e sigurisë në punë dhe masat për mbrojtjen e mjedisit, duke garantuar respekt dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të hapësirave memoriale.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe oborreve të shkollave për sipërfaqe 1000 m² përfshin një gamë punimesh të organizuara për pastrimin, rregullimin dhe sigurimin e qarkullimit të sigurt brenda hapësirave të shkollës. Procesi përfshin heqjen e mbeturinave, gjetheve, mbetjeve të bimëve dhe materialeve të tjera të lëshuara nga aktivitetet e përditshme, pastrimin mekanik ose manual të sipërfaqes së rrugëve dhe oborreve, rrafshimin e pjesëve të dëmtuara të tokës ose asfaltit dhe nivelimin e zonave me pabarazi. Në rast nevojë realizohet riparimi i shtresës sipërfaqësore, pastrimi i kanalizimeve të ujërave dhe rregullimi i pengesave që mund të rrezikojnë qarkullimin e fëmijëve dhe stafit. Punimet kryhen me përdorim të mjeteve manuale dhe mekanike sipas kushteve të terrenit, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e infrastrukturës ekzistuese. Mbledhja dhe largimi i mbeturinave realizohet në vend të miratuar, në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, sipërfaqe të pastra, të sigurt dhe funksionale për nxënësit dhe personelin, duke përmirësuar higjienën dhe paraqitjen e hapësirave të shkollës.

Fidane lule dekorative përfshin furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e bimëve të reja të përdorura për qëllime dekorative në hapësira publike, kopshtore ose brenda ambienteve të organizuara. Procesi realizohet duke përzgjedhur fidane me cilësi të lartë, me rrënjë të shëndetshme dhe me karakteristika të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës së vendosjes. Fidane lule dekorative vendosen në tokë të përgatitur paraprakisht, ku janë pastruar mbeturinat dhe është kryer përgatitja e shtresës së mbjelljes me dhe të ushqyeshëm dhe drenazh të përshtatshëm. Pas vendosjes, fidanet ujiten në mënyrë të kontrolluar dhe trajtohen sipas nevojës me plehëra, mbrojtje ndaj sëmundjeve dhe përkujdesje për rritjen e shëndetshme. Punimet përfshijnë gjithashtu sistemimin estetik të grupimeve të bimëve, mbrojtjen e tyre nga dëmtimet fizike dhe kontrollin e rregullt të gjendjes së fidaneve. Mbledhja e mbeturinave bimore dhe pastrimi i hapësirës realizohen në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve dhe standardet e higjienës. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të hapësirave ku vendosen fidane lule dekorative.

Fidane shkurre dekorative “Oleander” përfshin furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shkurreve Oleander në hapësira dekorative, kopshtore ose përgjatë rrugëve dhe hapësirave publike. Procesi realizohet duke përzgjedhur fidane të shëndetshme, me rrënjë të forta dhe karakteristika të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës së vendosjes. Tokat për mbjellje përgatiten paraprakisht duke pastruar mbeturinat dhe duke siguruar shtresë toke të ushqyeshme me drenazh të mirë. Fidane Oleander vendosen në distanca të rregulluara dhe trajtohen pas mbjelljes me ujtitje të rregullt, plehërim dhe masat e nevojshme për mbrojtje nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Punimet përfshijnë gjithashtu sistemimin estetik të shkurreve, mbledhjen e mbeturinave bimore dhe pastrimin e zonës së punës në përputhje me rregullat e menaxhimit të mbetjeve dhe higjienës. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme, mirëmbajtje të vazhdueshme

dhe prezantim estetik të hapësirave ku vendosen fidane shkurre dekorative Oleander, duke kontribuar në përmirësimin e pamjes vizuale dhe funksionalitetit të hapësirave publike.

Fidane shkurre dekorative Juniperus V18 grup 3, vendosur çdo 6.6 m, përfshin furnizimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shkurreve dekorative Juniperus me madhësi V18, në grupe prej tre njësi, për krijimin e vijave dekorative ose mbrojtëse në hapësira publike, kopshtore ose përgjatë rrugëve. Procesi realizohet duke përzgjedhur fidane të shëndetshme, me rrënjë të forta dhe karakteristika të përshtatshme për klimën dhe tokën e vendosjes. Tokat për mbjellje përgatiten paraprakisht duke pastruar mbeturinat, duke siguruar shtresë toke të ushqyeshme dhe drenazh të mirë, dhe duke krijuar hapësirën e nevojshme për grupimin e tre shkurreve në distancën e përcaktuar 6.6 m. Fidane Juniperus vendosen në mënyrë të kontrolluar dhe trajtohen pas mbjelljes me ujitje të rregullt, plehërim dhe masat e nevojshme për mbrojtje nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Punimet përfshijnë gjithashtu mbledhjen e mbeturinave bimore, pastrimin e zonës së punës dhe sigurimin e prezantimit estetik të grupeve të shkurreve. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme, mirëmbajtje të vazhdueshme dhe paraqitje vizuale të harmonizuara të hapësirave ku vendosen fidane shkurre dekorative Juniperus V18, duke kontribuar në funksionalitetin dhe bukurinë e hapësirave publike ose kopshtore.

Mirëmbajtja e luleve dekorative përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe kujdesin e vazhdueshëm të luleve të vendosura në hapësira publike, kopshtore ose dekorative. Procesi përfshin ujitjen e rregullt sipas nevojës së bimëve dhe kushteve klimatike, plehërimin me lëndë ushqyese të përshtatshme për llojin e luleve, heqjen e pjesëve të vyera ose të dëmtuara dhe trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave bimore, mbledhjen e gjetheve dhe lulave të thata, si dhe nivelimin dhe sistemimin estetik të sipërfaqes për të ruajtur paraqitjen vizuale të luleve. Për siguri dhe shëndet të bimëve, fushat e mbjelljes kontrollohen rregullisht për lagështinë e tokës, dendësinë e bimëve dhe rritjen e shëndetshme. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të hapësirave dekorative, duke kontribuar në bukurinë vizuale dhe funksionalitetin e hapësirave publike ose kopshtore.

Plehrimi i pemëve me pleh kimik lloji 12-12-17 përfshin aplikimin e një përzierjeje të kontrolluar të lëndëve ushqyese (azot, fosfor dhe kalium në raport 12-12-17) për të siguruar rritje të shëndetshme, forcim të sistemit rrënjor dhe zhvillim optimal të frutave dhe gjetheve. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e plehut sipas madhësisë dhe gjendjes së pemëve, duke shpërndarë materialin në bazamentin e trungut ose sipas metodave të projektit, në mënyrë të barabartë dhe të kontrolluar. Pas aplikimit, plehu mund të përthithet më mirë duke ujitur pemët sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të siguruar tretje dhe absorbim maksimal nga rrënjët. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të mbetura pas shpërndarjes dhe kontrollin e gjendjes së pemëve pas aplikimit për të vlerësuar efektivitetin e plehimit. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme të pemëve dhe përmirësim të prodhimit frutor dhe estetik, duke kontribuar në stabilitetin dhe bukurinë e hapësirave të gjelbërta dhe kopshtore.

Plehrimi i pemëve me ure përfshin aplikimin e azotit në formë të përqendruar për të stimuluar rritjen e gjethëve, rigjenerimin e pjesëve të reja dhe forcimin e sistemit rrënjor. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e duhur të ure-s sipas madhësisë, gjendjes dhe llojit të pemës, dhe shpërndarjen e saj rreth bazamentit të trungut në mënyrë të barabartë, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me trungun ose gjethët për të parandaluar djegien. Pas aplikimit, pemët ujiten sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të favorizuar tretjen dhe absorbimin e azotit nga rrënjët. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të plehut nga sipërfaqja dhe kontrollin e gjendjes së pemëve pas aplikimit për të vlerësuar efektivitetin e plehrit. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme dhe të kontrolluar të pemëve, përmirësim të prodhimit frutor dhe forcim të gjelbërimit, duke kontribuar në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe bukurinë e hapësirave kopshtore ose publike.

Plehrimi i pemëve me pleh kimik lloji 20-20-20 përfshin aplikimin e një përzierjeje të balancuar të azotit, fosforit dhe kaliumit në raport 20-20-20 për të stimuluar rritjen e përgjithshme të pemëve, forcimin e sistemit rrënjor dhe zhvillimin optimal të gjethëve dhe frutave. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e plehut sipas madhësisë dhe gjendjes së pemëve, dhe duke shpërndarë materialin në bazamentin e trungut në mënyrë të barabartë dhe të kontrolluar, duke shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë me gjethët ose trungun për të parandaluar dëmtimin. Pas aplikimit, pemët ujiten sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të siguruar tretje dhe absorbim maksimal të lëndëve ushqyese. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të mbetura pas shpërndarjes dhe kontrollin e gjendjes së pemëve pas aplikimit për të vlerësuar efektivitetin e plehrit. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe të kontrolluar të pemëve, përmirësim të prodhimit frutor dhe forcim të gjelbërimit, duke kontribuar në stabilitetin, shëndetin dhe bukurinë e hapësirave kopshtore ose publike.

Trajtimi i pemëve me ilaç për spërkatje kundër morave, krimbave dhe dëmtuesve të tjerë përfshin aplikimin e një pesticide të përshtatshëm për kontrollin e insekteve dhe parazitëve që mund të dëmtojnë gjethët, degët dhe frutat. Procesi realizohet duke përzgjedhur ilaçin e duhur sipas llojit të pemës, dëmtuesve të pranishëm dhe udhëzimeve teknike të produktit, dhe duke përgatitur përzierjen në përqindjet e rekomanduara për spërkatje. Spërkatja kryhet në mënyrë uniforme në të gjithë pjesët e pemës, duke përfshirë gjethët, degët dhe trungun sipas nevojës, me përdorimin e pompave ose spërkatësve mekanikë, dhe duke respektuar masat e sigurisë për operatorët dhe ambientin. Pas aplikimit, mbeturinat e ilaçit menaxhohen në përputhje me rregullat e mbrojtjes së mjedisit, ndërsa pemët monitorohen për efektivitetin e trajtimit dhe mundësinë e nevojës për spërkatje përsëritëse. Shërbimi garanton mbrojtje të vazhdueshme të pemëve nga dëmtuesit, ruajtjen e shëndetit të tyre, përmirësimin e prodhimit frutor dhe ruajtjen e gjelbërimit, duke kontribuar në qëndrueshmëri dhe bukuri të hapësirave kopshtore ose publike.

Mirëmbajtja e barit përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe zhvillimin e shëndetshëm të sipërfaqeve të gjelbëruara. Procesi përfshin prerjen e rregullt të barit në lartësinë e duhur për të siguruar densitet, uniformitet dhe rigjenerim të shëndetshëm të rrënjëve, largimin e mbeturinave bimore, gjethëve dhe pjesëve të thata, si dhe përmirësimin e ajrosjes së tokës përmes veprimeve të lehta mekanike ose manuale si skarifikimi. Gjatë

mirëmbajtjes mund të aplikohet plehërim i kontrolluar dhe ujitje sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të ruajtur shëndetin dhe ngjyrën e gjelbër të barit. Punimet përfshijnë gjithashtu kontrollin e dëmtuesve dhe trajtimin kundër sëmundjeve ose insekteve që mund të dëmtojnë sipërfaqen e gjelbëruar. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme, densitet dhe paraqitje estetike të barit, duke kontribuar në funksionalitetin dhe bukurinë e hapësirave kopshtore, oborreve, lëndinave sportive dhe zonave publike.

Mbjellja e barit përfshin përgatitjen, kultivimin dhe vendosjen e farës ose trungjeve të barit për krijimin e sipërfaqeve të gjelbëruara të shëndetshme dhe uniforme. Procesi fillon me pastrimin e tokës nga mbeturinat, gurët dhe bimët e padëshiruara, nivelimin dhe tharjen e sipërfaqes, dhe përmirësimin e tokës me shtresa toke të ushqyeshme, plehërim dhe drenazh të përshtatshëm për rritje optimale. Farat ose trungjet e barit shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme dhe sipas dendësisë së kërkuar, pasuar nga ngjeshja e lehtë e tokës për të siguruar kontakt të mirë me substratin dhe mundësinë e një mbirjeje uniforme. Pas mbjelljes, bari ujitet sipas nevojës dhe kushteve klimatike për të favorizuar mbirjen dhe zhvillimin e shëndetshëm, dhe mund të trajtohet me plehërim të kontrolluar ose masa mbrojtëse ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave, monitorimin e mbirjes dhe mirëmbajtjen fillestare për të siguruar dendësi, ngjyrë dhe shëndet optimal të barit. Shërbimi garanton krijimin e sipërfaqeve të gjelbëruara, funksionale dhe estetikisht tërheqëse në hapësira kopshtore, oborre, lëndina sportive ose zona publike.

Krasitja e pemëve përfshin prerjen dhe formësimin e degëve dhe kurorës së pemës për të siguruar rritje të shëndetshme, forcim të strukturës dhe prezantim estetik të pemës. Procesi realizohet duke hequr degët e thata, të sëmura, të dëmtuara ose të panevojshme, si dhe duke rregulluar formën e kurorës për të lehtësuar qarkullimin e ajrit, depërtimin e dritës dhe zhvillimin e pjesëve të reja. Pas kryerjes së krasitjes, degët dhe mbeturinat bimore grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar sipas rregullave të menaxhimit të mbetjeve, ndërsa sipërfaqja e ndërhyrjes pastrohet dhe sistemohen zonat përreth. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme të pemëve, forcim të strukturës dhe prezantim estetik të hapësirave publike, kopshtore ose oborreve, duke kontribuar në funksionalitetin, bukurinë dhe sigurinë e hapësirave të gjelbëruara.

Mirëmbajtja e pemëve përfshin një seri punimesh të organizuara për ruajtjen, zhvillimin e shëndetshëm dhe prezantimin estetik të pemëve në hapësira publike, kopshtore ose oborre. Procesi përfshin krasitjen e degëve të thata, të sëmura ose të panevojshme, kontrollin dhe trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve, plehërimin dhe ujitjen sipas nevojës për të siguruar rritje optimale, forcim të sistemit rrënjor dhe zhvillim të gjethëve dhe frutave. Gjithashtu përfshihet grumbullimi dhe largimi i mbeturinave bimore, pastrimi i zonës së punës dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së pemëve për të vlerësuar efektivitetin e masave të mirëmbajtjes. Shërbimi garanton rritje të shëndetshme, forcim të strukturës, mbrojtje nga dëmtuesit dhe prezantim estetik të hapësirave me pemë, duke kontribuar në bukurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e gjelbërimit në zonat publike, kopshtore dhe oborret.

Bordura e gjelbërt përfshin krijimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e një vijë dekorative me bimë të ulëta ose shkurre të kontrolluara që përdoren për ndarjen vizuale të hapësirave, formësimin e kopshtit dhe përmirësimin estetik të mjedisit. Procesi fillon me përzgjedhjen e bimëve të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës, përgatitjen e tokës për mbjellje duke pastruar mbeturinat, shtresuar dhe ushqyer tokën dhe siguruar drenazh të mjaftueshëm. Bimët vendosen në distanca të njëtrajtshme sipas projektit dhe trajtohen pas mbjelljes me ujitje të rregullt, plehërim dhe kujdes kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu mbledhjen e mbeturinave bimore, kontrollin e rritjes dhe sistemimin estetik të bordurës për të ruajtur uniformitetin dhe prezantimin vizual. Shërbimi garanton krijimin dhe mirëmbajtjen e një bordure të gjelbërt të shëndetshme, estetike dhe funksionale, duke kontribuar në organizimin e hapësirave kopshtore, oborreve dhe zonave publike dhe në përmirësimin e paraqitjes së përgjithshme të mjedisit.

Transporti i mbetjeve përfshin mbledhjen, ngarkimin, bartjen dhe largimin e materialeve të mbetura nga një vendpunim ose hapësirë në një vend të miratuar për trajtim ose asgjësim. Procesi realizohet me mjete të përshtatshme transporti, si kamionë, automjete vetëshkarkuese ose kontenierë, duke siguruar ngarkesë të barabartë dhe mbulim të materialeve të lirshme për të shmangur shpërndarjen gjatë transportit. Mbledhja përfshin grumbullimin e mbetjeve, përfshirë mbeturinat bimore, materiale ndërtimi ose të tjera, dhe ngarkimin me mjete manuale ose mekanike sipas nevojës. Shkarkimi kryhet në vendin e miratuar sipas rregullave të menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. Transporti i mbetjeve zbatohet duke respektuar rregullat e sigurisë në punë dhe të qarkullimit rrugor, duke minimizuar rrezikun për operatorët dhe ambientin. Shërbimi garanton pastrim, mirëmbajtje dhe ruajtje të higjienës në vendpunime, oborre, hapësira publike dhe kopshtore, duke kontribuar në organizimin, funksionalitetin dhe estetikën e hapësirave të trajtuara.

Vaditja e pemëve përfshin furnizimin e pemëve me ujë të mjaftueshëm dhe të kontrolluar për të siguruar rritje të shëndetshme, zhvillim optimal të gjethëve, frutave dhe sistemit rrënjor, veçanërisht gjatë periudhave me mungesë reshjesh ose kushte të thata. Procesi realizohet duke përcaktuar sasinë e ujit sipas madhësisë, moshës dhe llojit të pemës, si dhe kushteve klimatike dhe tipit të tokës. Ujitja kryhet në mënyrë të drejtuar në bazamentin e trungut ose në zonën rrënjore, me mjete manuale, shiringa ujitëse ose sisteme vaditëse mekanike, për të siguruar depërtim të ujit dhe absorbim maksimal. Gjatë punës sigurohet që të shmanget përmbytja e tokës ose dëmtimi i trungut dhe rrënjëve. Procedura përfshin gjithashtu kontrollin e gjendjes së pemëve pas vaditjes dhe mbikëqyrjen e nivelit të lagështisë së tokës për të përcaktuar nevojat e ardhshme për ujitje. Shërbimi garanton ruajtjen e shëndetit, forcimin e sistemit rrënjor, zhvillim të gjelbërimit dhe prodhim frutor optimal, duke kontribuar në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe bukurinë e hapësirave kopshtore, publike ose oborreve.

Skarifikimi i barit me lopatë përfshin hapjen, pastrimin dhe përpunimin e sipërfaqes së barit për të përmirësuar ajrosjen, thithjen e ujit dhe depërtimin e lëndëve ushqyese në tokë, duke stimuluar rritjen e shëndetshme dhe densitetin e barit. Pasi të kryhet skarifikimi, sipërfaqja mund të ujitet ose të përgatitet për mbjellje ose mbulim të shtresave të reja të tokës ose farës, sipas nevojës.

Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të mbledhura dhe kontrollin e uniformitetit të sipërfaqes së përpunuar për të garantuar efekt optimal. Shërbimi siguron përmirësim të densitetit, shëndetit dhe prezantimit estetik të barit, duke kontribuar në mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe bukurinë e lëndinave, oborreve ose hapësirave kopshtore.

Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm përfshin heqjen e bimëve të vogla, të pangjitura ose të dëmtuara për të kontrolluar zhvillimin e vegjetacionit, liruar hapësirat e gjelbëruara dhe përmirësuar paraqitjen estetike të terrenit. Procesi realizohet duke përdorur mjete manuale si sharrë dore, gërshërë ose lopatë për të prerë trungjet dhe degët e vogla në lartësi të përshtatshme, duke shmangur dëmtimin e bimëve të afërta të shëndetshme. Pjesët e prerë grumbullohen, ngarkohen dhe largohen në vend të miratuar, ndërsa sipërfaqja pastrohet dhe sistemohen zonat përreth për të siguruar qasje dhe paraqitje të rregullt. Punimet përfshijnë gjithashtu monitorimin e bimëve të mbetura dhe trajtimin sipas nevojës për të parandaluar rritjen e pakontrolluar ose shfaqjen e dëmtuesve. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, zhvillim të shëndetshëm të bimëve, rritje të estetikës dhe funksionalitetit të hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Shkulja e rrënjëve të bimëve të vogla përfshin heqjen e plotë të rrënjëve të bimëve të vogla, të pangjitura ose të dëmtuara për të parandaluar rigjenerimin e tyre, liruar hapësirat e gjelbëruara dhe përgatitur terrenin për mbjellje, mirëmbajtje ose punime të tjera. Rrënjët e nxjerra grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar për asgjësim ose përdorim tjetër sipas rregullave të menaxhimit të mbetjeve. Pas punës, sipërfaqja pastrohet dhe nivelizohet për të siguruar paraqitje të rregullt dhe qasje të lirë për ndërhyrje të mëtejshme. Shërbimi garanton kontroll të qëndrueshëm të bimëve të padëshiruara, mirëmbajtje të vazhdueshme të hapësirave gjelbëruese dhe krijim të kushteve të favorshme për rritjen e bimëve të dëshiruara, duke kontribuar në estetikën, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër Φ 10–20 cm përfshin prerjen profesionale, rregullimin dhe trajtimin e pemëve me diametër të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, si dhe largimin ose segmentimin e materialit drunor sipas nevojës. Degët e panevojshme ose të dëmtuara hiqen paraprakisht për të siguruar qasje dhe stabilitet gjatë operacionit, ndërsa trungjet priten në segmente të transportueshme sipas kërkesave të projektit. Pas prerjes kryhet grumbullimi, ngarkimi dhe transporti i materialit drunor në vend të miratuar, si dhe pastrimi dhe nivelimi i sipërfaqes për të ruajtur estetikën dhe funksionalitetin e hapësirës. Punimet zbatohet duke respektuar standardet e sigurisë në punë dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, ndërsa kapaciteti i realizimit varet nga numri i pemëve, konfigurimi i terrenit dhe qasja në lokacion. Shërbimi siguron mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të pemëve, duke kontribuar në bukurinë dhe funksionalitetin e hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Prerja dhe sistemimi i pemëve me diametër Φ 41–75 cm përfshin prerjen profesionale, rregullimin dhe trajtimin e pemëve të mëdha me diametër të matur në lartësi rreth 1.3 m nga niveli i tokës, për të siguruar shëndet, stabilitet dhe prezantim estetik, si dhe për të lehtësuar

qarkullimin ose punimet në hapësirë. Degët e panevojshme, të sëmura ose të dëmtuara hiqen paraprakisht për të siguruar qasje të sigurt dhe stabilitet gjatë prerjes, ndërsa trungjet priten në segmente të transportueshme sipas kërkesave të projektit. Pas prerjes, pjesët e drurit grumbullohen, ngarkohen dhe transportohen në vend të miratuar, ndërsa sipërfaqja pastruar dhe sistemuar për të ruajtur estetikën dhe funksionalitetin e hapësirës. Punimet kryhen duke respektuar standardet e sigurisë në punë dhe përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale, dhe kapaciteti i zbatimit varet nga madhësia e pemëve, konfigurimi i terrenit dhe qasja në lokacion. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme, forcim të strukturës dhe prezantim estetik të hapësirave me pemë, duke kontribuar në bukurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e hapësirave publike, kopshtore ose oborreve.

Transporti i materialeve të ndërtimit dhe dheut me automjetet deri në distancë 3 km përfshin ngarkimin, bartjen dhe shkarkimin e materialeve nga vendi i origjinës në destinacionin e përcaktuar brenda rrezes maksimale prej 3 km. Procesi realizohet me automjete të përshtatshme transporti, si kamionë vetëshkarkues ose kamionë me karroceri të hapur, me kapacitet mbajtës sipas ngarkesave të lejuara, duke siguruar shpërndarje të barabartë dhe mbulim të materialit për të shmangur derdhjen gjatë lëvizjes. Ngarkimi kryhet me mjete mekanike, si eskavator ose ngarkues frontal, ose manualisht kur kërkohet, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e materialeve. Shkarkimi realizohet në vendin e përcaktuar, me sistem vetëshkarkimi ose mjete ndihmëse, dhe materialet mund të sistemohen sipas kërkesës për përdorim të mëtejshëm. Çmimi njësi përfshin të gjitha kostot operative, duke përfshirë karburantin, amortizimin, fuqinë punëtore dhe kohën e pritjes për ngarkim dhe shkarkim brenda kushteve normale. Shërbimi garanton transport të sigurt, të shpejtë dhe efikas të materialeve të ndërtimit dhe dheut, duke kontribuar në funksionalitetin dhe vijimësinë e punimeve ndërtimore.

Mirëmbajtja e kodrave dhe lisave në Pilur përfshin një gamë punimesh të organizuara për ruajtjen, pastrimin dhe zhvillimin e shëndetshëm të pemëve dhe hapësirave gjelbëruese në terrenet kodrinore. Procesi përfshin krasitjen e degëve të thata ose të dëmtuara, shkëlqen e bimëve të padëshiruara dhe mirëmbajtjen e gjelbërimit ekzistues, për të përmirësuar prezantimin vizual dhe stabilitetin e pemëve. Tokat dhe zonat rreth lisave pastrohen nga mbeturinat bimore, gjethet e thata dhe pjesët e vyera, ndërsa bari dhe bimët e vogla rregullohen ose priten sipas nevojës. Në rast të nevojës, kryhet plehërim, vaditje ose trajtim kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve për të siguruar rritje të shëndetshme dhe forcim të sistemit rrënjor. Punimet realizohen me mjete manuale ose mekanike, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e pemëve ose mjedisit përreth. Gjithashtu përfshihet grumbullimi dhe largimi i mbeturinave, pastrimi i sipërfaqeve dhe monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së pemëve dhe kodrave. Shërbimi garanton mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme, stabilitet dhe prezantim estetik të lisave dhe hapësirave kodrinore, duke kontribuar në bukurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e zonës në Pilur.

Mirëmbajtja e murit prej guri mbajtës dhe themeleve të ndërtuara me llac cemento M25 përfshin një seri punimesh për ruajtjen, përforcimin dhe restaurimin e strukturës ekzistuese të murit. Procesi përfshin inspektimin e murit për të identifikuar dëmtime, çarje ose dobësime në lidhjet e

gurëve dhe llacit, pastrimin e sipërfaqeve nga pluhuri, gëlqeri e rrënojat e tjera, dhe riparimin e pjesëve të dëmtuara duke përdorur llacimento M25 sipas standardeve të ndërtimit. Punimet mund të përfshijnë rivendosjen e gurëve të zhvendosur, mbushjen e çarjeve, përforcimin e themeleve dhe sigurimin e stabilitetit të murit. Gjatë mirëmbajtjes respektohen masat e sigurisë dhe përdoren mjete manuale ose mekanike sipas nevojës, duke shmangur dëmtimin e strukturës ekzistuese. Pas kryerjes së ndërhyrjeve, zona pastrohet nga mbeturinat e gurëve dhe llacit, ndërsa murit i sigurohet trajtim mbrojtës për rezistencë të zgjatur ndaj erozionit dhe faktorëve atmosferikë. Shërbimi garanton ruajtjen e integritetit struktural, stabilitetin dhe prezantimin estetik të murit mbajtës dhe themeleve, duke kontribuar në funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e objekteve ndërtimore.

Gropat për fidanet e rinj 40×40×40 cm përfshijnë përgatitjen e tokës dhe hapjen e gropave të përshtatura për vendosjen e fidaneve të reja në hapësira kopshtore, oborre ose zona publike. Procesi realizohet duke përcaktuar vendet sipas projektit, pastruar zonën nga mbeturinat dhe bimët e padëshiruara, dhe hapur gropat me dimensionet e kërkuara 40×40×40 cm, duke siguruar thellësi dhe gjerësi të mjaftueshme për zhvillimin optimal të sistemit rrënjor. Tokat e nxjerra mund të përpunohen me pleh ushqyes ose të kombinohen me tokë të pasur për të favorizuar rritjen e shëndetshme të fidaneve. Pas hapjes, gropat ujiten lehtë dhe fidanet vendosen me kujdes, duke mbuluar rrënjët me tokë të përgatitur dhe ngjeshur butësisht për stabilitet. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave të nxjerra, sistemimin estetik të hapësirës përreth dhe monitorimin fillestar të ujitjes dhe gjendjes së fidaneve për të siguruar mbirje të shëndetshme. Shërbimi garanton vendosje të saktë, rritje optimale dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të fidaneve, duke kontribuar në bukurinë dhe funksionalitetin e hapësirave kopshtore dhe publike.

Mbjellja e fidaneve të rinj përfshin vendosjen e bimëve të reja në tokë të përgatitur për të siguruar rritje të shëndetshme, zhvillim optimal të rrënjëve dhe prezantim estetik të hapësirave kopshtore, oborre ose publike. Procesi fillon me përzgjedhjen e fidaneve të shëndetshme dhe të përshtatshme për klimën dhe tokën e zonës, si dhe përgatitjen e tokës duke pastruar mbeturinat, gërmuar sipërfaqen dhe përforcuar shtresën e tokës me lëndë ushqyese sipas nevojës. Fidanet vendosen në gropat të përgatitura paraprakisht, me thellësi dhe gjerësi të përshtatshme për rrënjët, dhe mbulohen me tokë të ngjeshur butësisht për stabilitet. Pas mbjelljes, fidanet ujiten në mënyrë të kontrolluar dhe mund të trajtohen me plehëra ose mbrojtje kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Punimet përfshijnë gjithashtu pastrimin e mbeturinave, sistemimin estetik të hapësirës dhe monitorimin fillestar të zhvillimit të fidaneve për të siguruar mbirje të shëndetshme. Shërbimi garanton vendosje të saktë, mirëmbajtje të vazhdueshme, rritje të shëndetshme dhe prezantim estetik të hapësirave gjelbëruese, duke kontribuar në bukurinë dhe funksionalitetin e kopshtit, oborrit ose hapësirave publike.

Transporti i materialeve të ndërtimit dhe dheut me automjetet deri në distancë 3 km përfshin ngarkimin, bartjen dhe shkarkimin e materialeve nga vendi i origjinës në destinacionin e përcaktuar brenda rrezes maksimale prej 3 km. Procesi realizohet me automjete të përshtatshme transporti, si kamionë vetëshkarkues ose kamionë me karrocë të hapur, me kapacitet të

përshtatshëm për ngarkesën, duke siguruar shpërndarje të barabartë dhe mbulim të materialit për të shmangur derdhjen gjatë lëvizjes. Ngarkimi kryhet me mjete mekanike si eskavator ose ngarkues frontal, ose manualisht kur është e nevojshme, duke respektuar masat e sigurisë dhe duke shmangur dëmtimin e materialeve. Shkarkimi realizohet në vendin e destinacionit, ku materialet mund të sistemohen sipas kërkesave të punimeve të mëtejshme. Çmimi njësi përfshin të gjitha kostot operative, duke përfshirë karburantin, fuqinë punëtore, amortizimin e automjeteve dhe kohën e pritjes për ngarkim dhe shkarkim brenda kushteve normale. Shërbimi garanton transport të sigurt, të shpejtë dhe efikas të materialeve të ndërtimit dhe dheut, duke kontribuar në vijimësinë dhe funksionalitetin e punimeve ndërtimore.

III.7.2. Në shtojcën 7 “Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të Ekzekutimit”, të dokumenteve standarde të tenderit , autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi që kërkohet:

Nr	Nr.An.	Emërtimi	Njësia	Sasia
<i>I- Mirëmbajtje e sipërfaqeve të gjelbra dhe infrastrukturës në varreza</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	125,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	22,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	3,500
5	3.4	Prerje e sistemim pemësh Φ21-40cm	copë	2,100
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	1,000
7	3.161/1	Rrafshim skarpate	m ²	4,500
8	3.322	Mur guri, llaç çimento M25 (mirëmbajtje)	m ³	200
9	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	400
10	an.	Mirëmbajtje varrezat e dëshmorëve Kuç	m ²	1,750
<i>II - Mirëmbajtje rruge për shkolla, kosha, varreza etj</i>				
1	an	Mirëmbajtje rruge për 1,000 m ²	m ²	90,000
1	3.96	F.V. fidane lule dekorative	copë	2,200
2	3.962	F.V. fidane shkurre dekorative "Oleander"	copë	300
3	an.168	F.V. shkurre dekorative Juniperus V18 grup3 cdo 6.6m	copë	200
4	an.	Mirëmbajtje	m ²	2,500
<i>IV-Plehërim i pemëve me pleh kimik</i>				
1	an.	Pleh kimik lloji 12-12-17	kg	3,000
2	an.	Ure	kg	2,500

3	an.	Pleh kimik lloji 20-20-20	kg	2,000
4	an.	Ilaç për spërkatje pemë (kunder morave, krimbave etj)	kg	60
<i>V- Mirëmbajtje bari</i>				
1	an.	Mirëmbajtje bari	m ²	32,000
2	3.643	Mbjellje bari	m ²	10,000
<i>VI- Krasitje pemë në shëtitore dhe trotuare</i>				
1	an.	Krasitje pemë	copë	1,250
2	an	Mirëmbajtje e pemëve	copë	1,250
3	an.	Bordurë e gjelbërt	ml	350
4	an.	Transport mbetjesh	m ³	127
<i>VI-Vaditje e pemëve gjatë sezonit 6-mujor</i>				
1	an.	Vaditje pemësh	copë	1,250
<i>VIII- Mirëmbajtje pishat pranë fushës, kodra</i>				
1	3.1	Skarifikim bari me lopatë	m ²	95,000
2	3.2	Prerje bimë të vogla Φ-10cm	m ²	12,000
3	3.7	Shkulje rrënjëve bimëve të vogla	m ²	11,000
4	3.3	Prerje e sistemim pemësh Φ10-20cm	copë	2,000
6	3.5	Prerje e sistemim pemësh Φ41-75cm	copë	250
7	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	220
<i>IX- Mirëmbajtje kodra e lisave në Pilur</i>				
1	an.	Mirëmbajtje	m ²	9,000
2	3.322	Mur guri mbajtës e themele, ilaç çimento M25, mirëmbajtje	m ³	122
3	an.	Gropa për fidanet e rinj 40x40x40cm	copë	200
4	an.	Mbjellja e fidanëve të rinj	copë	200
5	2.37/3a	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 3km	m ³	136

III.7.3. Në shtojcën 8 “*Formulari i Termave të Referencës*”, të dokumenteve standarde të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

Shërbimi i mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbëruara

1. Qëllimi i kontratës

Qëllimi i kësaj kontrate është realizimi i shërbimeve për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara, prerjen dhe sistemimin e vegjetacionit, furnizimin dhe mbjelljen e fidaneve, plehërimin dhe trajtimin fitosanitar, transportin e materialeve dhe mbetjeve, si dhe mirëmbajtjen

e elementeve ndërtimore dhe infrastrukturore në zona publike, rrugore, shkollore dhe memoriale.

2. Përshkrimi i shërbimeve

Shërbimet që do të realizohen përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon.

Skarifikimi manual i barit me lopatë në thellësi 3–5 cm dhe me distancë prerjesh 10–15 cm duke përfshirë pastrimin e mbetjeve, nivelimin dhe sipas nevojës mbjellje plotësuese dhe plehërim

Prerja e bimëve të vogla me diametër deri në Φ 10 cm, shkulja e plotë e rrënjëve të tyre, grumbullimi dhe largimi i mbetjeve si dhe nivelimi i sipërfaqes.

Prerja dhe sistemimi i pemëve sipas kategorive të diametrit Φ 10–20 cm, Φ 21–40 cm dhe Φ 41–75 cm duke përfshirë rrëzimin e kontrolluar, segmentimin, transportin e materialit drunor dhe pastrimin përfundimtar të zonës.

Krasitja dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e pemëve duke përfshirë heqjen e degëve të thata ose të dëmtuara, trajtimin kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe plehërimin sipas nevojës.

Rrafshimi dhe stabilizimi i skarpatave sipas parametrave gjeoteknikë, me ngjeshje të kontrolluar dhe sistemim përfundimtar të sipërfaqes.

Mirëmbajtja dhe riparimi i mureve prej guri dhe mureve mbajtëse me llaç cemento M25 duke përfshirë pastrimin e fugave, zëvendësimin e elementeve të dëmtuara dhe përforcimet e nevojshme.

Transporti i materialeve të ndërtimit, dheut dhe mbetjeve deri në distancë 3 km duke përfshirë ngarkimin, shkarkimin dhe sistemimin sipas kërkesës.

Mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve në Kuç, Tërbaç dhe Shën Vasil duke përfshirë pastrim, prerje bari, riparime të elementeve memoriale dhe raportim periodik mbi gjendjen.

Mirëmbajtja e rrugëve dhe oborreve të shkollave për sipërfaqe 1000 m² duke përfshirë pastrim, rrafshim, sistemim dhe garantim të sigurisë së qarkullimit.

Furnizimi, mbjellja dhe mirëmbajtja e fidaneve lule dekorative, shkurre dekorative Oleander, shkurre dekorative Juniperus V18 grup 3 të vendosura çdo 6 6 m, si dhe krijimi i bordurave të gjelbërta.

Hapja e gropave për fidane 40×40×40 cm dhe mbjellja e fidaneve të rinj me përgatitje toke dhe trajtim pas mbjelljes.

Mbjellja dhe mirëmbajtja e barit duke përfshirë përgatitjen e tokës, mbjelljen, ujitjen, plehërimin dhe kontrollin fitosanitar.

Plehërimi i pemëve me pleh kimik 12-12-17, 20-20-20 dhe ure sipas dozimit teknik dhe kushteve agronomike.

Trajtimi i pemëve me pesticide për spërkatje kundër morave, krimbave dhe dëmtuesve të tjerë sipas udhëzimeve teknike dhe standardeve mjedisore.

Vaditja e pemëve sipas kërkesave biologjike dhe kushteve klimatike.

Mirëmbajtja e kodrave dhe lisave në Pilur duke përfshirë krasitje, pastrim, trajtim dhe stabilizim të terrenit.

3. Kërkesat teknike

Të gjitha punimet duhet të realizohen në përputhje me standardet teknike në fuqi dhe praktikën e mirë profesionale.

Kontraktori duhet të përdorë pajisje dhe makineri të përshtatshme për natyrën e punimeve. Duhet të sigurohet përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale dhe zbatimi i rregullave të sigurisë në punë.

Materialet e përdorura duhet të jenë cilësore dhe në përputhje me specifikimet teknike. Mbetjet dhe materialet e tepërta duhet të transportohen në vende të miratuara sipas legjisllacionit mjedisor.

4. Afati i realizimit

Shërbimet do të realizohen sipas grafikut të përcaktuar nga autoriteti kontraktor dhe në varësi të kushteve klimatike dhe sezonalitetit të punimeve.

5. Detyrimet e kontraktorit

Të sigurojë staf të kualifikuar dhe të trajnuar.

Të garantojë cilësi dhe realizim korrekt të punimeve.

Të raportojë periodikisht mbi ecurinë e shërbimit.

Të riparojë çdo dëmtim të shkaktuar gjatë realizimit të punimeve.

6. Kontrolli dhe pranimi i shërbimeve

Punimet do të mbikëqyren nga përfaqësues të autoritetit kontraktor.

Pranimi i shërbimeve do të bëhet pas verifikimit të cilësisë dhe përputhshmërisë me kërkesat teknike.

III.7.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.7.5. Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti

kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.7.6. Neni 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”.

III.7.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të

fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”* Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”* Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe

etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsytuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” Gjithashtu, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Kështu, autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, nuk mund të niset vetëm nga procedura analoge të zhvilluara më parë nga po i njëjti autoritet kontraktor ose nga autoritete të tjera kontraktore homologe, ose eprore, por në përputhje me parashikimet e ligjit. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” se qëllimi i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit dhe pas verifikimit të përmbajtjes së specifikimeve teknike, termave të referencës dhe dokumentacionit në tërësi të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, autoriteti nuk ka publikuar asnjë hartë apo plan vendosje të objekteve ku do të realizohet shërbimi. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues, me të drejtë në ankesën e paraqitur ka parashtruar argumente, në lidhje me mangësit e konstatura mangësi të cilat do të ndikonin drejtperdrejtë në ofertimin e operatorit ekonomik. Në përfundim, KPP gjykon, se për sa kohë operatori ekonomik në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe KPP, ka argumentuar se mungesa e mospublikimit të hartave apo planvendosjeve të objekteve në të cilat do të kryhet shërbimi i mirëmbajtjes ndikon në mënyrën e ofertimit pasi nuk është e mundur të llogariten kostot e detajuara të shërbimit, ndaj dhe Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të publikojë hartat apo planvendosjet e objekteve në SPE, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Albgarden*” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79017-03-12-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra”, me fond limit: 149,998,577.16 (njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjet e tetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,560,209.87 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë e dyqind e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë) euro. (Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.14), datë 12.03.2026), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albgarden” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79017-03-12-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e hapësirave të gjelbëra”, me fond limit: 149,998,577.16 (njëqind e dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjet e tetëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH ose 1,560,209.87 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetëmijë e dyqind e nëntë pikë tetëdhjetë e shtatë) euro. (Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.14), datë 12.03.2026), parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albgarden” SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

